



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raporti përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Dimal

RAPORT

(Auditim Financiar)

BASHKIA DIMAL

TIRANË 2024

Përmbajtja

| | |
|--|----|
| I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE | 2 |
| a. Përshkrim i shkurtër i institucionit | 2 |
| b. Rëndësia e institucionit dhe auditimit të tij..... | 3 |
| c. Objektivat dhe qëllimi i auditimit:..... | 3 |
| d. Metodatat dhe Teknikat e Kontrollit të përdorura nga audituesit gjatë auditimit:..... | 3 |
| e. Numri i gjetjeve dhe rekomandimeve..... | 4 |
| KONKLUZIONI I PËRGJITHSHËM DHE OPINIONI I AUDITIMIT | 5 |
| II. HYRJE | 6 |
| 1. Objektivat dhe qëllimi..... | 6 |
| 2. Identifikimi i çështjes:..... | 6 |
| 3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar: | 6 |
| 4. Përgjegjësia e audituesve të KLSH:..... | 7 |
| 5. Kriteret e vlerësimit:..... | 7 |
| 6. Dokumentimi i rezultateve të auditimit:..... | 8 |
| III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT | 8 |
| III.1 PËRSHKRIMI I REZULTATEVE SIPAS DREJTIMEVE TË AUDITIMIT | 8 |
| 1. AUDITIM MBI KONTROLLIN E BRENDSHËM FINANCIAR PUBLIK..... | 8 |
| 2. AUDITIM MBI PLANIFIKIMIN, ZBATIMIN DHE MONITORIMIN E PLANIT TË BUXHETIT | 18 |
| 3. AUDITIM MBI VLERËSIMIN E RAPORTIMIT FINANCIAR, PËR TË ARRITUR NË OPINIONIN NË SE PASQYRAT FINANCIARE PËR VITIN 2023 JAPIN NJË PARAQITJE TË VËRTETË E TË DREJTË TË POZICIONIT FINANCIAR, PERFORMANCËS FINANCIARE DHE FLUKSIT TË PARASË, BAZUAR NË KUADRIN RREGULLATOR NË FUQI..... | 36 |
| 4. MBI AUDITIMIN E ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM | 50 |
| IV. GJETJE DHE REKOMANDIME | 68 |
| A. MASA ORGANIZATIVE | 68 |
| B. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR DHE RITJEN E PERFORMANCËS NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TAKSAT DHE TARIFAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA - TË ARDHURA TË MUNGUARA. | 74 |
| V. ANEKSE | 77 |

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

a. Përshkrim i shkurtër i institucionit

Dimali kufizohet në veri- perëndim me bashkinë Lushnjë, në veri-lindje me bashkinë Kuçovë, në jug-lindje me bashkinë Berat dhe në jug-perëndim me bashkinë e Roskovecit. Kryeqendra e bashkisë është qyteti i Urës Vajgurore. Popullsia: Sipas Çensusit të vitit 2011, kjo bashki numëron 27,295 banorë, ndërsa sipas Regjistrat Civil ajo numëron një popullsi prej 39,551 banorë. Me një sipërfaqe prej 156.56 km², ajo ka densitet prej 174 banorë/km² sipas çensusit dhe densitet prej 226 banorë/km² sipas regjistrat civil. Bashkia Dimal ka qenë që prej vitit 1914 nënprefekturë. Zona që përfshihet në bashkinë e re është e pasur me monumente arkeologjike, historike, monumente kulturi dhe natyrore, me vlera unike në llojin e vet, të vizitueshme në çdo kohë dhe të njohura

ndërkombëtarisht. Të dhëna të tjera: Bashkia e re shtrihet në një zonë të pasur me toka bujqësore shumë pjellore si dhe me burime të rëndësishme guri. Burimet kryesore të të ardhurave për banorët e kësaj zone bazohen te shfrytëzimi i resurseve natyrore, sidomos atyre të përpunimit të inerteve të gurit dhe të lumenjve, i fermave private, përpunimit agro-industrial, plantacioneve me ullinj, dru frutorë dhe vreshta, perimeve, blegtorisë, si dhe përpunimit të produkteve të qumështit dhe mishit. Kjo zonë është e njohur herët për minierat sipërfaqësore të gurit, ndërsa kohët e fundit edhe për përpunimin e gurit në granit dhe gëlqere, duke u njohur edhe si “gurorja” e Shqipërisë për shkak të numrit të madh të shoqërive private që kryejnë aktivitetet në këtë fushë. Me ndarjen e re administrative kjo njësi vendore do të marrë një profil të rëndësishëm bujqësor, të orientuar sidomos në frutikulturë me prodhimin e ullirit, por nuk mbetet pas dhe blegtoria, drithërat dhe perimet, si dhe shumë foragjere. Veçanërisht Komuna Kutalli është e njohur në rang kombëtar për kultivimin dhe hershmërinë e perimeve në serat pa ngrohje. Këtë mundësi ia jep terreni dhe pozicioni shumë i favorshëm gjeografik që i favorizon fermerët të kultivojnë perime, fruta dhe vreshta. Për periudhën objekt auditimi Bashkia Dimal ka patur në dispozicion një buxhet të planifikuar në vlerën 579,012 mijë lekë.

b. Rëndësia e institucionit dhe auditimit të tij.

Auditimi i këtij institucioni çdo vit është detyrim ligjor në bazë të ligjit nr. 68/2017 datë 27.04.2017 “Për financat e qeverisjes vendore” nenit 50 “Auditi i jashtëm” pikat 1 dhe 2 në të cilat përcaktohet: “1. *Veprimtaria financiare dhe zbatimi i buxhetit vjetor të njërive të vetëqeverisjes vendore u nënshtrohen çdo vit auditimit të jashtëm.* 2. *Auditimi i jashtëm realizohet nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose auditues të tjerë ligjorë*”. Gjithashtu ky auditim merr rëndësi të veçantë për arsye se, Bashkia Dimal si çdo njësi vendore administron, menaxhon dhe shpenzon fonde publike, pjesë e buxhetit të Bashkisë të miratuar nga Këshilli Bashkiak me burim financimi nga të ardhurat e realizuara nga taksapaguesit qytetarë dhe fondet e transferuara nga Buxheti i Shtetit.

c. Objektivat dhe qëllimi i auditimit:

Qëllimi i këtij auditimi është dhënia e opinionit mbi pasqyrat financiare dhe mbi përputhshmërinë e veprimtarisë ekonomike dhe financiare me aktet ligjore dhe nënligjore, për periudhën 01.01.2023 - 31.12.2023. Për të gjitha problematikat e konstatuara janë dhënë rekomandime për përmirësime me synim ndërmarrjen e masave dhe veprimeve korrigjuese nga Bashkia Dimal. Në përmbushje të qëllimit të auditimit, janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme

- mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditin e brendshëm.
- mbi planifikimin, zbatimin e monitorimin e planit të buxhetit.
- mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2023, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.
- mbi zbatimin i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

d. Metodatat dhe Teknikat e Kontrollit të përdorura nga audituesit gjatë auditimit:

Metodat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit; në procedurat bazë dhe në procedurat analitike pas testeve të kryera me qëllim arritjen e objektivave të auditimit.

Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodatat dhe teknikat e mëposhtme:

Intervistimi - duke marrë informacion nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit dhe atij të përfshirë për një çështje të caktuar, e kombinuar kjo me shqyrtimin e evidencave përkatëse:

Raporte dhe informacione - shfrytëzimi i raporteve/ informacioneve relevante dhe të që kanë lidhje me objektivat e auditimit dhe specifikisht me drejtimit e auditimit;
Verifikimi në sistemin elektronik - me përzgjedhje i çështjeve të veçanta të auditimit, sipas drejtimeve të auditimit;
Të kombinuara, sipas rastit dhe vlerësimit të audituesve.

e. Numri i gjetjeve dhe rekomandimeve

Nga shqyrtimi i evidencave rezultoi se Bashkia Dimal për periudhën nën auditimit paraqet të meta dhe mangësi në disa prej drejtimeve të veprimtarisë, për të cilat grupi i auditimit ka konstatuar 11 gjetje dhe janë lënë 20 rekomandime. Në vijim paraqiten ato më kryesoret:

-Nivel jo i plotë i realizimit të buxhetit në masën 83%, me pasojë mos përmbushjen plotësisht të objektivave të parashikuar sipas programeve të tij.

- Nivel i lartë i detyrimeve të prapambetura në vlerën 253,749,611 lekë, si pasojë e mos realizimit të të ardhurave.

- Efekt financiar negativ në vlerën 9,140,021 lekë si pasojë e një Vendimi gjyqësor në disfavor të Bashkisë Dimal ndaj operatorëve ekonomik.

- Mos marrja e masave për bllokimin e aktivitetit ndaj 4 subjekteve që ushtrojnë aktivitet në fushën e hidrokarbureve në mungesë të dokumentacionit ligjor.

-Mos pasqyrim i situatës reale në llogaritë kontabël të institucionit si pasojë e

- Mos regjistrimit në pronësi të saj të 246 aseteve në përdorim
- Mos inventarizimi dhe mos përditësimi me vlerat aktuale të llogarive nr.210 “Toka, Troje, Terrene” dhe nr.211 “Pyje, Kullota, Plantacione”, për vlerat e truallit nën objekt dhe të truallit funksional, si dhe vlerat e trojeve, pyjeve dhe kullotave të cilat me VKM kanë kaluar në pronësi të Bashkisë Dimal.

- Mos pasqyrimi në llogarinë përkatëse të aktiveve të nxjerra jashtë përdorimit.

- Mos përditësimi i vlerës për 4 mjete transporti për të cilat për shkak të vjetërsisë prej 20 vitesh u ka kaluar norma e amortizimit.

Me qëllim zgjidhjen e problematikave janë dhënë disa rekomandime si vijon:

- Bashkia Dimal, Drejtoria e Financës, të paraqesë në mbledhjen e Këshillit Bashkiak, një material për gjendjen e faturave të pa likuiduara, si dhe të hartojë një grafik duke zbatuar të gjithë radhën e pagesave. Për Vendimet Gjyqësore që kanë marrë formë të prerë, duhet ti ekzekutojë ato në mënyrë vullnetare dhe të mos presë që ekzekutimi të bëhet nëpërmjet urdhrave të përmbaruesit gjyqësor për të shmangur kostot e tepërta buxhetore që vijnë për shkak të pagesave të shpenzimeve përmbarimore.

- Kryetari i Bashkisë Dimal dhe Drejtoria e Financës, të hartojnë regjistrin e aktiveve dhe kontabilizimin e plotë dhe të saktë në llogarive nr.210 “Toka, Troje, Terrene” dhe nr.211 “Pyje, kullota, plantacione”, si dhe të marrë masat e nevojshme për ngritjen e një grupi pune me qëllim kryerjen e verifikimit fizik dhe vlerësimin me vlerë financiare të sipërfaqeve të pyjeve, kullotave dhe plantacioneve të llogarisë nr.210 “Toka, Troje, Terrene” dhe nr.211 “Pyje, kullota, plantacione”.

- Në funksion të një planifikimi sa më të saktë të të ardhurave, nga titullari i Bashkisë të merren masa për lidhjen e Akt marrëveshje me agjentët tatimorë si dhe për caktimin e një personi përgjegjës për mbajtjen e marrëdhënieve dhe korrespondencave periodike me ta Ujësbellës sh.a, ASHK Dega Berat, Drejtoria e Tatim-Taksave, zyra e Gjendjes Civile, etj, për gjenerimin e të dhënave dhe treguesve të saktë dhe në kohë reale mbi numrin e subjekteve familjarë apo privatë të cilët kanë detyrime ndaj Bashkisë.

KONKLUZIONI I PËRGJITHSHËM DHE OPINIONI I AUDITIMIT

Opinion mbi Pasqyrat Financiare:

Grupi i auditimit të KLSH-së, ka audituar pasqyrat financiare të Bashkisë Dimal për periudhën ushtrimore 01.01.2023– 31.12.2023, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, të performancës financiare, të ndryshimit të aktiveve, të fluksit të mjeteve monetare dhe shënimet shpjeguese. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

"Në opinionin tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, pasqyrat financiare të subjektit Bashkia Dimal janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin”, që në gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një **opinionit të modifikuar, me rezervë**”, e shprehur kjo në bazën për opinionin.

Baza për opinion:

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Njësia shpenzuese Bashkia Dimal, në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare, si dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë. (ISA 700-ISSAI 1700).

Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se, pasqyra e pozicionit financiar, pasqyra e performancës financiare, pasqyra e ndryshimeve në kapital, pasqyra e flukseve e mjeteve monetare, si dhe shpjegimet janë përfshirë në deklaratat financiare, por gjatë auditimit kemi arritur në përfundimin se pasqyrat financiare përmbanin gabime materiale, por jo të përhapura (ISA 705-ISSAI 1705). Materialiteti i llogaritur nga audituesit e Kontrollit të Lartë të Shtetit bazuar në Manualin e Auditimit Financiar të KLSH-së për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023 është 18,653 mijë lekë.

Përshkrimi i çështjeve:

Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë faktin se: janë konstatuar mangësitë si vijon:
-Mos pasqyrim i situatës reale në llogaritë kontabël të institucionit si pasojë e

- Mos regjistrimit në pronësi të saj të 246 aseteve në përdorim
- Mos inventarizimi dhe mos përditësimi me vlerat aktuale të llogarive nr.210 “Toka, Troje, Terrene” dhe nr.211 “Pyje, Kullota, Plantacione”, për vlerat e truallit nën objekt dhe të truallit funksional, si dhe vlerat e trojeve, pyjeve dhe kullotave të cilat me VKM kanë kaluar në pronësi të Bashkisë Dimal
- Mos pasqyrimi në llogarinë përkatëse të aktiveve të nxjerra jashtë përdorimit.
- Mos përditësimi i vlerës për 4 mjete transporti për të cilat për shkak të vjetërsisë prej 20 vitesh u ka kaluar norma e amortizimit.

II. HYRJE

Mbështetur në ligjin nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 358/1 Prot, datë 13.03.2024, miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 16.03.2024 deri më datë 12.04.2024 në subjektin Bashkia Dimal, u krye auditimi financiar për periudhën 01.01.2023 deri 31.12.2023, nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. R.K, Përgjegjëse grupi
2. H.M, Auditues
3. M.M, Auditues

Nga grupi i auditimit u përgatit Raporti Përfundimtar i Auditimit, një kopje e të cilit i dërgohet Bashkisë Dimal dhe një kopje protokollohet në Kontrollin e Lartë të Shtetit.

1. Objektivat dhe qëllimi

Objektivi i auditimit financiar është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, nëse për vitin 2023, transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi.

Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve janë paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe të shpenzimeve.

2. Identifikimi i çështjes:

Raporti Përfundimtar synon të identifikojë përmbushjen e rolit dhe të përgjegjësive të titullarëve dhe stafeve mbështetëse për realizimin e përgjegjësive publike.

Gjetjet e këtij auditimi të karakterit organizativ, çështjet e vlerësuara i janë nënshtruar skepticizmit profesional dhe gjykimit objektiv të audituesve, duke i dhënë mundësi KLSH në dhënien e rekomandimeve përkatëse për përmirësimin e gjendjes, në funksion të rritjes së efektivitetit të veprimtarisë së këtij institucioni publik, transparencës, përgjegjësisë dhe llogaridhënies.

Raporti Përfundimtar i Auditimit është i strukturuar në disa kapituj ku identifikohet hyrja, me çështjet e objektivave dhe qëllimin e auditimit, përgjegjësitë e strukturave drejtuese dhe të audituesve, kriteret, përshkrimi i auditimit, në të cilin paraprin një informacion i përgjithshëm mbi subjektin e audituar dhe vazhdon me trajtimin e rezultateve të auditimit për secilin prej drejtimeve të auditimit; përfshirë dhe gjetjet e rekomandimet së bashku me anekset.

3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar:

Titullari i Bashkisë, dhe Nëpunësi Zbatues sipas rastit, janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm për raportimin financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton respektimin e kuadrit ligjor në fuqi, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në RSH”, i ndryshuar, ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, etj. Gjithashtu, stafi drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e aplikuara. Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar.

4. Përgjegjësia e audituesve të KLSH:

Përgjegjësia e audituesve është dhënia e opinionit mbi problematikat e trajtuara të çështjeve nën auditim. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI. Këto standarde kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike, si dhe të planifikojë e kryejë auditimin me qëllim që të arrijë nivelin e sigurisë së kërkuar me objekt: dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord. Objektivi ynë lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme mbi përputhshmërinë e aktivitetit të Bashkisë, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi. Gjatë kryerjes së auditimit, audituesit e KLSH marrin evidenca të besueshme, të përshtatshme dhe të mjaftueshme për të mbështetur gjykimin dhe konkluzionet e dala lidhur me organizimin, veprimtarinë, programin dhe funksionet e subjekteve nën auditim. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojnë.

5. Kriteret e vlerësimit:

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;

Ligji nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;

Në fushën e buxhetit dhe administrimit financiar:

Ligji nr. 24/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”

Ligji nr. 84/2023 “Për buxhetin e vitit 2023” dhe aktet normative që ndryshojnë këtë ligj.

Ligji nr. 48/2014, datë 24.04.2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, i ndryshuar;

Udhëzimi i MF nr. 8, datë 29.03.2012 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”;

UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit”, etj.;

Udhëzimit i MF nr. 2, datë 02.06.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar;

Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 5, datë 27.02.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura” ndryshuar me udhëzimin nr. 5/1 datë 21.05.2014.

Udhëzimi i MF nr. 10/1, datë 28.02.2017 “Për përgatitjen e buxhetit vendor”;

Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetëqeverisjes vendore”;

Në fushën e mbajtjes Kontabilitetit dhe Hartimit të Pasqyrave Financiare:

VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”;

Udhëzimi i MF nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar me UMFE nr. 5, datë 21.2.2022, etj.;

Në fushën e administrimit të taksave dhe tarifave vendore:

Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar”;

Ligji nr. 9632, datë 30/10/2006 “Për Sistemin e Taksave Lokale”, i ndryshuar;

VKM nr. 170, datë 25.4.2002 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”, me ndryshime;

VKM nr. 1064, datë 22.12.2010, “Për disa ndryshime në VKM nr. 391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”;

Udhëzim i MF nr. 24, datë 02.9.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

6. Dokumentimi i rezultateve të auditimit:

Audituesit e KLSH, mbi bazën e evidencave dhe dokumentacionit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion, si dhe intervistave, takimeve, konsultave dhe komunikimeve me stafin, kanë përgatitur dokumentacionin e mjaftueshëm të auditimit, si rezultat i kuptimit të qartë të kriterëve të përdorura, të fushë-veprimit të auditimit; të përfundimeve të arritura mbi bazën e programit të auditimit dhe natyrën, kohën, shtrirjen dhe rezultatet e procedurave të kryera; arsyetimin pas të gjitha çështjeve të rëndësishme që kërkohej për ushtrimin e gjykimit profesional, si dhe konkluzioneve lidhur me to. Në këtë mënyrë, dokumentimi i auditimit është kryer nëpërmjet letrave të punës, shënimeve, pyetësorëve, intervistave etj., të finalizuara me akt-konstatimet, të cilat kanë shërbyer si bazë për hartimin e këtij Raporti Përfundimtar Auditimi. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e mbledhura gjatë auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur vlerësimet / përfundimet dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tij.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

III.1 PËRSHKRIMI I REZULTATEVE SIPAS DREJTIMEVE TË AUDITIMIT

1. AUDITIM MBI KONTROLLIN E BRENDSHËM FINANCIAR PUBLIK.

1.1. Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK: Mjedisi i kontrollit, Menaxhimi i riskut, Veprimtaritë e kontrollit, Informimi dhe komunikimi, Monitorimi. Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike.

1.2. Organizimi i njësisë së auditit të brendshëm;

1.3. Vlerësim mbi veprimtarinë e njësisë së auditit të brendshëm.

Në zbatim të nënpikës 1.1 të programit të auditimit, u auditua dokumentacioni si më poshtë:

1. Rregullorja e brendshme e miratuar;
2. Kod i brendshëm etik ose një kod sjellje, apo udhëzim për zbatimin e etikës;
3. Strukturën organike të institucionit me ndryshimet për vitet objekt auditimi dhe nëse ka pasur ndryshime në strukturë, a është reflektuar edhe në rregullore;
4. Shkresat e përcaktimit të NA në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, Ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar;
5. Shkresat për krijimin e grupeve të Menaxhimit Strategjik;
6. Trajnimet e stafit si dhe planifikimet për trajnime të tyre;
7. Strategjinë dhe Regjistrin e Riskut;
8. Lista ose harta e proceseve të punës;
9. Raportet e Monitorimit;

10. Pyetësori i Vetëvlerësimit dhe a është dërguar në Ministrinë e Financave

Drejtimet kryesore të auditimit të MFK-së janë:

- Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK.
- Mjedisi i Kontrollit, Menaxhimi i Riskut, Veprimtaritë e Kontrollit, Informimi/ Komunikimi, si dhe Monitorimi.
- Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike që mbulon.

Në drejtim të vlerësimit të implementimit të komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm në Bashkinë Dimal, nga grupi i auditimit janë kryer verifikimet për implementimin dhe plotësimin e kërkesave në lidhje me funksionimin, përgjegjshmërinë menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit për të gjithë komponentët si: *“Mjedisi i Kontrollit”*, *“Menaxhimi i Riskut”*, *“Aktivitetet e Kontrollit”*, *“Informimi dhe Komunikimi”* si dhe *“Monitorimi”*, sipas përcaktimit të nenit 19 të Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 *“Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”* i ndryshuar, ku titullari i njësisë në sektorin publik krijon dhe vlerëson sistemet e MFK-së nëpërmjet këtyre komponentëve të lidhur me njëri tjetrin.

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Bashkia Dimal, grupi i auditimit rezulton me këto konstatime:

- Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK.

Në drejtim të vlerësimit të implementimit të komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm në Bashkinë Dimal, nga grupi i auditimit janë kryer verifikimet për implementimin dhe plotësimin e kërkesave në lidhje me funksionimin, përgjegjshmërinë menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit për të gjithë komponentët si: *“Mjedisi i kontrollit”*, *“Menaxhimi i riskut”*, *“Aktivitetet e kontrollit”*, *“Informimi dhe Komunikimi”* si dhe *“Monitorimi”*, në referim të nenit 19 të Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 *“Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”* i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015 *“Për disa shtesa dhe ndryshime”*, ku titullari i njësisë në sektorin publik krijojnë dhe vlerësojnë sistemet e MFK-së nëpërmjet këtyre komponentëve të lidhur me njëri- tjetrin. Thelbi i MFK-së ka të bëjë me menaxhimin dhe kontrollin e të ardhurave, shpenzimeve, aktiveve, detyrimeve, procedurave të tenderimit dhe kontraktimit si dhe mënyrës së funksionimit të njësisë.

Komponenti “Mjedisi i Kontrollit”:

Në lidhje me parimin 1 “Angazhimin për integritet dhe vlerat etike”.

-Mjedisi i kontrollit është një element i menaxhimit financiar dhe kontrollit, i cili siguron vendosjen e objektivave në përmbushjen e misionit të institucionit. Mjedisi i kontrollit përmban: a) integritetin personal dhe etikën profesionale të nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të njësisë publike; b) politikat menaxheriale dhe stilin e punës; c) strukturën organizative, garantimin e ndarjes së detyrës, hierarkinë dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit; ç) politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore; d) aftësitë profesionale të punonjësve.

-Nga shqyrtimi i Strukturës dhe Organigramës së Bashkisë Dimal në Rregulloren e saj, u konstatua se në disa raste ka mbivendosje dhe mbingarkesë kompetencash.

-Në pikën 11 të Rregullores, ku përshkruhet përbërja e strukturës së Drejtorisë së Planifikimit të Territorit, Kontrollit të Projekteve, Shërbimeve Publike, Transportit, Administrimit të Ujërave, Diasporës, Migracionit dhe Integritit European, si dhe përgjegjësitë dhe detyrat e kësaj drejtorie

së bashku me punonjësit e saj, vihet re një mbingarkesë e detyrave dhe kompetencave të kësaj drejtorie, duke qenë se pjesë e saj janë dhe specialistë të integritit evropian dhe specialistë për çështjet e diasporës, migracionit dhe integritit evropian. Këto dy pozicione jo vetëm që kanë përgjegjësi e detyra të ngjashme me njëra tjetrën, por nuk përshtaten me profilin dhe përshkrimin e punës së kësaj Drejtorie. Këto dy pozicione do të ishin më përshtatshme në Drejtorinë Juridike dhe sektorët e saj.

-Në Drejtorinë e sipërcituar parashikohet pozicioni i punës Specialist për Ujitjen dhe Kullimin, i cili parashikon disa detyra dhe përgjegjësi mbi ujitjen, vaditjen dhe rindërtimin e sistemeve të tyre në rast dëmtimi të tyre. Në Drejtorinë e Asistencës ndaj Fermerit, Mjedisit, Shërbimit Pyjor, Mbrojtjes Konsumatore dhe Shërbimit Veterinar, Sektori për Bujqësinë, Asistencën e Fermerit dhe Administrimin e Ujrave, është parashikuar specialisti Administrimit të Ujrave, i cili konkretisht mbikqyr dhe kontrollon punën e Specialistit për Ujitjen, pjesë e strukturës së Drejtorisë së Planifikimit të Territorit. Për të mos ngarkuar strukturën e Drejtorisë së Planifikimit të Territorit, si dhe për të lehtësuar e thjeshtëzuar punën në shërbimin ndaj qytetarëve, do të duhej që pozicioni i Specialistit të Ujitjes të vendosej në Sektorin e Administrimit të Ujrave në Drejtorinë e Asistencës së Fermerit Mjedisit, Shërbimit Pyjor, Mbrojtjes Konsumatore dhe Shërbimit Veterinar. Këto dy drejtori mbajnë në emërtesën e tyre funksionin e Administrimit të Ujrave, duke ndërlikuar ushtrimin e detyrave dhe përgjegjësi të përcaktuar në Rregulloren e institucionit.

-Për vitin 2023, Bashkia Dimal ka miratuar Strukturën dhe Organigramën e saj me Urdhërin e Kryetarit nr. 571 datë 01.09.2023, ku përcaktohet numri i përgjithshëm i punonjësve të Bashkisë prej 299 punonjësish, nga të cilët 210 punonjës të Bashkisë, 85 funksione të transferuar, 4 funksione të deleguar, dy të zgjedhur, 7 staf politik (këshilltarë të Kryetarit), 57 pozicione pune të shërbimit civil, 233 pozicione pune të rregulluar me Kodin e Punës.

-Për vitin 2023, Bashkia Dimal ka ushtruar veprimtarinë e saj nëpërmjet Rregullores së brendshme të institucionit. Bashkia nuk ka një Kod Etike të hartuar dhe miratuar si një dokument të veçantë, por dispozitat që rregullojnë etikën dhe disiplinën e administratës së institucionit janë integruar në Rregulloren e institucionit. Në bazë të pyetësorit dërguar njësisë të menaxhimit, nuk ka një urdhër nga titullari i institucionit për njohjen dhe trajnimin e stafit me rregulloren dhe bazën ligjore në fuqi. Komunikimi për rregulloren e brendshme dhe dispozitat përkatëse për etikën dhe disiplinën është kryer nëpërmjet postës elektronike.

-Bashkia Dimal ka hartuar dhe krijuar Rregulloren “Për Hetimin Administrativ të Sinjalizimit dhe Konfidencialitetin me akt nr. 356 prot. Dt 28.12.2017 dhe Rregulloren “Për Hetimin Administrativ dhe Kërkesën e Sinjalizuesit për Mbrojtjen nga Hakmarrja”, si dhe është krijuar Njësia e Sinjalizimit të Brendshëm të përbërë nga dy punonjës me Urdhër nr 405, dt. 20.12.2016, i ndryshuar me nr 3051 dt. 13.12.2018 të Kryetarit të Bashkisë. Për ndëshkimin e rasteve ndiqen procedurat e masave disiplinore të parashikuara në legjislacionin për shërbimin civil dhe kodin e punës.

-Sipas Rregullores së institucionit, ankesat nga qytetarët mund të depozitohen zyrtarisht pranë institucionit (në sektorin e marrëdhënieve me publikun). Rregullorja përcakton se përgjigjet lidhur me ankesat e paraqitura siglohen nga specialisti, drejtuesi i njësisë së menaxhimit dhe drejtori i përgjithshëm e me pas firmosen nga Kryetari i Bashkisë. Përveç dorëzimit të ankesave në Sektorin e Marrëdhënieve me Publikun, Rregullorja e Institucionit në nenin 15 të saj parashikon se qytetarët kanë të drejtë të takojnë personalisht Kryetarin e Bashkisë për problemet e tyre, në ditët dhe orët e përcaktuar specifikisht në Rregullore.

Në lidhje me parimin nr 2 “Titullari demonstroi pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikqyrje”.

-Për periudhën vitin 2023, janë hartuar raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit për çdo 4-muaj, duke u paraqitur MFE.

-Këshilli bashkiak me kompetencat e tij ushtron përgjegjësitë e mbikqyrjes dhe kontrollit të veprimtarisë së bashkisë.

Në lidhje me parimin 3 “Titullari/NA krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë”.

-Bashkia Dimal nuk ka një plan strategjik për veprimtarinë vjetore ose të viteve në vijim.

-Nuk është hartuar dhe miratuar në dokument të veçantë deklarata e misionit.

--Bashkia Dimal nuk ka një plan strategjik për veprimtarinë vjetore ose të viteve në vijim.

-Nuk është hartuar dhe miratuar në dokument të veçantë deklarata e misionit.

Për çdo drejtori janë përcaktuar objekti, qëllimi, detyrat dhe përgjegjësitë sipas hierarkisë në nivel drejtori, përgjegjës sektori dhe specialist.

Në lidhje me parimin 4 “Njësia publike demonstroi angazhimin në realizimin e kompetencave”.

Punësimi në Bashkinë e Dimal bëhet në zbatim të Ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe Ligjit nr.7961 /1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, VKM nr.243/2015 i ndryshuar me VKM nr.746/2018 Kreu I pika 1,2. Kjo procedurë rregullohet nga Strukturat e Bashkisë së Dimal:

-Drejtorja e Burimeve Njerëzore është përgjegjëse për zbatimin e hapave të procedurës së punësimit sipas nenit 10 pika 1 e Ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe VKM nr.243/2015 i ndryshuar Kreu II;

-Komiteti i Përhershëm i Pranimit [KPP] në zbatim të përcaktimeve në Kreun III të VKM nr.243/2015 i ndryshuar ;

-Kryetari i Bashkisë në zbatim të nenit 64 pika e,ë,f,g të Ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”.

-Strukturat përgjegjëse të Bashkisë së Dimal hartojnë në fillim të çdo viti Planin vjetor të pranimit në shërbimin civil duke zbatuar Ligjin nr.152/2015 “Për nëpunësin civil” neni 18, VKM nr. 108/2014 “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil”, VKB “Mbi miratimin e numrit maksimal të punonjësve dhe nivelit të pagave të tyre” si dhe Vendimeve të Kryetarit “Për miratimin e strukturave organizative të Bashkisë Dimal” për çdo vit ushtrimor.

-Punonjësit e Bashkisë Dimal trajnohen në bazë të kalendarit të trajnimeve vjetore të ASPA, për ata punonjës që të cilët janë punësuar sipas dispozitave të Ligjit për Nepunësin Civil. Bashkia Dimal nuk ka një plan trajnimesh të brendshme, për rrjedhojë as një buxhet trajnimesh për punonjësit e shërbimit civil apo punonjësit marrëdhënia e punës e të cilëve rregullohet me anë të Kodit të Punës. Mungesa e një plani të brendshëm trajnimesh bie në kundërshtim me Kreun III, paragrafin 3.1 të Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollin.

-Për vitin 2023 janë larguar 28 punonjës, ndërsa janë rekrutuar 33 punonjës. Të dhëna tabelore paraqiten në kapitullin e anekseve.

-Për Bashkinë Dimal, Koordinatorja e Riskut është znj. I.M .

-Nëpunësi Zbatues për zbatimin e programit buxhetor është zonja M.B, e cila mban pozicionin si Drejtor i Drejtorisë Ekonomike dhe Financave.

- *Krijimi i grupeve të menaxhimit strategjik (GMS).*

Në zbatim të nenit nr. 24 të ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor”, i ndryshuar; ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; ligji nr. 68/2017 datë

27.04.2017“Për financat e vetëqeverisjes vendore”,ligjit nr.10296 datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar dhe Udhëzimin e MFE nr.23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte për përgatitjen e PBA të njësive të Qeverisjes Vendore”,është ngritur GMS ku është miratuar draft-projekti PBA 2023-2025, projekt-buxheti për vitin 2023, si dhe deklarata e cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm dhe raporte për funksionimin e kontrollit të brendshëm. . Lidhur me përbërjen e GMS, në përgjithësi ajo është sipas përcaktimit të bërë në pikën 30 të Udhëzimit nr.23, datë 30.07.2016 “Për procedurat standarte për përgatitjen e PBA të njësive të Qeverisjes Vendore”, ku drejtuesi i grupit është Kryetari i Bashkisë, si dhe ka përfaqësues nga të gjitha drejtoritë dhe sektorët e Bashkisë.

Nga verifikimi i veprimtarisë së Grupit të Menaxhimit Strategjik(GMS) rezultoi se:

-Bashkia Dimal nuk ka miratuar plan pune vjetor lidhur me funksionimin e Grupit për Menaxhimin Strategjik” në kundërshtim me Udhëzimin nr. 15 dt 20.07.2016 për Koordinatorin MFK dhe koordinatorin e riskut në njësinë publike, pika 2.3.

- Procesverbalet e Mbledhjeve të GMS përgjatë vitit 2023 janë të paprotokolluara, si dhe u konstatua mungesa e firmave të disa anëtarëve të GMS, duke ardhur kështu në kundërshtim me nenin 18 të Normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në republikën e shqipërisë.

II.Komponenti“Menaxhimi i Riskut”

Në lidhje me parimin 6: Njësia Publike specifikon objektivat si bazë për identifikimin dhe vlerësimin e risqeve në lidhje me realizimin e tyre.

-Nga Bashkia Dimal përcaktohen objektiva sasiore (vlerë monetare) vetëm në hartimin e PBA-ve dhe buxheteve vjetore. Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion, konstatohet se nuk është hartuar plani i përgjithshëm strategjik të zhvillimit afatmesëm të Bashkisë Dimal, sipas përcaktimit të bërë në nenin 32 të Ligjit nr.68/2017 “Për financat e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”.

Në lidhje me parimin 7: “Njësia Publike identifikon dhe analizon risqet për arritjen e objektivave.

-Bashkia Dimal ka hartuar dhe ka miratuar regjistrin e riskut.

-Në Bashkinë Dimal nuk është hartuar dhe miratuar strategjia e menaxhimit të riskut, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 15 dt 20.07.2016 pika 3.2.3, si dhe në kundërshtim me në kundërshtim me nenin 21, pika 2 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”

-Përcaktimi i NA dhe NZ është bërë në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, ligjin “Për menaxhimin e sistemit buxhetor të RSH”, si dhe ligjit nr. 90 datë 27.09.2012 “Për organizimin e administratës shtetërore” si dhe janë njoftuar Njësia Qendrore e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në Ministrinë e Financës Nëpunësi Autorizues dhe Zbatues plotësojnë kriteret e kërkuara nga ligji si: (kriteri i varësisë NA-NZ, kriteri i arsimimit dhe kriteri i nivelit menaxherial).

III. Komponenti: “ Aktivitetet e Kontrollit”

Në lidhje me parimin 10: “Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitetet kontrolli”.

-Në Rregulloren e Brendshme në mënyrë të përgjithshme dhe për çdo strukturë, krahas detyrave, janë të identifikuar edhe proceset e punës.

-Urdhër shpenzimet nënshkruhen nga nëpunësi Autorizues dhe Njësia Zbatues.

-Bashkia Dimal nuk ka hartuar “Planin e Veprimtimit të Kontrollit për Kontrollin e Brendshëm” në kundërshtim me paragrafin 3.3, Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin.

-Kontrolli i dokumentacionit dhe pranimit të tij para njohjes së shpenzimit në kontabilitet kryhet nga Drejtori i Drejtorisë Ekonomike dhe Financiare (NZ). Kontabilizimi i transaksioneve financiare kryhet nga Drejtori i Drejtorisë Ekonomike, hartimi dhe regjistrimi i pagesës kryhet nga specialistët e Sektorit të Financës, ndërsa Autorizimi i pagesës nga NA.

-Për prokurimet nga NA kanë dalë urdhërat e krijimit dhe funksionimit, komisionit të përlogaritjes së fondit limit dhe specifikimeve teknike, njësia e prokurimit, komisioni i vlerësimit të ofertave, komisioni i blerjeve të vogla, komisioni i marrjes në dorëzim të mallrave/punimeve/shërbimeve.

- Për çdo vit buxhetor hartohet regjistri i planit dhe realizimit të prokurimeve

-Në Rregulloren e Brendshme për dokumentacionin e financës nuk parashikohet dhe specifikohet ndonjë rregull i veçantë, por veprohet në bazë të legjislacionit për arkivat.

-Për menaxhimin e aktiveve veprohet në bazë të Udhëzimit nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, në bazë të cilit është mbajtur regjistri i aktiveve, i cili përditësohet çdo vit për ndryshimet e pësuar si për shtesat dhe pakësimet. Aktivitet afatgjatë dalin në përdorim në bazë urdhër-dorëzimeve nga personi i autorizuar dhe për të janë hapur kartelat e Zyrate dhe kartelat personale të konfirmuar nga përgjegjësi.

-Të ardhurat arkëtohen nëpërmjet Bankave të nivelit të dytë në llogarinë e Thesarit për Bashkinë Dimal.

-Bashkia Dimal në bashkëpunim me Degën e Thesarit, kryen kontrollin e disponibiliteteve monetare, kontrolli i angazhimeve, menaxhimi i investimeve sipas planit kontraktual të pagesave dhe gjendjen limit të arkës, ku për çdo transaksion merret konfirmimi i Degës së Thesarit për gjendjen e disponibiliteteve, dhe bëhet çelja e fondeve me shkresë nga Bashkia.

-Titullarja e Bashkisë Dimal nuk ka miratuar gjurmën e auditimit. Kjo bie në kundërshtim me nenin 16 pika 2 të Ligjit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin.

Në lidhje me parimin 11: “Njësi publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete të kontrollit të përgjithshme të kontrollit të teknologjisë”.

-Bashkia Dimal nuk ka procedurë të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT. Jo çdo sistem ka procedurën e vet të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara.

-Bashkia Dimal nuk ka një sistem elektronik back-up për të dhënat e institucionit.

-Në rregulloren e brendshme përcaktohen detyrat e specialistit të IT. Aktualisht Bashkia Dimal nuk ka një punonjës IT që të mbulojë këtë aspekt në institucion.

-Nuk ka manuale të përdorimit të sistemit të IT.

Në lidhje me parimin 12: “Njësi publike vendos aktivitetet e kontrollit përmes politikave dhe procedurave”.

-Në rregulloren e brendshme janë përcaktuar dhe ndarë detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorëve dhe Përgjegjësve të sektorëve, ku vihen re mbivendosje/mbingarkesë të funksioneve.

-Me vlerësimin, përzgjedhjen, kostimin dhe monitorimin e investimeve merret Drejtoria Ekonomike dhe Financave, duke iu referuar dispozitave ligjore në fuqi dhe rregullores së brendshme.

- Ekzistojnë procedurë kontrolli të integritetit të të dhënave financiare, pasi nga përgjegjësit e kontabilitetit kryhen kontrole dhe rregullime në lidhje me veprimet e kryera nga specialistët përkatës të kontabilizimeve e mbajtjeve ditareve, hartime PF, rakordimet me thesarin e bankat e nivelit të dytë, hartime listë-pagesave, urdhër-shpenzimeve e veprime të tjera, pastaj kontrollohen nga Drejtori. PF konfirmohen nga NA dhe NZ. Këto procedurë janë të përfshira në detyrat dhe përgjegjësitë të gjitha nivelet e Drejtorisë Ekonomike dhe Financave.

IV. Komponenti: “Informimi dhe Komunikimi”

Në lidhje me parimin 13:

Bashkia Dimal disponon faqen e saj të ëeb-it www.bashkiadimal.gov.al

Në këtë web faqe pasqyrohet aktiviteti i saj si Rregullorja e Brendshme, broshura, planet e performancës, projekte të brendshme dhe të huaja, bashkëpunime brenda dhe jashtë vendit, aktivitete, struktura organike, vendimet e këshillit bashkiak, buxheti vjetor, publikime të ndryshme e shumë të dhëna të tjera nga veprimtaria e bashkisë. Të gjithë drejtuesit e programeve kanë informacion mbi miratimet e buxheteve, alokimet dhe rialokimet që ndodhin gjatë vitit buxhetor si dhe realizimet në fakt të shpenzimeve. Nuk janë përditësuar raportet periodike apo publikimet vjetore për performancën e bashkisë në lidhje me shërbimet e ofruara publikut, planifikimin dhe realizimin e prokurimeve, raporte të auditimit, institucionet e varësisë, nuk përditësohet informacioni mbi ndryshimet në strukturën e bashkisë, paketat fiskale.

-Çdo drejtori ka e-mail zyrtar dhe është e përcaktuar apo menaxhohet nga Drejtori i Drejtorisë.

-Komunikimi me publikun, ankesat dhe kërkesat për informacion menaxhohen nga organet e parashikuara në Rregulloren e brendshme.

Në lidhje me parimin 14: Njësia publike përdor komunikimin e brendshëm verbal, shkresor dhe atë elektronik, i cili rregullohet në nenin 35 të Rregullores së brendshme.

V. Komponenti: “Monitorimi dhe Raportimi”

Në lidhje me parimin 16: “Njësia publike përzgjedh, zhvillon dhe kryen vlerësime të vazhdueshme”.

- Proçedura tperiodike të raportimit që rregullojnë zbatimin dhe monitorimin e objektivave në këtë institucion konsistojnë në planet mujore dhe vjetore të punës, analizat për aktivitetin bashkisë. Raportimet e drejtuesve të sektorëve dhe drejtorive bëhen në me shkresa dhe në mënyrë verbale drejtuar eprorëve.

-Monitorimi i progresit lidhur me arritjen objektivave dhe analiza e shkaqeve për dështimet e mundshme nga ana e drejtuesve të programeve buxhetore e lidhin me monitorimin e zbatimit të buxhetit, dokument i cili duhet hartohet cdo 4 muaj, dhe është dorëzuar brenda afateve në MFE.

-Procesi i vlerësimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm realizohet nëpërmjet procesit të vetëvlerësimit të menaxherëve e strukturave, hartimit e deklaratës mbi cilësinë e kontrollit të brendshëm, si dhe me anë të njësisë të auditimit të brendshëm, e cila vepron sipas një plani vjetor dhe strategjik të miratuar nga titullari i institucionit.

-Bashkia Dimal lidhur me pyetësin e vetëvlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe deklaratën e cilësisë, ka raportuar në MFE për vlerësimin e sistemeve për vitin 2023 me shkresën përcjellëse me nr. prot 585/1 datë 27.02.2024. Raporti i Cilësisë së Sistemeve të Kontrollit të Brendshëm paraqet në mënyrë të përmbledhur problematikat në 5 komponentët e MFK dhe është deri diku në përputhje me problematikat e evidentuara në këtë akt konstatimi. Të pesta elementet e MFK janë trajtuar në Raport, së bashku me çfarë është menduar të zgjidhet dhe organet përgjegjëse për problematikat e caktuara.

Në lidhje me parimin 17: “Njësia publike vlerëson dhe komunikon mangësitë”.

- Sipas kontakteve me menaxhimin dhe pyetësorëve nuk ka raportime apo ankesa për çështje të kontrollit të brendshëm

Konkluzion: Në pikën 11 të Rregullores, ku përshkruhet përbërja e strukturës së Drejtorisë së Planifikimit të Territorit, Kontrollit të Projekteve, Shërbimeve Publike, Transportit, Administrimit të Ujërave, Diasporës, Migracionit dhe Integritimit European, si dhe përgjegjësitë dhe detyrat e kësaj

drejtorie së bashku me punonjësit e saj, vihet re një mbingarkesë e detyrave dhe kompetencave të kësaj drejtorie, duke qenë se pjesë e saj janë dhe specialistë të integritit europian dhe specialistë për çështjet e diasporës, migracionit dhe integritit europian. Këto dy pozicione jo vetëm që kanë përgjegjësi e detyra të ngjashme me njëra tjetrën, por nuk përshtaten me profilin dhe përshkrimin e punës së kësaj Drejtorie. Këto dy pozicione do të ishin më përshtatshme në Drejtorinë Juridike dhe sektorët e saj. Në Drejtorinë e sipërcituar parashikohet pozicioni i punës Specialist për Ujitjen dhe Kullimin, i cili parashikon disa detyra dhe përgjegjësi mbi ujitjen, vaditjen dhe rindërtimin e sistemeve të tyre në rast dëmtimi të tyre. Në Drejtorinë e Asistencës ndaj Fermerit, Mjedisit, Shërbimit Pyjor, Mbrojtjes Konsumatore dhe Shërbimit Veterinar, Sektori për Bujqësinë, Asistencën e Fermerit dhe Administrimin e Ujrave, është parashikuar specialisti Administrimit të Ujrave, i cili konkretisht mbikqyr dhe kontrollon punën e Specialistit për Ujitjen, pjesë e strukturës së Drejtorisë së Planifikimit të Territorit. Për të mos ngarkuar strukturën e Drejtorisë së Planifikimit të Territorit, si dhe për të lehtësuar e thjeshtëzuar punën në shërbimin ndaj qytetarëve, do të duhej që pozicioni i Specialistit të Ujitjes të vendosej në Sektorin e Administrimit të Ujrave në Drejtorinë e Asistencës së Fermerit Mjedisit, Shërbimit Pyjor, Mbrojtjes Konsumatore dhe Shërbimit Veterinar. Këto dy drejtori mbajnë në emërtesën e tyre funksionin e Administrimit të Ujrave, duke ndërlikuar ushtrimin e detyrave dhe përgjegjësi të përcaktuar në Rregulloren e institucionit. Bashkia Dimal nuk ka një plan strategjik për veprimtarinë vjetore ose të viteve në vijim. Nuk është hartuar dhe miratuar në dokument të veçantë deklarata e misionit. Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Bashkia Dimal, nuk ka hartuar një plan të brendshëm trajnimesh për punonjësit e këtij institucioni. Bashkia Dimal nuk ka miratuar plan pune vjetor lidhur me funksionimin e Grupit për Menaxhimin Strategjik”. Procesverbalet e mbledhjeve të GMS përgjatë vitit 2023 janë të paprotokolluara, si dhe u konstatua mungesa e firmave të disa anëtarëve të GMS. Bashkia Dimal nuk ka hartuar planin e përgjithshëm strategjik të zhvillimit afatmesëm për institucionin. Në Bashkinë Dimal nuk është hartuar dhe miratuar strategjia e menaxhimit të riskut. Bashkia Dimal nuk ka hartuar “Planin e Veprimit për Kontrollin e Brendshëm”. Bashkia Dimal nuk ka procedurë të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT. Jo çdo sistem ka procedurën e vet të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara, si dhe nuk ka një sistem elektronik back-up për të dhënat e institucionit. Në rregulloren e brendshme përcaktohen detyrat e specialistit të IT, por nuk ka një punonjës IT që të mbulojë këtë aspekt në institucion. Nuk ka manuale të përdorimit të sistemit të IT.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në republikën e shqipërisë, neni 18, Ligji nr.68/2017 “Për financat e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”, neni 32; Udhëzimi nr. 15 dt 20.07.2016 pika 3.2.3; Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”. neni 21, pika 2

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

Z. J.M, kryetar i Bashkisë Dimal,

Znj.I.D, me detyrë përgjegjës i sektorit të financës/ Koordinator i Riskut,

Znj. B.B ish-Drejtor i Burimeve Njerëzore.

2.1.2. Mbi funksionimin e Njesisë së Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Dimal

Në zbatim të pikave 1.2 dhe 1.3 të programit të auditimit “nr. 358/1prot., datë 13.03.2024, u auditua dokumentacioni si më poshtë:

1. Karta e Auditimit të Njesisë së AB të Bashkisë Dimal;

2. Planet Strategjike dhe vjetore, si dhe pasqyrat shoqëruese;
3. Plani i auditimeve të brendshme për vitin 2023;
4. Raportimi vjetor në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditit të Brendshëm;
5. Dosjet e përhershmet e subjektevetëaudituar;
6. Projekt-raportet dhe raportet përfundimtare të auditimit të brendshëm të njësive publike;
7. Rekrutimi i punonjësve në Njësinë e Auditit të Brendshëm, dhe ngritja e nivelit profesional të tyre.

Në bazë të VKM nr.83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kritereve të krijimit të Njësive të Auditit të Brendshëm në Sektorin Publik”, është krijuar njësia e Auditit të Brendshëm, e cila është e organizuar në nivelin e Sektorit të Auditit të Brendshëm duke përmbushur detyrimin ligjor të pavarësisë, i parashikuar nga Standardi Atributiv nr.1100 i Institutit Ndërkombëtar të Auditëve të Brendshëm. Ky sektor përgjatë periudhës 2023, është organizuar dhe ka funksionuar në zbatim të Vendim Këshillit Bashkiak nr.4, datë 02.02.2017, duke pasur në strukturën e saj tre punonjës. Përgjegjësi i kësaj njësie është z. Q.M. Struktura e njësisë AB për periudhën 2023

| 2023 | Funksioni | Arsimimi | Vjetërsi ne pune | Vjetërsi në auditim/vite | Çertifikimi |
|------|-------------|----------|------------------|--------------------------|---------------|
| Q.M | Përgjegjës | i lartë | 39 | 7 | i certifikuar |
| V.SH | Specialiste | i lartë | 9 | 6 | në proces |
| L.B | Specialiste | i lartë | 6 | 4 | në proces |

Përgjatë periudhës Janar-Dhjetor 2023, nga sektori i auditit të brendshëm pranë Bashkisë Dimal, janë kryer 7 kryer auditime.

Plani Strategjik 2023-2025 dhe plani vjetor i auditimeve për vitin 2023 është përcjellë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, me shkresën nr.2712/1 datë 13.10.2022.

Për aktivitetin e veprimtarisë së Struktues së Auditimit të Brendshëm për vitin 2023 është raportuar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, me shkresën nr.381/1 datë 09.02.2024.

Karta e auditimit të brendshëm është përgatitur dhe miratuar nga Titullari i Bashkisë Dimal me urdhrin nr.5720 prot., datë 20.11.2018.

Nga auditimi i raportimit për vitin 2023, rezulton se janë dhënë 36 rekomandime, nga të cilat janë pranuar të gjitha. Nga 36 rekomandime janë zbatuar 7 rekomandime, ndërkohë janë në proces zbatimi 7 rekomandime.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion u konstatua se:

-Nuk është ngritur Komiteti i Auditimit të Brendshëm, në kundërshtim me nenin 13 të Ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”

-Karta e Auditimit të Brendshëm është hartuar në përputhje me formatin e paraqitur në Manualin e Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhërin nr.4, datë 10.01.2020 të Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë “Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në Manualin e Auditimit të Brendshëm, miratuar me urdhërin nr.100, datë 25.10.2016”;

-Plani strategjik është përgatitur dhe dërguar në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm për vitet 2023-2025, dhe është hartuar në përputhje me standardet e

përcaktuar në MAB, Kapitulli III, pika 3.1.6 dhe aneksin me modelin përkatës në fundin e kapitullit III.

-Plani vjetor i auditimeve për vitin 2023 është përgatitur në mënyrë të rregullt, në përputhje me paragrafin 3.2 të Kapitullit III të MAB, si dhe me modelet përkatëse në po këtë kapitull.

-Për vitin 2023, konstatohet se janë mbuluar me auditim 6 subjekte si dhe është realizuar një auditim tematik në Drejtoritë dhe Sektorët e Bashkisë Dimal, për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve nga vitit ushtrimor paraardhës. Të dhënat tabelare në kapitullin e anekseve.

-Struktura e projekt-raporteve dhe raporteve përfundimtare pjesë e dosjeve të auditimit të zhvilluar në vitin 2023, nuk është hartuar plotësisht në përputhje me urdhërin nr, 4 dt. 10.10.2020 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Në dosjet e auditimit të realizuar përgjatë vitit 2023, nuk janë bërë pjesë e Raportit Përfundimtar të Angazhimit, rubrikat e parashikuara si pjesë e Përmbledhjes Ekzekutive:

1) Rezultatet e auditimit

2) Opinioni mbi vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm.

-Nga verifikimi i Raporteve Përfundimtare të Angazhimit pjesë e dosjeve të auditimit u konstatua mungesa e rubrikës “Opinion i Përgjithshëm” në kundërshtim me përcaktimet e Urdhërit nr, 4 dt. 10.10.2020 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

-Dosjet e auditimit të brendshëm të njësive publike nuk arkivohen në arkivin e njësisë vendore në kundërshtim me nenin 19 pika 1 e Normave Tekniko Profesionale të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë.

-Njësia e Auditit të Brendshëm nuk ka çelur manualisht dhe elektronikisht dosjet e përhershme mbi njësitë e menaxhimit, duke rënë në kundërshtim me Manualin e Auditimit të Brendshëm, Kreu 6, paragrafin 6.3.

-Nuk është bërë pjesë e dosjes së auditimit njoftimi që duhet të kryejë grupi i auditimit për titullarin e njësisë publike, në rastet kur subjekti i audituar nuk njofton për planin e masave në kundërshtim me përcaktimet e MAB, pika 4.1.12.

-Në dosjet e auditimit të realizuar nga Njësia e Auditimit nuk është dokumentuar plani i veprimit, i cili duhet të realizohet nga subjekti i audituar në vazhden e rekomandimeve të lëna nga grupi i auditimit. Edhe pse vërtetohet se grupi i auditimit të brendshëm ka lënë për detyrë hartimin e një plani veprimi për zbatimin e rekomandimeve, nga verifikimi fizik i disa prej dosjeve të përzgjedhura u konstatua mungesa e planeve të veprimit nga ana e subjekteve të audituara. Duke qenë se plani i veprimit nga ana e subjektit të audituar është fillimi i procesit të ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve nga ana e NJAB, duhet të ishte bërë një punë më këmbëngulëse nga kjo njësi për ecurinë e këtij procesi. Në dosjet e auditimit nuk janë konstatuar shkresa rikujtuese nga ana e përgjegjësit të njësisë së auditimit drejtuar njësive të menaxhimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna. Këto mosveprime bien në kundërshtim me Kreun IV paragrafi 4.1.13.1 të Manualit për Auditimin e Brendshëm

Konkluzion: Bashkia Dimal nuk ka parashikuar në strukturën e saj, Komitetin e Auditimit të Brendshëm. Struktura e projekt-raporteve dhe raporteve përfundimtare pjesë e dosjeve të auditimit të zhvilluar në vitin 2023, nuk është hartuar plotësisht në përputhje me urdhërin nr, 4 dt. 10.10.2020 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Në dosjet e auditimit të realizuar përgjatë vitit 2023, nuk janë bërë pjesë e Raportit Përfundimtar të Angazhimit, rubrikat e parashikuara si pjesë e Përmbledhjes Ekzekutive:

1) Rezultatet e auditimit

2) Opinioni mbi vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Nga verifikimi i Raporteve Përfundimtare të Angazhimit pjesë e dosjeve të auditimit u konstatua mungesa e rubrikës “Opinion i Përgjithshëm”. Dosjet e auditimit të brendshëm të njësive publike nuk arkivohen në arkivin e njësisë vendore. Njësia e Auditit të Brendshëm nuk ka çelur manualisht dhe elektronikisht dosjet e përhershme mbi njësitë e menaxhimit. Nuk është bërë pjesë e dosjes së auditimit njoftimi që duhet të kryejë grupi i auditimit për titullarin e njësisë publike, në rastet kur subjekti i audituar nuk njofton për planin e masave. Në dosjet e auditimit të realizuar nga Njësia e Auditimit nuk është dokumentuar plani i veprimit, i cili duhet të realizohet nga subjekti i audituar në vazhden e rekomandimeve të lëna nga grupi i auditimit. Edhe pse vërtetohet se grupi i auditimit të brendshëm ka lënë për detyrë hartimin e një plani veprimi për zbatimin e rekomandimeve, nga verifikimi fizik i disa prej dosjeve të përzgjedhura u konstatua mungesa e planeve të veprimit nga ana e subjekteve të audituara. Në dosjet e auditimit nuk janë konstatuar shkresa rikujtuese nga ana e përgjegjësit të njësisë së auditimit drejtuar njësive të menaxhimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Ligjin nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, neni 13, Urdhëri nr, 4 dt. 10.10.2020 i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Normave Tekniko Profesionale të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë, neni 19 pika 1, Manuali i Auditimit të Brendshëm, paragrafi 4.1.12, Kreu 6, paragrafin 6.3, Kreun IV, paragrafi 4.1.13.1

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi:

Znj. J.M, *me detyrë Kryetar i Bashkisë Dimal,*

Z. Q.M, *me detyrë përgjegjës i Sektorit të Auditimit të Brendshëm.*

2. AUDITIM MBI PLANIFIKIMIN, ZBATIMIN DHE MONITORIMIN E PLANIT TË BUXHETIT

Në zbatim të Programit të Auditimit cituar më sipër pika 2, u auditua *planifikimi dhe zbatimi i planit të buxhetit, bazuar në ligjin organik të buxhetit të shtetit, ligji për buxhetin e shtetit të vitit 2023, si dhe aktet nënligjore mbi planifikimin, monitorimin dhe zbatimin e buxhetit.*

Dokumentacioni që u shqyrtua për auditimin e kësaj pike të programit të auditimit është si vijon:

- PBA 2023-2025
- Projekt-buxhetin e miratuar për vitin 2023;
- Vendimet e KB “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Dimal” për vitin 2023;
- Vendime të tjera të KB, në lidhje me ndryshimet buxhetore;
- Situacionet e shpenzimeve për vitin 2023 rakorduar me Degën e Thesarit;
- Situacionet e të ardhurave për vitin 2023 rakorduar me Degën e Thesarit;
- Raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit;
- Raportimet në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë lidhur me detyrimet e prapambetura të Bashkisë Dimal;
- Informacion shkresor i përgatitur nga subjekti bazuar në kërkesat e hartuara nga grupi i auditimit.

Përgatitja e Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025

Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025, janë ndërmarrë brenda afateve hapat në vijim:

Me VKB nr. 11, datë 28.02.2022 është miratuar raporti i vlerësimeve dhe parashikimeve afatmesme të të ardhurave, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut me shkresë nr. 176/1, datë 03.03.2022;

Me VKB nr. 28, datë 23.05.2022 janë miratuar Tavanet Përgatitore, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut me shkresë nr. 396/1, datë 01.06.2022;

Me VKB nr. 37, datë 04.07.2022, janë miratuar Tavanet përfundimtare, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut me shkresë nr. 498/1, datë 07.07.2022.

Me VKB nr. 84, datë 27.12.2022 është miratuar Programi Buxhetor Afatmesëm 2023-2025 dhe detajimi i Buxhetit të Bashkisë Dimal për vitin 2023, me të gjitha pasqyrat përkatëse, si dhe konfirmuar nga Prefekti i Qarkut me shkresë nr. 960/1, datë 11.01.2023 dhe depozituar pranë Degës së Thesarit me shkresë nr. 93/1, datë 13.01.2023.

Në mënyrë të detajuar, Programi Buxhetor Afatmesëm 2023-2025 paraqitet në tabelat në vijim: Programimi i shpenzimeve për vitin 2023-2025 dhe i detajuar sipas programeve

| Nr. | Shpenzimet sipas programeve | Viti 2023 | Viti 2024 | Viti 2025 |
|-----|--|----------------|----------------|----------------|
| | | 000/lekë | 000/lekë | 000/lekë |
| 1 | 1110(Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi) | 96,037 | 97,240 | 98,500 |
| 2 | 3140(Sherbimet e Policise Vendore) | 7,950 | 8,500 | 9,000 |
| 3 | 3280(Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile) | 33,673 | 34,600 | 35,700 |
| 4 | 4240(Menaxhimi i infrastruktures se ujitjes dhe kullimit | 28,400 | 29,300 | 30,673 |
| 5 | 4260(Administrimi i pyjeve dhe kullotave) | 950 | 950 | 1,000 |
| 6 | 4520(Rrjeti rrugor rural) | 107,455 | 110,555 | 115,000 |
| 7 | 6140(Planifikimi Urban Vendor) | 11,500 | 11,500 | 11,500 |
| 8 | 6260(Sherbimet publike vendore) | 93,541 | 93,541 | 95,541 |
| 9 | 8130(Sport dhe arretim) | 1,000 | 1,500 | 1,500 |
| 10 | 8220(Trashëgimia kulturore) | 17,000 | 18,000 | 18,000 |
| 11 | 9120(Arsimi baze) | 70,000 | 71,000 | 71,500 |
| 12 | 9230(Arsimi i mesem i pergjithshem) | 1,700 | 1,700 | 1,700 |
| 13 | 10430(Perkujdesi Social) | 19,700 | 20,000 | 20,500 |
| 14 | 6370(Furnizimi me uje dhe kanalizime) | 2,917 | 3,500 | 4,000 |
| 15 | 5100(Menaxhimi i mbetjeve) | 2,100 | 2,100 | 2,100 |
| | TOTALI | 493,923 | 503,986 | 516,214 |

PBA 2023-2025 sipas natyrës së shpenzimeve

| Nr | Shpenzimet sipas programeve | Viti 2023 | Viti 2024 | Viti 2025 |
|----|-----------------------------------|----------------|----------------|----------------|
| 1 | Paga (600) | 188,360 | 190,635 | 193,190 |
| 2 | Sigurime (601) | 34,261 | 34,868 | 37,588 |
| 3 | Shpenzime operative (602) | 108,562 | 111,389 | 111,554 |
| 4 | Shpenzime (603) | 0 | 0 | 0 |
| 5 | Shpenzime (604) | 25,400 | 25,214 | 25,777 |
| 6 | Shpenzime (606) | 4,730 | 6,230 | 7,122 |
| 7 | Shpenzime (609) | 0 | 0 | 0 |
| 8 | Shpenzime për investime)230-231) | 132,610 | 135,650 | 140,983 |
| | Totali | 493,923 | 503,986 | 516,214 |

Tendenca e të ardhurave sipas PBA 2023-2025

| A | Të ardhurat | 2023 | 2024 | 2025 |
|---|-------------|---------|---------|---------|
| 1 | Nga taksat | 166,008 | 166,008 | 166,008 |

| A | Të ardhurat | 2023 | 2024 | 2025 |
|------------|--|----------------|----------------|----------------|
| 2 | Jo tatimore | 91,872 | 91,872 | 91,872 |
| I | Totali | 257,881 | 257,881 | 257,881 |
| 1 | Transferta e pakushtëzuar | 148,619 | 154,985 | 163,368 |
| 2 | Transferte specifike | 92,423 | 96,120 | 99,965 |
| | Tjera... | 0 | 0 | 0 |
| II | Shuma e transfertave | 241,042 | 251,105 | 263,333 |
| III | Transferta te pritshme (FZHR e tjera) | 0 | 0 | 0 |
| | Totali i burimeve të veta (I +II+III) | 498,923 | 508,986 | 521,214 |

Hartimi dhe programimi i buxhetit vjetor

Buxheti i vitit 2023 është miratuar në Këshillin Bashkiak me VKB nr. 84, datë 27.12.2022, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut me shkresën nr. 960/1, datë 11.01.2023. I detajuar planifikimi i buxhetit për vitin 2023 paraqitet në vijim:

| Planifikimi i të ardhurave 2023 | | Planifikimi i shpenzimeve 2022 | |
|--|----------------|---|----------------|
| Burimi i të ardhurave | 000/ lekë | Emërtimi i zërave | 000/ lekë |
| Të ardhura të planifikuara për vitin 2023 | 257,881 | Art. 600 Paga | 185,700 |
| Te ardhurat e veta të trashëguara nga viti i mëparshëm e të planifikuara për shpenzim për vitin 2023 | 13,178 | Art.601 Sigurime shoqërore dhe shend. | 30,713 |
| Total të ardhurat e veta | 271,059 | Art.602 Shpenzime operative | 125,075 |
| Të ardhura të trashëguara nga granti i pakushtëzuar. | 6,480 | Art.604 Transferime korrente te brendshme | 20,000 |
| Të ardhura të trashëguara nga transferta specifike | 6,342 | 606 Transferime te buxhetit familjar dhe individë | 5,425 |
| Transferta e pa kushtëzuar çelur për llogari të vitit 2023 | 164,070 | Art.230-231 Investime | 163,390 |
| Transferte specifike e çelur për llogari të vitit 2023 | 92,428 | Fondi Rezervë + Kontigjencës (609) | 10,076 |
| Total të ardhura nga transfertat e buxhetit te shtetit | 269,320 | | |
| Totali të Ardhurave | 540,379 | Totali Shpenzimeve | 540,379 |

Rezulton se buxheti i konsoliduar është miratuar i balancuar dhe pa defiçite. Të ardhurat dhe shpenzimet fillestare të miratuara janë në shumën **540,379 mijë lekë**.

-Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas Akteve Normative. Kontrolli i realizmit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura.

Ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit.

Akordimi fillestar i buxhetit dhe ndryshimet që kanë pësuar zërat e tij gjatë vitit, janë të rakorduar me Degën e Thesarit dhe janë të raportuara periodikisht pranë degës së Thesarit dhe në MFE. Situacionet e shpenzimeve janë të plotësuara sipas klasifikimit buxhetor për të gjithë periudhën e audituar. Fondet e akorduara në planet buxhetore dhe ndryshimet e bëra në periudha të ndryshme, janë evidentuar dhe janë ndjekur në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nënartikulli sipas shërbimeve dhe më vete për çdo njësi vartëse e sipas periudhave të planifikuara.

Analiza e shpenzimeve buxhetore për artikuj dhe nën artikuj është bërë periodikisht mbi bazën e situacioneve mujore të konfirmuara nga Dega e Thesarit.

Nga auditimi i të dhënave të paraqitura nga subjekti Bashkia Dimal, konstatohet se buxheti vjetor ka pësuar ndryshime gjatë vitit sipas nevojave të Bashkisë.

| Planifikimi i të ardhurave për vitin 2023 | | | | Planifikimi i shpenzimeve për vitin 2023 | | | |
|--|------------------------------------|---------------------------------|-------------------|--|------------------------------------|--------------------------------|--|
| Burimi i të ardhurave | Buxheti fillestar, miratuar me VKB | Buxheti shtesë, miratuar me VKB | Vlera në 000/lekë | Emërtimi i zërave | Buxheti fillestar, miratuar me VKB | Buxheti shtesë miratuar me VKB | Vlerat e buxhetit fillestar + buxheti shtesë (në 000/lekë) |
| | 1 | 2 | 1+2 | | 3 | 4 | 3+4 |
| Të ardhura të planifikuara për vitin 2023 | 257,881 | | 257,881 | Art. 600 Paga | 185,700 | 7,400 | 193,100 |
| Të ardhurat e veta të trashëguara nga viti i mëparshëm dhe të planifikuara për shpenzim për vitin 2023 | 13,178 | | 13,178 | Art.601 Sigurime shoqërore dhe shëndetësore | 30,713 | 635 | 31,348 |
| Total të ardhurat e veta | 271,059 | | 271,059 | Art.602 Shpenzime operative | 125,075 | 8,035 | 134,013 |
| Të ardhura të trashëguara nga granti i pakushtëzuar | 6,480 | | 6,480 | Art.604 Transferime korrente të brendshme | 20,000 | 2,846 | 22,846 |
| Të ardhura të trashëguara nga transfertat specifike | 6,342 | 2,601 | 8,943 | Art. 606 Transferime te buxhetit familjar dhe individë | 5,425 | 2,601 | 8,026 |
| Transferta e pa kushtëzuar e çelur për llogari të vitit 2023 | 164,070 | 32,921 | 196,991 | Art. 230-231 Investime | 163,390 | 15,948 | 179,338 |
| Transferta specifike e çelur për llogari të vitit 2023 | 92,428 | 2,846 | 95,274 | Fondi Rezervë + Kontigjencës (609) | 10,076 | 0 | 10,076 |
| Donacion nga UNDP | | 295 | 295 | 602 | | 295 | 295 |
| Total të ardhurat nga transfertat e buxhetit të shtetit | 269,320 | 38,368 | 307,688 | | | | |
| Totali të Ardhurave | 540,379 | 38,663 | 579,012 | Totali Shpenzimeve | 540,379 | 38,663 | 579,012 |

Të ardhurat dhe shpenzimet përfundimtare të miratuara për vitin 2023 janë në shumën **579,012 mijë lekë**.

Nga auditimi i ndryshimeve të bëra në buxhet rezulton se gjatë vitit ka patur lëvizje, por nuk shoqërohen me relacion shpjegues dhe nuk ka një analizë se si ndikojnë ndryshimet në realizimin e objektivave të synuara të Bashkisë. Ndryshimet buxhetore paraqiten si vijon:

Me VKB nr. 20, datë 14.04.2023 është miratuar një shtesë në buxhetin e vitit 2023 në masën 2,896,014 lekë përbërë nga të ardhura lokale të pa përdorura në vitin 2022;

Me VKB nr. 26, datë 14.04.2023 është miratuar është miratuar përdorimi i Fondit të Emergjencave për objektin e Shkollës Skrevan, rikonstruksionin e rrugës në Fshatin Drenovicë, si dhe Modulin IT të Emergjencave Civile;

Me VKB nr. 22, datë 31.08.2023 është miratuar një shtesë në buxhet grant i pakushtëzuar për rritjen e pagave të punonjësve mbështetës në vlerën 8,034,395 lekë, si dhe në vlerën 968,000 lekë për objektin “Mbrojtje nga gërryerjet e lumit Osum”;

Me VKB nr. 36, datë 22.11.2023 është miratuar shtesë buxheti në masën 5,000,000 lekë transfertë e pa kushtëzuar, për Sektorin e Shërbimit Publik për shlyerjen e detyrimeve të shërbimit të pastrimit;

VKB nr. 47, datë 26.12.2023 është miratuar shtesë në buxhet në masën 19,886,473 lekë transfertë e pa kushtëzuar për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura.

- Saktësia e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit.

Për zbatimin e buxhetit është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit, si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt-rakordimet përkatëse.

Gjatë vitit 2023 janë respektuar procedurat ligjore për çeljen e fondeve me Degën e Thesarit, duke pasqyruar rregullisht dhe periodikisht ndryshimet në buxhetin fillestar të realizuar me Vendim të KB, ose të diktuar nga transfertat e deleguara nga pushteti qendror, si dhe rishikimet e buxhetit e rritjet e limitit nga të ardhurat e realizuara, u konstatua se si në planifikim dhe në realizimin është respektuar disiplina buxhetore.

Pasqyra e realizimit të treguesve të buxhetit, referuar akt-rakordimet me thesarin paraqitet në tabelën e mëposhtme:

| Buxheti përfundimtar Plan-Fakt. Në 000/lekë | | | | | | | | | |
|--|---|----------------|----------------|-------------|--------------------|--|-----------------------------------|--|--|
| Nr. | Përshkrimi Shpenzimeve | Plani | Fakti | Realizimi % | Të ardhurat e veta | Burimi i financimit të shpenzimit të realizuar | | | |
| | | | | | | Nga Granti Qeveritar | | | |
| | | | | | | Transferta e pakushtëzuar | Transferta e kushtëzuar specifike | Transferta e kushtëzuar për funksionet e deleguara | Transferta e kushtëzuar për investimet |
| 1 | Paga 600 | 199977 | 186291 | 93 | 74024 | 46802 | 60715 | 4750 | 0 |
| 2 | Sigurime shoqërore 601 | 31889 | 30603 | 96 | 0 | 19560 | 10560 | 483 | 0 |
| 3 | Shp. Operat602 | 136906 | 96845 | 71 | 53762 | 22694 | 16145 | 275 | 0 |
| 4 | Fond. Emergj . 609 | 3076 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 5 | Transferta Korrente te brendshme 604 | 25338 | 8743 | 34 | 3405 | 0 | 0 | 5338.5 | 0 |
| 6 | Transferta per familje dhe individe 606 | 173149 | 169303 | 97 | 7837 | 0 | 0 | 165435 | 0 |
| 7 | Investime 230-231 | 362311 | 281888 | 77.8 | 24663 | 102923 | 400 | 0 | 150302 |
| | Totali | 932,647 | 773,673 | 83% | 163,690 | 191,979 | 91,420 | 176,181 | 150,302 |

Referuar të dhënave të pasqyrës së mësipërme, niveli i treguesve të buxhetit për vitin 2023 paraqitet i realizuar 773,673 mijë lekë nga 932,647 mijë lekë të planifikuara, ose në masën 83%. Ndër zërat e shpenzimeve që paraqiten me mos realizim, ndër më të ulët janë Transferta korrente të brendshme, realizuar në masën 34% përdorur për shpronësime dhe rehabilitime si pasojë emergjencash, si dhe shpenzime operative realizuar në masën 71%.

Peshën specifike më të madhe në buxhet ndaj totalit e zënë shpenzimet për investime në masën 36% ndjekur nga shpenzimet për paga në masën 24%.

Për këtë vit, shpenzimet e realizuara në Bashkinë Dimal, janë mbuluar nga të ardhurat e veta vetëm në vlerën 163,690 mijë lekë ose në masën 21%.

- Miratimi dhe përdorimi i fondit rezervë dhe të kontigjencës

Për vitin 2023, fondi rezervë dhe i kontigjencës është planifikuar në vlerën 201,563 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 178,046 mijë lekë, ose në masën 88%, nga ku rezulton se nuk janë përdorur fond për nevoja emergjence.

- Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të pa likuiduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve

Bashkia Dimal në planifikimin e procedurave, fillimisht duhet që në buxhet të planifikojë detyrimet e prapambetura (kreditor) gjë e cila ndodh, por që nuk mbahet në konsideratë gjatë zbatimit të tij dhe në raport me fondet e mbetura të planifikojë procedurat e domosdoshme për vitin pasardhës, kjo për të shmangur në maksimum rritjen e nivelit të kreditorëve në fund të periudhave ushtrimore.

Me fondet e vitit buxhetor 2023, janë likuiduar edhe detyrimet për fatura të palikuiduara të viteve të mëparshme, duke bërë pagesat pjesë-pjesë të detyrimeve kontraktuale sipas çeljeve të fondeve për shpenzimet e përballuara me fondet e veta, ndërsa për investimet e financuara nga Ministritë e linjës apo FZSHH, sipas fondeve të çelura për çdo vit buxhetor të përcaktuar në PBA e periudhës përkatëse në bazë të shkresave përkatëse të alokimit të fondeve.

Detyrimet e palikuiduara paraqiten më poshtë si vijon:

| Detyrimet e NQV | Detyrimi ne fillim te vitit 2023 | Shtesa 2023 | Pakesime 2023 | Detyrime ne fund te 2023 |
|-------------------|----------------------------------|--------------------|--------------------|--------------------------|
| Vendime Gjyqesore | 9,140,021 | 0 | 0 | 9,140,021 |
| Sherbime | 5,987,284 | 43,356,710 | 38,176,680 | 11,167,314 |
| Mirmbajtje | 7,440,374 | 12,818,105 | 14,471,612 | 5,786,867 |
| Investime | 223,961,553 | 115,382,678 | 151,285,632 | 188,058,599 |
| Mallra | 19,521,564 | 37,264,281 | 17,289,035 | 39,596,810 |
| Totali | 266,150,796 | 208,821,774 | 221,222,959 | 253,749,611 |

Nga auditimi konstatohet se, detyrimet e Bashkisë Dimal në fillim të vitit 2023 janë në vlerën 266,150,796 lekë, gjatë vitit 2023 janë krijuar detyrime totale në vlerën 208,821,774 lekë, ndërkohë që janë shlyer detyrime në vlerën 221,222,959 lekë duke sjellë që vlera totale e detyrimeve të Bashkisë Dimal më 31.12.2023 të jetë 253,749,611 lekë. Konkretisht më datë 01.01.2023, numri i faturave të palikuiduara ka qenë 105 fatura me vlerë 266,150,796 lekë, ndërkohë që në datë 31.12.2023 numri i faturave të palikuiduara është 85 fatura me vlerë 253,749,611 lekë. Nga verifikimi rezultoi se nga këto detyrime, 3 fatura me vlerë 89,220,684 lekë janë detyrime të krijuara nga mungesa e alokimit të fondeve nga Ministria e Infrastrukturës, pasi objekti i këtij shpenzimi është “Ndërtim i rrjetit të brendshëm dhe të jashtëm të ujësjellësit Cukalat”.

Për vitin 2023, Bashkia Dimal ka detyrime edhe nga një Vendim i hershëm gjyqësor dhe konkretisht administruar me nr. 2270 datë 05.02.2019, me objekt dëmshpërblim për shlyerje të vonuar investimi, me vlerë të vendimit 16,640,021 lekë, kreditor subjekti “GJ” ShPK, prej të cilit

gjatë vitit 2022 është likuiduar vlera 6,500,000 lekë, ndërsa vlera 9,140,021 lekë është detyrim për tu shlyer në vijim. Nga auditimi konstatohet se për periudhën objekt auditimi, Bashkia Dimal nuk ka marrë masa për shlyerjen e këtij Vendimi Gjyqësor, duke riskuar lindjen e penalteteve të tjera nga vonesat. Po kështu, rezulton se vlerën më të lartë të detyrimeve Bashkia Dimal e ka në mos shlyerjen e investimeve dhe konkretisht në masë 74% të detyrimeve, çka tregon se ka mangësi në planifikimin e projekteve për investime të cilat bëhen në mungesë të garantimit të fondeve.

- Çelja dhe ekzekutimi i fondeve për investime, saktësia e raportimit buxhetor të tyre.

Me miratimin e buxhetit vjetor janë miratuar dhe projektet për investime. Investimet kryesisht janë me burim financimi nga transfertat e pakushtëzuar dhe transfertat e kushtëzuar për investime dhe vetëm në masën 9% nga të ardhurat e veta.

Në vitin 2023 janë miratuar projektet në vijim, nga të cilët është përfunduar vetëm njëri:

- Rikonstrukcion i rrugës Sheq-Gajde me vlerë 68,767,020 lekë;
- Rikonstrukcion i rrugës Kthesa Pashallisë-Konizbaltë me vlerë 82,642,774 lekë;
- Ndërtim i godinës së shkollës Gorican me vlerë 83,996,885 lekë;
- Mbrojtje e qytetit nga përmytja dhe erozioni i Lumit Osum dhe rehabilitimi urban i kësaj zone me vlerë 6,188,400 lekë;
- Mbrojtje Lumore në fshatin Arrëz me vlerë 36,094,372 lekë.

Në UMFE nr. 26, datë 27.09.2019 “Procedura për menaxhimin e vështirësive financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore”, trajtohet shkalla e vështirësisë financiare dhe menaxhimi i këtyre vështirësive. Gjithashtu në ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, datë 27.04.2017, kreu XI vështirësitë financiare dhe masat për zgjidhjen e tyre, neni 55 Probleme Financiare, pika 1.

Për Bashkinë Dimal, totali i shpenzimeve të miratuara nga të ardhurat e veta me VKB për vitin 2023 ka vlerën 543,275 mijë lekë, ndërsa stoku i detyrimeve të prapambetura më 31.12.2023, ka vlerën 172,097 mijë lekë, sipas raportimit në MFE me shkresë nr. 512, datë 19.02.2024, me anë të të cilit është dërguar dhe planifikimi për shlyerjen e tyre në 3 vitet në vijim. Raporti i këtyre treguesve, pra raporti i stokut të detyrimeve të prapambetura me shpenzimet totale të miratuara, ka vlerën 31,68%, shifër që e klasifikon Bashkinë Dimal në njësi të qeverisjes vendore **me vështirësi financiare**.

| Nr. | Emërtimi | Stoku në vlerë 2023 | Totali i shpenzimeve të miratuara për NJQV-në | Stoku/Shpenzimeve totale të miratuara të NJQV-së |
|-----------|---------------------------|---------------------|---|--|
| I | Borxhe (a+b) | 0 | | |
| a | Hua sfatgjatë | 0 | | |
| b | Hua afatshkurtër | 0 | | |
| II | Detyrime (a+b+c) | | | 31,68% |
| a | Shpenzime korrente | 64,119,511 | | |
| a.1 | Mallra dhe shërbime | 39,596,810 | | |
| a.2 | Paga dhe sigurime | 0 | | |
| a.3 | Të tjera | 24,522,701 | | |
| b | Shenzime kapitale | 98,837,915 | | |
| b.1 | Insitucionebuxhetore | 0 | | |
| b.2 | Subjekte private | 98,837,915 | | |

| Nr. | Emërtimi | Stoku në vlerë 2023 | Totali i shpenzimeve të miratuara për NJQV-në | Stoku/Shpenzimeve totale të miratuara të NJQV-së |
|------------|--------------------------|---------------------|---|--|
| c | Vendime gjyqësore | 9,140,021 | | |
| c.1 | Marrëdhënie pune | 0 | | |
| c.2 | Mallra dhe Shërbime | 0 | | |
| c.3 | Investime | 9,140,021 | | |
| c.4 | Të tjera | 0 | | |
| III | Totali (I+II) | 172,097,447 | 543,275 | 31,68% |

Raportet e Monitorimit

Në zbatim të detyrimeve ligjore për monitorimin e zbatimit të buxhetit, ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenit 44 dhe ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 48, Bashkia Dimal ka përgatitur dhe dërguar rregullisht pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, raportet periodike të monitorimit të buxhetit dhe konkretisht me shkresat nr. 1572, datë 12.05.2023, nr.1572/1, datë 26.09.2023 dhe nr. 1572/2, datë 27.02.2024.

Për sa më lart ngarkohen me përgjegjësi J.M, Kryetare e Bashkisë dhe M.B , Përgjegjëse e sektorit të Financës.

Konkluzion: Niveli i treguesve të buxhetit për vitin 2023 paraqitet i realizuar në vlerën 773,673 mijë lekë nga 932,647 mijë lekë të planifikuara, ose në masën 83%. Ndër zërat e shpenzimeve që paraqiten me mos realizim, ndër më të ulët janë Transferta korrente të brendshme, realizuar në masën 34% përdorur për shpronësime dhe rehabilitime si pasojë emergjencash, si dhe shpenzime operative realizuar në masën 71%. Peshën specifike më të madhe në buxhet ndaj totalit e zënë shpenzimet për investime në masën 36% ndjekur nga shpenzimet për paga në masën 24%. Për këtë vit, shpenzimet e realizuara në Bashkinë Dimal, janë mbuluar nga të ardhurat e veta vetëm në vlerën 163,690 mijë lekë ose në masën 21%, si pasojë e mos realizimit të të ardhurave në nivelin e planifikuar.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” nenet 42,43,47,50,52 dhe 65; ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 41, me ligjin nr. 68/2017 datën 27.4.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 40,42. Udhëzim i MFE nr. 09 datë 20.07.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” pika 106, ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar neni 12 pika 3.

Konkluzion: Nga auditimi konstatohet se, detyrimet e Bashkisë Dimal në fillim të vitit 2023 janë në vlerën 266,150,796 lekë, gjatë vitit 2023 janë krijuar detyrime totale në vlerën 208,821,774 lekë, ndërkohë që janë shlyer detyrime në vlerën 221,222,959 lekë duke sjellë që vlera totale e detyrimeve të Bashkisë Dimal më 31.12.2023 të jetë 253,749,611 lekë. Konkretisht më datë 01.01.2023, numri i faturave të palikuiduara ka qenë 105 fatura me vlerë 266,150,796 lekë, ndërkohë që në datë 31.12.2023 numri i faturave të palikuiduara është 85 fatura me vlerë 253,749,611 lekë. Nga verifikimi rezultoi se nga këto detyrime, 3 fatura me vlerë 89,220,684 lekë janë detyrime të krijuara nga mungesa e alokimit të fondeve nga Ministria e Infrastrukturës, pasi

objekti i këtij shpenzimi është “Ndërtim i rrjetit të brendshëm dhe të jashtëm të ujësjetillësit Cukalat”. Për vitin 2023, Bashkia Dimal ka detyrime edhe nga një Vendim i hershëm gjyqësor dhe konkretisht administruar me nr. 2270 datë 05.02.2019, me objekt dëmshpërblim për shlyerje të vonuar investimi, me vlerë të vendimit 16,640,021 lekë, kreditor subjekti GJ ShPK, prej të cilit gjatë vitit 2022 është likuiduar vlera 6,500,000 lekë, ndërsa vlera 9,140,021 lekë është detyrim për tu shlyer në vijim. Nga auditimi konstatohet se për peridhën objekt auditimi, Bashkia Dimal nuk ka marrë masa për shlyerjen e këtij Vendimi Gjyqësor, duke riskuar lindjen e penalteteve të tjera nga vonesat. Po kështu, rezulton se vlerën më të lartë të detyrimeve Bashkia Dimal e ka në mos shlyerjen e investimeve dhe konkretisht në masë 74% të detyrimeve, çka tregon se ka mangësi në planifikimin e projekteve për investime të cilat bëhen në mungesë të garantimit të fondeve.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 41, me ligjin nr. 68/2017 datën 27.4.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 40,42. Udhëzim i MFE nr. 09 datë 20.07.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” pika 106, Udhëzimin e MF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, Kreu “Detyrimet e prapambetura të Njësisve të Vetëqeverisjes Vendore”, pikat 82-91.

Në zbatim të Programit të Auditimit cituar më sipër pika 2, u auditua “**Burimi i krijimit të të ardhurave dhe niveli i mbledhje së tyre bazuar në kuadrin rregullator në fuqi**”.

2.6. Administrimi i taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Dimal bëhet mbështetur në kuadrin ligjor si më poshtë:

- Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Ligji nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar;
- VKB nr. 72, datë 21.11.2022, “Paketa fiskale për sistemin e taksave dhe tarifave vendore dhe penaltet për kundërvajtjet administrative për vitin 2023”.
- Dokumentacioni që u analizua për të vlerësuar administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore është si vijon:
- Pasqyrat financiare në lidhje me arkëtimet, kontabilizimin dhe pasqyrimin e të ardhurave nga subjektet dhe familjarët, lidhur me taksat dhe tarifavat vendore;
- Dokumentacioni i Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, në lidhje me mënyrën e mbajtjes së regjistrave dhe dokumentacionit të tatim-paguesve;
- Kontrata, procesverbale dhe relacione në lidhje me të ardhurat;
- Regjistrat dhe mbajtja e debitorëve për bizneset dhe familjarët, për taksat dhe tarifavat vendore;
- Analiza dhe pasqyra financiare të planifikimit të të ardhurave për vitin 2023;
- Realizimi faktik i të ardhurave, monitorimi dhe analiza mbi performancën e realizimit të të ardhurave të planifikuara;
- Dokumentacion tjetër i vënë në dispozicion nga Drejtoria e Taksave dhe të Ardhurave Vendore.

Dokumentacioni që u analizua për të vlerësuar pagesat e kontratave të qirave të aseteve është:

- Regjistri i aseteve të dhëna me qira;
- Kontratat e aseteve të dhëna me qira;
- Dosjet përkatëse të subjekteve që kanë marrë asete me qira;

Administrimi i taksave dhe tarifave vendore

Administrimi i taksave dhe tarifave vendore për subjektet fizik/juridik dhe abonentët familjarë ku përfshihen regjistrat, pagesat e kryera, detyrimet e pa likuiduara etj, në Bashkinë Dimal rregjistrohen manualisht në Excel dhe në sistem, si dhe dokumentohen në dosjet përkatëse.

Për vitin 2023 paketa e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Dimal është miratuar me VKB-në nr. 72, datë 21.11.2023 “Paketa fiskale për sistemin e taksave dhe tarifave vendore dhe penalitet për kundërvajtjet administrative për vitin 2023”, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut me shkresën nr. 882/3 Prot, datë 02.12.2022. Për periudhën objekt auditimi, struktura organizative e kësaj njësie përbëhet nga titullari i Drejtorisë së Tatim-Taksave dhe Menaxhimit të Aseteve, një Përgjegjës sektori, një specialist për tatim-taksat, një specialist për menaxhimin e asetëve dhe 10 inspektorë, të gjithë me arsim të lartë. Nga auditimi rezulton se për periudhën objekt auditimi, evidenca mbi planifikimin dhe realizimin e të ardhurave, rakorduar nga Dega e Thesarit, paraqitet si vijon:

| E m ë r t i m i | 2023 | | |
|---|------------------|-----------------|----------------|
| | PLAN | FAKT | % e realizimit |
| Të ardhura të taksueshme | 169,572.5 | 83,367.1 | 49% |
| Taksa mbi pasurinë e paluajtshme | 24,113.2 | 22,516.0 | 93% |
| Familjarët | 14,100.4 | 13,013.3 | 92% |
| Subjektet tregtare | 10,012.8 | 9,502.7 | 95% |
| Taksa mbi tokën Bujqesore | 22,338.1 | 20,997.2 | 94% |
| Debitore | 86,215.8 | 37,432.2 | 43% |
| Taksa e truallit | 3,584.2 | 2,790.6 | 78% |
| Të ardhura nga tatimi mbi të ardhurat personale | 8,000.0 | 10,790.5 | 135% |
| Tatimi thjeshtuar mbi fitimin e BV | 118.3 | 94.7 | 80% |
| Taksa e fjetjes në hotel | 15.7 | - | 0% |
| Të ardhura nga legalizimet | 6,053.5 | 5,163.3 | 85% |
| Taksa vjetore e mjeteve të përdorura | 17,625.3 | 19,921.4 | 113% |
| Taksa e tabelës | 1,508.3 | 1,093.4 | 72% |
| Tabelë identifikuese mbi 2 m2 | 1,000.9 | 770.6 | 77% |
| Tabelë reklamuese | 507.5 | 322.9 | 64% |
| Të ardhura jo tatimore | 88,308.5 | 83,895.8 | 95% |
| Tarifat | 71,515.9 | 68,721.9 | 96% |
| Tarifa e pastrimit | 23,614.4 | 24,146.3 | 102% |
| Për familjaret | 9,335.7 | 9,547.4 | 102% |
| Për subjekte | 14,278.7 | 14,598.9 | 102% |
| Tarifa e parkimit të automjeteve | 2,472.3 | 3,068.5 | 124% |
| Te ardhura nga parkimi | 1,382.9 | 1,499.5 | 108% |
| Cerifikatatransporti, licenca, tarifeparkimi | 1,089.4 | 1,569.1 | 144% |
| Tarifa e ndricimit public | 5,548.7 | 5,423.4 | 98% |
| per familjaret | 3,200.6 | 2,938.0 | 92% |
| per subjektet | 2,348.1 | 2,485.3 | 106% |
| Tarifa e gjelberimit | 6,013.9 | 5,159.9 | 86% |
| per familjaret | 4,219.0 | 3,416.6 | 81% |
| per subjektet | 1,794.9 | 1,743.3 | 97% |
| Tarife per mirembajtje te infrastruktures arsimore | 4,839.5 | 3,516.7 | 73% |
| Familjaret | 4,316.0 | 3,058.0 | 71% |
| Bizneset | 523.5 | 458.7 | 88% |
| Tarife mirembajtje te infrastruktures rrugore | 16,967.8 | 17,434.6 | 103% |
| Tarife per ujitjen dhe kullimin | 7,943.6 | 6,990.8 | 88% |
| Tarifa Urbanistikes (azhornim, planimetri, kontrolle etj) | 1,473.7 | 1,188.1 | 81% |
| Tarife dhenie licence tregtim karburanti +Lende djegese | 1,200.0 | 400.0 | 33% |

| E m ë r t i m i | 2023 | | |
|--|------------------|------------------|----------------|
| | PLAN | FAKT | % e realizimit |
| Tarife për zënien e hapësirave publike | 1,331.0 | 1,302.6 | 98% |
| Tarifë për zënien e hapësirave publike me platforma betoni, kangjella. | 335.0 | 325.6 | 97% |
| Tarifë për zënien e hapësirave në tregjet publike | 996.0 | 977.0 | 98% |
| Tarifa sherbimi te MZSH | 111.0 | 91.0 | 82% |
| Të ardhura të tjera | 16,792.6 | 15,173.9 | 90% |
| Te ardhura nga qira për toke bujqësore | 1,106.6 | 972.1 | 88% |
| Te ardhura nga qira per ndertesat | 136.2 | 136.2 | 100% |
| Tarifa vendore ndotje | 5,231.0 | 5,603.0 | 107% |
| Te tjera gjoba | 2,263.5 | 1,076.3 | 48% |
| Kamatvonesa | 810.3 | 634.9 | 78% |
| Gjoba te policise bashkiake | 70.0 | 35.0 | 50% |
| Renta minerale | 1,001.0 | 782.9 | 78% |
| Tarife per aktet administrative | 85.0 | 151.5 | 178% |
| Tarife vendore e regjistrimit te biznesit | 730.0 | 446.1 | 61% |
| Te tjera te ardhura | 500.0 | 1.8 | 0% |
| Te ardhura nga cerdhet dhe kopeshtet e femijeve | 1,225.6 | 1,636.2 | 133% |
| Tarife regjistrimi per cerdhet dhe kopeshtet | 120.0 | 62.5 | 52% |
| Tarife vendore ne sektorin e pyjeve dhe kullotave | 3,513.4 | 3,635.4 | 103% |
| SHUMA | 257,881.0 | 167,263.0 | 65% |

Referuar të dhënave të paraqitura në tabelën më sipër, realizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore në Bashkinë Dimal për vitin 2023 paraqitet në masën 65%, nga 257,881 mijë lekë të parashikuara janë realizuar 167,263 mijë lekë.

Nga auditimi u konstatua se, Drejtoria e Tatim-Taksave dhe Menaxhimit të Aseteve qendron thujtë në të njëjtën performancë në realizimin e të ardhurave krahasuar me vitin para ardhës nga ku rezulton se masat shtrënguese nuk kanë qenë në nivelin e duhur dhe ka managësi në planifikim dhe realizim, me pasojë mos realizim të të ardhurave për vitin 2023 në vlerën 90,618 mijë lekë, në kundërshtim me pikën (ç) të nenit 5 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar dhe në Kreun XI- “Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar”, nenet 88 – 104, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH” me ndryshime.

Lidhur me planifikimin e taksave të ndara apo atyre që vilen nga agjentët tatimore si tatimit të thjeshtur mbi fitimin, tatimit mbi të ardhurat personale, etj, njësia e tatim-taksave në Bashkinë Dimal nuk disponon të dhëna të sakta për numrin e subjekteve të cilët gjatë vitit mbyllën dhe regjistrohen dhe rrjedhimisht nuk ka rakordime të sakta me Drejtorinë Rajonale Tatimore Berat (DRTB). Nga auditimi konstatohet se vazhdimisht Bashkia Dimal ngre grupe pune për të identifikuar subjektet që janë larguar nga vendi pa mbyllur aktivitetin, apo që funksionojnë të pa rregjistruar. Krahas treguesve me mos realizim, rezulton se si pasojë e mungesës së të dhënave të sakta, ka mangësi edhe në planifikim, pasi rezulton se në disa zëra të ardhurat paraqiten me mbi kalim plani, çka nënkupton planifikim jo të plotë dhe mbi tregues jo real dhe konkretisht të ardhurat nga tarifa e parkimit, nga çerdhet dhe kopshtet, nga tatimi mbi të ardhurat personale, etj. Procesi i planifikimit të taksave dhe tarifave vendore nuk është i dokumentuar si duhet. Nuk ka dokumentacion të plotë lidhur me kërkesat që Drejtoria e Tatim-Taksave dhe Menaxhimit të Aseteve dërgon për informacion në Drejtorinë brenda Bashkisë, njësitë apo strukturat në varësi për

të grumbulluar të dhëna lidhur me panifikimin e të ardhurave vjetore. Veprime këto në kundërshtim me VKB-në nr. 72, datë 21.11.2022 “Paketa fiskale për sistemin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2023”.

- Taksa e ndikimit në infrastrukturë

Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet llogaritet në bazë të përcaktimeve të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 3/c “për ndërtesat, të cilat janë në proces legalizimi, taksa e ndikimit në infrastrukturë e ndërtimeve të reja është 0,5 për qind e vlerës së investimit. Leja e legalizimit lëshohet vetëm pasi të jetë vërtetuar pagesa e taksës nga taksapaguesi” dhe VKM-së nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”, pika 5 “Taksa vendore e ndikimit në infrastrukturë, për ndërtimet e legalizuara, pavarësisht nga funksioni i tyre, të llogaritet, arkëtohet dhe administrohet nga njësitë e qeverisjes vendore, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. Për zbatimin e kësaj pike, drejtoritë e ALUIZNI-t, të vënë në dispozicion të njërive të qeverisjes vendore, në momentin e dërgimit për regjistrim në ZVRPP, të dhënat e ndërtimeve që pajisen me leje legalizimi”.

Për periudhën objekt auditimi situata për të ardhurat nga taksa e ndikimit në infrastrukturë paraqitet si vijon:

| Periudha | Nr. i lejeve të legalizimit | Sip. totale e ndërtimit (m ²) | Vlera e taksës |
|-----------------|-----------------------------|---|------------------|
| Deri 31.12.2023 | 215 | 36849.64 | 5,953,921 |
| Shuma | 215 | 36849.64 | 5,953,921 |

| Gjendja fund 31.12.2022 | | Shtesa 2023 | | Pakesime 2023 | | Gjendja në fund 31.12.2023 | |
|-------------------------|-----------|-------------|-----------|---------------|-----------|----------------------------|-----------|
| nr. | vlere | Nr. | Vlere | nr. | vlere | nr. | vlere |
| 137 | 3,822,253 | 145 | 4,388,402 | 67 | 2,256,734 | 215 | 5,953,921 |

Nga auditimi i dokumentacionit lidhur me ecurinë e pagesave që kryhen nga qytetarët që përfitojnë certifikatën e pronësisë në përfundim të procesit të legalizimit për taksën e ndikimit në infrastrukturë konstatohet se, në fund të vitit 2023 rezultojnë debitorë progresiv 215 individë në vlerë totale të detyrimit 5,953,921 lekë. nga të cilët vetëm për vitin 2023 janë krijuar 145 debitorë të rinj në vlerën 4,388,402 lekë.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 4, neni 27, VKM-së nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim” pika 5 si dhe VKB-në nr. 72, datë 21.11.2022 “Paketa fiskale për sistemin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2023”.

Menaxhimi i borxhit

Taksa mbi tokën bujqësore

Taksa mbi tokën bujqësore llogaritet në bazë të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 23, pika 1, Aneksi 1. Referuar paketës fiskale Bashkia Dimal ka miratuar taksën e tokës bujqësore lekë/ha në vit si në tabelën më poshtë:

| Njësia Administrative | Toke bujq. Gjithsej | Nr. Fam. Që kanë marr AMTP | Sipërfaqja e tokësndarë ne fakte Ligji 7501 | Kategoria e tokës ndarë sipas ligjit 7501/ në hektar | | | | | | | | Sipërfaqja e ndarë sipas kategorive | Sipërfaqja e tokës se pandanë | Sip. e tokësdhënë me qira |
|-----------------------|---------------------|----------------------------|---|--|-------------|-------------|-------------|-------------|-------------|-------------|----------|-------------------------------------|-------------------------------|---------------------------|
| | | | | I | II | III | IV | V | VI | VII | VIII | | | |
| Ura Vajgurore | 1500 | 1006 | 1300 | 231 | 258 | 95 | 132 | 584 | | | | 1300 | 200 | x |
| Poshnje | 3120 | 1679 | 2986 | 745 | 410 | 1168 | 263 | 127 | 273 | | | 2986 | 134 | 19.06 |
| Kutalli | 3680 | 2090 | 3651 | | 862 | 332 | | 1837 | 620 | | | 3651 | 31 | 130.2 |
| Cukalat | 1900 | 900 | 1713 | | | | | | | 1713 | | 1713 | 193 | 18.06 |
| | 10200 | 5675 | 9650 | 976 | 1530 | 1595 | 395 | 2548 | 893 | 1713 | 0 | 9650 | 558 | 167.4 |
| | | | | 4200 | 3500 | 2800 | 2300 | 1900 | 1600 | 1400 | | | | |

Nga auditimi konstatohet se, detyrimi që familjet kanë për taksën e tokës bujqësore në Bashkinë Dimal më 31.12.2023 rezulton në vlerën 70,268,869 lekë për 5776 familje. Vetëm për vitin 2023 janë krijuar debitorë në vlerën 13,594,882 lekë.

Taksa dhe tarifa të tjera familjare

| | TOKA | NDERTESA | TRUALL | PASTRIM | KULLIM | RRUGE | GJELBERIM | ARSIM | NDRIÇIM | kuz. | total |
|------------------|-------------------|-------------------|----------------|-------------------|-------------------|-------------------|------------------|------------------|------------------|----------------|--------------------|
| Ura vajgurore | 5,144,643 | 4,307,429 | 82,534 | 3,886,743 | 2,145,210 | 5,101,278 | 1,915,000 | 1,236,583 | 2,152,810 | 113,200 | 26,085,429 |
| Kutalli | 28,268,989 | 10,337,293 | 245,367 | 6,533,503 | 10,391,545 | 24,963,422 | 3,852,054 | 4,461,229 | 3,271,493 | | 92,324,895 |
| Poshnje | 28,114,447 | 7,684,805 | 161,494 | 4,408,151 | 6,207,427 | 15,524,187 | 2,639,336 | 2,647,036 | 465,841 | | 67,852,723 |
| Cukalat | 8,740,790 | 3,971,339 | 119,741 | 1,788,000 | 3,387,600 | 8,517,000 | 1,064,000 | 1,071,400 | 58,000 | 16800 | 28,734,670 |
| TOTAL | | | | | | | | | | | |
| Progresiv | 70,268,869 | 26,300,866 | 609,136 | 16,616,397 | 22,131,781 | 54,105,886 | 9,470,390 | 9,416,248 | 5,948,144 | 130,000 | 214,997,717 |
| 2023 | 13,594,882 | 7,953,883 | 173,078 | 4,477,527 | 5,613,550 | 14,037,000 | 2,586,716 | 2,341,883 | 1,653,489 | | 52,432,006 |

Vlera e borxhit për taksapaguesit familjarë më datë 31.12.2023 është në total 214,997,717 lekë dhe vetëm për vitin 2023, debitorët familjarë rezultojnë në vlerën 52,432,006 lekë.

Nga të dhënat konstatohet se rezulton problematike mbledhja e taksave nga toka bujqësore, për të cilën rezultojnë debitorë në vlerën 70,268,869 lekë ose në masën 33% të vlerës totale të detyrimeve familjare.

Agjentët tatimor

Nga auditimi rezulton se Bashkia Dimal për vitin 2023 nuk ka patur Akt marrëveshje me asnjë nga agjentët tatimorë, kjo edhe për shkak të mos bashkëpunimit nga ana e këtyre të fundit pavarësisht përpjekjeve, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2016 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe VKB nr. 72, datë 21.11.2022 “Paketa fiskale për sistemin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2023”.

Detyrimet nga subjektet fizikë/juridikë

| Lloji Biznesit | Gjendja në fillim | Të reja | Mbyllur | Gjendja në fund 2023 | Nr subjekteve debitor | Detyrimet progresiv | Nr subjekteve debitor 2023 | Detyrimet 2023 |
|-----------------|-------------------|-----------|-----------|----------------------|-----------------------|---------------------|----------------------------|------------------|
| Biznesi vogël | 598 | 35 | 36 | 597 | 99 | 7,399,405 | 59 | 1,775,433 |
| Biznesi i madh | 183 | 10 | 14 | 179 | 40 | 29,765,794 | 25 | 3,375,438 |
| Gjithsej | 781 | 45 | 50 | 776 | 139 | 37,165,199 | 84 | 5,150,871 |

Nga të dhënat rezulton se për vitin 2023 në Bashkinë Dimal janë hapur 45 biznese dhe janë mbyllur 50. Nga auditimi i dokumentacionit që administrojnë Drejtoria e Tatim-Taksave dhe Menaxhimit të Aseteve u konstatua se subjektet njoftohen periodikisht për detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, si dhe janë rinjofitur në rastet e vonesave në pagesat e detyrimeve vendore, duke aplikuar edhe kamatë vonesat përkatëse.

Nga auditimi rezulton se më datë 31.12.2023 vlera totale e borxhit tatimor në mënyrë progresive në Bashkinë Dimal për subjektet fizikë/juridikë është 37,165,199 lekë dhe përbëhet nga:

- Detyrime nga biznesi i vogël në vlerën 7,399,405 lekë;
- Detyrime nga biznesi i madh në vlerën 29,765,794 lekë;

Debitorët vetëm për vitin 2023 rezultojnë në vlerën 5,150,871 lekë.

Referuar regjistrave analitikë të vënë në dispozicion nga Bashkia Dimal, borxhi tatimor për vitin 2023 paraqitet si vijon:

| | Përshkrimi | Borxhi 31.12.2022 | Borxhi i krijuar gjatë 2023 | Borxhi më 31.12.2023 |
|-----------|--|--------------------|-----------------------------|----------------------|
| I | DEBITOR FAMILJAR | 199,755,004 | 52,432,008 | 214,997,717 |
| | Debitorë taksa e ndërtesës familje | 23,566,269 | 7,953,883 | 26,300,866 |
| | Debitorët taksa e tokës familje | 68,201,327 | 13,594,882 | 70,268,869 |
| | Debitorët taksa e truallit | 549,975 | 173,078 | 609,136 |
| | Debitorët tarifat (pastrim, ndriçim, gjelbërim, arsim, tarifë mirëmbajtjes kanaleve) familje, infr rrugore | 107,437,433 | 30,710,165 | 117,818,846 |
| II | DEBITOR BIZNESI | 33,268,305 | 5,150,871 | 37,165,199 |
| | Debitorët biznes i vogël | 7,047,754 | 1,775,433 | 7,399,405 |
| | Debitorët biznes i madh | 26,220,551 | 3,375,438 | 29,765,794 |
| III | Debitorët qiratë e tokës bujqësore | 11,918,322 | 258,505 | 12,137,543 |
| IV | Karburant | 2,600,000 | | 2,200,000 |
| V | Guroret | 36,652,600 | | 36,652,600 |
| VI | Debitorët taksa e ndikimit në infrastrukturë | 3,822,253 | 3,643,927 | 5,953,921 |
| | Total Borxhi | 288,016,484 | 61,485,311 | 309,106,980 |

Nga të dhënat rezulton se vlera progresive e detyrimit në fund të vitit 2023 është vlera 309,106,980 lekë nga të cilat vlera 61,485,311 lekë janë krijuar vetëm në vitin 2023, vlerë e cila është kontabilizuar. Në vlerën totale të detyrimit, peshën më të madhe e zenë debitorët familjarë për tarifat pastrim, ndriçim, gjelbërim, etj, në vlerën 117,818,846 lekë ose në masën 38% të vlerës totale të borxhit, ndërkohë zëri i dytë që rëndon këtë vlerë janë detyrimet po familjare për taksën e tokës bujqësore në vlerën 70,268,869 lekë ose në masën 22.7%. Sa i takon bizneseve debitore, nuk janë krijuar vlera të konsiderueshme detyrimesh për vitin 2023, duke marrë parasysh se Bashkia Dimal ka arritur të arkëtojë këto detyrime më tepër nëpërmjet bllokimit të llogarive sesa

nëpërmjet arkëtimeve vullnetare, ndërkohë që peshën më të lartë në totalin e borxhit ndër bizneset e zenë detyrimet nga shfrytëzimi i fondit pyjor i cili rezultoi në vlerën 36,652,600 lekë dhe që përbën detyrim të trashëguar nga subjekte me të cilat aktualisht Bashkia Dimal është në procese gjyqësore për heqjen e licensave, ndërkohë që për vitin 2023 nuk rezultoi të ketë debitorë në këtë kategori.

- **Masat e marra për uljen e borxhit**

Drejtoria e Taksave dhe të Ardhurave Vendore në Bashkinë Dimal është përgjegjëse për të mbledhur detyrimet e papaguara në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi. Në zbatim të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008, hapat që duhet të ndërmerren me qëllim mbledhjen e detyrimeve të papaguara vijnë duke u përshkallëzuar si:

1. Njoftimi dhe kërkesa për të paguar;
2. Urdhri i bllokimit të llogarive bankare të tatimpaguesit;
3. Masa e sigurimit të detyrimit tatimor;
4. Sekuestrimi i pasurisë.

Referuar dokumentacionit të audituar lidhur me hapat që janë ndjekur për të mbledhur detyrimet për taksat dhe tarifave vendore në Bashkinë Dimal, rezultoi se për të gjithë debitorët si biznese ashtu edhe familjarë janë bërë njoftime për kalimin e afatit për pagesat vendore, si dhe janë aplikuar gjopa dhe kamatvonesa për këta debitorë sipas ligjit 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Pas dërgimit të njoftimeve, për subjektet që kanë vazhduar të rezultojnë debitorë për detyrimet vendore, gjatë vitit 2023 konstatohet të jenë marrë masat si vijon:

- Janë nxjerrë urdhrat e bllokimit të llogarive bankare të taksapaguesve drejtuar bankave të nivelit të dytë për 28 raste të vendosjes së masës administrative “Gjobë” nga inspektimet e IMTV;
- Janë dërguar në Gjyaktë kërkesat përkatëse për lëshim urdhër ekzekutimi për 30 raste për masat administrative “Gjobë” nga konstatimet e IMTV.
- Janë dërguar njoftime ndaj të gjithë debitorëve familjarë duke përfshirë edhe vlerën e kamatvonesës duke parashikuar favorizimin për heqjen e penaltetit në rast arkëtimi të detyrimit brenda 30 ditësh.
- Janë dërguar njoftimet e bllokimit të llogarive pranë bankave përkatëse për debitorët familjarë.

Nga auditimi konstatohet se pavarësisht përpjekjeve të bëra deri në bllokimin e llogarive bankare, nga Drejtoria e Tatim-Taksave dhe menaxhimit të Aseteve në bashkëpunim me sektorin Juridik, nuk është vijuar me ndjekjen e procedurave ligjore bazuar në nenin 181, “Mos pagimi i taksave dhe tatimeve”, të Kodit Penal të RSH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 me ndryshime, ku përcaktohet se: “Mospagimi i taksave dhe tatimeve brenda afatit të caktuar, me gjithë mundësinë e pagimit të tyre, nga personi ndaj të cilit janë marrë më parë masa administrative për këtë qëllim, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.”

Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar neni 9 “Të drejta dhe përgjegjësitë” pika 1.3., ku përcaktohet se:

1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë këto të drejta dhe përgjegjësi:

1.3. Të drejtën dhe përgjegjësinë e mbledhjes së të ardhurave dhe bërjes së shpenzimeve, sipas së cilës: a) krijojnë, mbledhin të ardhura dhe bëjnë shpenzime për përmbushjen e funksioneve të tyre; b) vendosin taksa vendore e tarifa për shërbimet, si dhe nivelin e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi; c) hartojnë, miratojnë dhe zbatojnë buxhetin e tyre; ç) mbajnë llogaritë, në përputhje me legjislacionin në fuqi, dhe ofrojnë informacione ose raporte financiare për hartimin dhe zbatimin e buxhetit për qeverisjen qendrore ose shtetasit.” Neni 35, “Të ardhurat që rrjedhin nga burimet e veta vendore”, me ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10, si dhe me ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 “Për sistemin e taksave vendore”, Kreu II, Kreu IV, Kreu V, Kreu VII, etj. Për pasojë vlera e debitorëve si familjarë ashtu edhe subjekte fizike apo juridike mbetet e konsiderueshme.

- Subjektet që ushtrojnë aktivitet në fushën e hidrokarbureve

Grupi i auditimit auditoi dokumentacionin lidhur me pajisjen e subjekteve me autorizim për ushtrimin e aktivitetit në zbatim të legjislacionit në fuqi përkatësisht:

- Ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar me ligjin nr. 71/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, “për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, neni 4, neni 20/pika 2;

- VKM nr. 344, datë 19.04.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 970, datë 02.12.2015, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, pika 2/9 “Pagesa për dhënien dhe përsëritjen e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet dhe vajrat lubrifikante, është 3,000,000 (tre milionë) lekë për Bashkinë e Tiranës dhe 1,000,000 (një milion) lekë për bashkitë e tjera”.

Referuar dokumentacionit të paraqitur rezulton se, në territorin e Bashkisë Dimal për periudhën objekt auditimi kanë ushtruar aktivitet në fushën e tregtimit të lëndëve djegëse me pakicë 16 subjekte të paraqitura në tabelën në vijim:

| Nr | Subjekti | Nipt | Afati i Autorizimit | | Detyrimi | Pagesat | Detyrim 31.12.2023 |
|--------------|---------------|-------|---------------------|------------|-----------|-----------|--------------------|
| | | | Fillimi | Mbarimi | | | |
| 1 | R Shpk | J...J | 11.12.2018 | 10.12.2023 | 1 000 000 | 1 000 000 | |
| 2 | B sh.p.k (N) | L...R | | | 1 000 000 | 600 000 | 400 000 |
| 3 | G.Z shpk | K...I | 30.10.2023 | 30.10.2024 | 1 000 000 | 1 000 000 | |
| 4 | R shpk | K...I | 06.10.2020 | 05.10.2024 | 1 000 000 | 1 000 000 | |
| 5 | B shpk | L...F | | | 1 000 000 | 600 000 | 400 000 |
| 6 | D shpk | L...J | 10.01.2023 | 10.01.2024 | 1 000 000 | 800 000 | 200 000 |
| 7 | N shpk | O...L | 10.08.2020 | 09.08.2025 | 1 000 000 | 1 000 000 | |
| 8 | N shpk | K...L | 20.02.2023 | 20.02.2024 | 1 000 000 | 1 000 000 | |
| 9 | M shpk | L...J | 13.03.2020 | 12.03.2025 | 1 000 000 | 1 000 000 | |
| 10 | K shpk | J...P | 05.08.2020 | 04.08.2023 | 1 000 000 | 1 000 000 | |
| 11 | E shpk | L...F | 24.08.2021 | 23.08.2022 | 1 000 000 | 800 000 | 200 000 |
| 12 | C shpk | K...T | 23.06.2020 | 22.06.2024 | 1 000 000 | 1 000 000 | |
| 14 | A shpk | K...J | Ska leje ndertimi | | 1 000 000 | | 1 000 000 |
| 16 | Z Oil | L...I | | | 1 000 000 | 1 000 000 | |
| SHUMA | | | | | | | 2 200 000 |

Nga auditimi rezultoi se subjektet që ushtrojnë veprimtari në fushën e hidrokarbureve pajisen me licenca 5 vjeçare, në zbatim të VKM përkatëse. Megjithatë, për shkak të vështirësive financiare në shlyerjen e menjëhershme të tarifës së pajisjes me autorizim prej 1.000.000 lekësh, nga Bashkia Dimal është pranuar që disa prej këtyre subjekteve të kryejn pagesa vjetore deri në shlyerjen e tarifës. Për sa më lart rezultoi se kanë shlyer detyrimin e plotë 11 subjekte, ndërsa 5 të tjerë mbeten debitorë për vitin 2023, në vlerën totale prej 2,200,000 lekë.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të mbajtur për secilin subjekt më sipër, rezultoi se nga 16 subjektet e mësipërme, 4 prej tyre vijojnë të ushtrojnë aktivitetin në shkelje të ligjit dhe konkretisht: **B sh.p.k** ka ushtruar aktivitetin në mungesë të plotësimin të dokumentacionit të nevojshëm për pajisjen me autorizimin përkatës dhe pavarësisht se për periudhën objekt auditimi nuk ka funksionuar më, ai rezultoi debitor në vlerën 400,000 lekë.

B shpk, ka bërë kërkesë për pajisje me autorizim për ushtrimin e aktivitetit me shkresën nr. 2361, datë 16.07.2021. Në përgjigje të kësaj kërkesë, me shkresë nr. 300 , datë 26.01.2021, Bashkia Dimal ka njoftuar subjektin se për pajisjen me këtë autorizim, subjekti duhet të shlyej detyrimet dhe të dorëzojë dokumentacionin e nevojshëm që mungon. Pavarësisht shkresave të njëpasnjëshme rikujtuese të Bashkisë Dimal, e fundit me nr. 3320, datë 23.11.2022, subjekti nuk i është përgjigjur përmbushjes së detyrimeve. Për sa më lart konstatohet se prej një viti, Komisioni i dhënies së licensave dhe Titullari i Bashkisë Dimal nuk kanë marrë masa për vijimin me njoftimin e instancave përkatëse për bllokimin e aktivitetit.

A shpk rezultoi se ushtron aktivitet në trëgëtimin e lëndëve hidrokarbure, në mungesë të lejes së ndërtimit, për të cilën nga Bashkia Dimal i është refuzuar dhënia e autorizimit. Pavarësisht sa më lart, Komisioni i dhënies së licensave dhe Titullari i Bashkisë Dimal nuk kanë marrë masa për vijimin me njoftimin e instancave përkatëse për bllokimin e aktivitetit.

Z Oil sh.p.k rezultoi se ushtron aktivitetin në mungesë të plotësimin të dokumentacionit të nevojshëm, për të cilin Bashkia Dimal ka bërë disa herë shkresa rikujtuese, e fundit me nr. 3317, datë 23.11.2022. Edhe për këtë rast, subjekti nuk i është përgjigjur përmbushjes së detyrimeve, megjithatë konstatohet se Komisioni i dhënies së licensave dhe Titullari i Bashkisë Dimal nuk kanë marrë masa për vijimin me njoftimin e instancave përkatëse për bllokimin e aktivitetit.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregëtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar me ligjin nr. 71/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregëtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar dhe VKM nr. 970, datë 02.12.2015, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licensave për tregëtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”.

- **Mbi realizimin e të ardhurave nga Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit në Bashkinë Dimal**

Nga auditimi i dokumentacionit që administron IMTV-ja në Bashkinë Dimal u konstatua se për vitin 2023 janë mbajtur në total 4 proces verbale për konstatimin e kundërvajtjeve, si më poshtë:

M.Z, vendim gjobe nr. 479, datë 04.01.2023 në vlerën 500,000 lekë;

F.C , vendim gjobe nr. 480, datë 04.07.2023 në vlerën 500,000 lekë dhe vendim prishje nr. 48, datë 04.07.2023;

R.B, vendim gjobe nr. 481, datë 08.04.2023 në vlerën 500,000 lekë dhe vendim prishje nr. 49, datë 31.10. 2023;

D.C, vendim gjobe nr. 482, datë 27.05.2023 dhe vendim prishje nr. 50, datë 01.11.2023.

Për të 4 rastet e mësipërme, Bashkia Dimal është në proces gjyqësor me subjektet, duke bërë që vetëm për vitin 2023, **vlera debitore e krijuar nga gjobat të jetë 2,000,000 lekë.**

Situata debitore progresive nga gjobat e vendosura nga IMTV, më 31.12.2023 rezulton në vlerën 35,024,950 lekë. Për të gjitha rastet Bashkia Dimal ka ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshme ligjore për ekzekutimin e vendimeve të IMTV dhe për të gjitha këto raste është në faza të ndryshme të proceseve gjyqësore me subjektet të cilat ende nuk kanë përfunduar, ose në faza të ekzekutimit nga përmbaruesit.

Konkluzion: Realizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore në Bashkinë Dimal për vitin 2023 paraqitet në masën 65%, nga 257,881 mijë lekë të parashikuara janë realizuar 167,263 mijë lekë.

Nga auditimi u konstatua se, Drejtoria e Tatim-Taksave dhe Menaxhimit të Aseteve qendron thujtë në të njëjtën performancë në realizimin e të ardhurave krahasuar me vitin para ardhës nga ku rezulton se masat shtrënguese nuk kanë qenë në nivelin e duhur dhe ka managësi në planifikim dhe realizim. Lidhur me planifikimin e taksave të ndara apo atyre që vilen nga agjentët tatimore si tatimit të thjeshtur mbi fitimin, tatimit mbi të ardhurat personale, etj, njësia e tatim-taksave në Bashkinë Dimal nuk disponon të dhëna të sakta për numrin e subjekteve të cilët gjatë vitit mbyllen dhe regjistrohen dhe rrjedhimisht nuk ka rakordime të sakta pasi për vitin 2023 nuk ka patur Akt marrëveshje me asnjë nga agjentët tatimorë, kjo edhe për shkak të mos bashkëpunimit nga ana e këtyre të fundit pavarësisht përpjekieve. Krahas treguesve me mos realizim, rezulton se si pasojë e mungesës së të dhënave të sakta, ka mangësi edhe në planifikim, pasi rezulton se në disa zëra të ardhurat paraqiten me mbi kalim plani, çka nënkupton planifikim jo të plotë dhe mbi tregues jo real. Nga të dhënat rezulton se vlera progresive e debitorëve nga taksat dhe tarifat vendore në fund të vitit 2023 është 309,106,980 lekë nga të cilat 61,485,311 lekë janë krijuar vetëm në vitin 2023. Në vlerën totale të detyrimit, peshën më të madhe e zenë debitorët familjarë për tarifat pastrim, ndriçim, gjelbërim, etj, në vlerën 117,818,846 lekë ose në masën 38% të vlerës totale të borxhit, ndërkohë zëri i dytë që rëndon këtë vlerë janë detyrimet po familjare për taksën e tokës bujqësore në vlerën 70,268,869 lekë ose në masën 22.7%. Sa i takon bizneseve debitore, nuk janë krijuar vlera të konsiderueshme detyrimesh për vitin 2023, duke marrë parasysh se Bashkia Dimal ka arritur të arkëtojë këto detyrime më tepër nëpërmjet bllokimit të llogarive sesa nëpërmjet arkëtimeve vullnetare.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Pikën (ç) e nenit 5 të Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar dhe në Kreun XI- “Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar”, nenet 88 – 104, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH” me ndryshime. VKB-në nr. 72, datë 21.11.2022 “Paketa fiskale për sistemin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2023”.

Konkluzion: Nga shqyrtimi i dokumentacionit të mbajtur për subjektet që ushtrojnë veprimtari në fushën e hidrokarbureve, rezultoi se nga 16 subjekte, 4 prej tyre vijnë të ushtrojnë aktivitetin në shkëlqje të ligjit dhe konkretisht:

B sh.p.k ka ushtuar aktivitetin në mungesë të plotësimin të dokumentacionit të nevojshëm për pajisjen me autorizimin përkatës dhe pavarësisht se për periudhën objekt auditimi nuk ka funksionuar më, ai rezulton debitor në vlerën 400,000 lekë.

B shpk, ka bërë kërkesë për pajisje me autorizim për ushtrimin e aktivitetit me shkresën nr. 2361, datë 16.07.2021. Në përgjigje të kësaj kërkesë, me shkresë nr. 300 , datë 26.01.2021, Bashkia Dimal ka njoftuar subjektin se për pajisjen me këtë autorizim, subjekti duhet të shlyej detyrimet

dhe të dorëzojë dokumentacionin e nevojshëm që mungon. Pavarësisht shkresave të njëpasnjëshme rikujtuese të Bashkisë Dimal, e fundit me nr. 3320, datë 23.11.2022, subjekti nuk i është përgjigjur përmbushjes së detyrimeve. Për sa më lart konstatohet se prej një viti, Komisioni i dhënies së licensave dhe Titullari i Bashkisë Dimal nuk kanë marrë masa për vijimin me njoftimin e instancave përkatëse për bllokimin e aktivitetit.

A shpk rezulton se ushtron aktivitet në mungesë të lejes së ndërtimit, për të cilën nga Bashkia Dimal i është refuzuar dhënia e autorizimit. Pavarësisht sa më lart, Komisioni i dhënies së licensave dhe Titullari i Bashkisë Dimal nuk kanë marrë masa për vijimin me njoftimin e instancave përkatëse për bllokimin e aktivitetit.

Z Oil sh.p.k rezulton se ushtron aktivitetin në mungesë të plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm, për të cilin Bashkia Dimal ka bërë disa herë shkresa rikujtuese, e fundit me nr. 3317, datë 23.11.2022. Edhe për këtë rast, subjekti nuk i është përgjigjur përmbushjes së detyrimeve, megjithatë konstatohet se Komisioni i dhënies së licensave dhe Titullari i Bashkisë Dimal nuk kanë marrë masa për vijimin me njoftimin e instancave përkatëse për bllokimin e aktivitetit.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Ligji nr. 8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregëtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar me ligjin nr. 71/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregëtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar dhe VKM nr. 970, datë 02.12.2015, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licensave për tregëtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”.

Për sa më lart ngarkohen me përgjegjësi:

I.SH, L.H, E.H, A.A, G.H, I.SH, M.G, R.B, I.M.

2.3 AUDITIM MBI VLERËSIMIN E RAPORTIMIT FINANCIAR, PËR VITIN 2023.

Për të arritur në opinionin, në se pasqyrat financiare për vitin 2023, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare, aktiveve neto dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi dhe konkretisht, ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” (i shfuqizuar), ligjin nr. 25/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisve të Qeverisjes së Përgjithshme”, u analizuan pasqyrat financiare të vitit 2023, konkretisht: Pasqyrat financiare të vitit 2023;

Ditari i Bankës;

Ditari i Arkës;

Ditari i Magazinës;

Aktrakordimet me Degën e Thesarit Berat

Inventarët etj.

Nga auditimi ka rezultuar se:

Bashkia Dimal ka përgatitur dhe raportuar Pasqyrat Financiare të vitit 2023, mbështetur në Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të Pasqyrave Financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme". Lidhur me operacionet buxhetore, është rakorduar dhe konfirmuar nga Dega e Thesarit, si dhe nuk ka patur në asnjë rast kontestime.

Pjesë përbërëse të Pasqyrave Financiare të vitit 2023 janë:

Pasqyra e pozicionit financiar (F1);
 Pasyra e performancës financiare (F2);
 Pasqyra e flukseve monetare (F3);
 Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto (F4);
 Pyetësor dhe shënimet shpjeguese mbi pasyrat financiare (F5);
 Pasqyrat statistikore:
 Investimet dhe burimi i financimit (F6);
 Gjendja dhe ndryshimet në aktivet afatgjata, kosto historike (F7.a);
 Gjendja dhe ndryshimet në aktivet afatgjata, vlera neto (F7.b);
 Numri i punonjësve dhe fondi i pagave (F8);
 Pasqyrat Financiare janë dërguar në Degën e Thesarit Berat me shkresën nr. 50/7, datë 28.03.2024, nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë Dimal J.M.
 Pjesë përbërëse e dokumentacionit mbi pasqyrat financiare dhe raportimin financiar janë Aktrakordimet mbi shpenzimet dhe të ardhurat me Degën e Thesarit të konfirmuara dhe nënshkruara nga NZ dhe NA i Bashkisë Dimal, Specialisti, kontabilisti dhe Përgjegjësi i Degës së Thesarit Berat .

Nga auditimi i pasqyrave financiare individuale rezultoi:

1. Pasqyra e pozicionit financiar (F1)

Aktivët neto janë të barabarta me Aktivët-Pasivët = 3,021,119,781.27 lekë.

| | |
|--------------|------------------------|
| Aktivët | 3,731,626,029.5 lekë |
| Pasivët | 3,261,812,711 lekë |
| Aktivët neto | 3,021,119,781.27 lekë. |

I. Aktivët Afatshkurtra

Aktivët afatshkurtra më datë 31.12.2023 paraqiten në vlerën 772,167,701.5 lekë dhe përbëhen nga:
 Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre” në shumën 87,743,277.5 lekë;
 Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues” në shumën 20,325,941 lekë;
 Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” në shumën 410,348,872 lekë.
 Llogaria e Klasës 4 “Te tjera aktive afatshkurtra” në shumën 253,749,611 lekë.
 Klasa 5 “Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre”, përbëhet nga:

Gjendja e llogarisë nr. 520 “Disponibilitete në Thesar”, sipas mbylljes së bilancit të vitit 2023 është në vlerën prej 86,524,662,5 lekë, e cila rakordon me rubrikën VI “Teprica e Likujditeve në fund të vitit ushtrimor” (sipas formatit F3 “Pasqyra e flukseve monetare”)
 Rakordimi i llogarive me degën e thesarit, llogaria nr.520 “Disponibilitete në Thesar”, llogaria nr.466 “Mjete në ruajtje” dhe llogaritë e të ardhurave.

Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues”, përbëhen nga:

| Llogaritë kontabël | Emërtimi i llogarive | Viti 2023 | Viti 2022 | Diferenca |
|--------------------|---|------------|------------|-----------|
| 31 | Materiale | 1,936,661 | 1,848,270 | 88,391 |
| 32 | Objekte inventari | 18,389,280 | 17,462,817 | 926,463 |
| 33 | Prodhime, punime e shërbime ne proces | 0 | 0 | 0 |
| 34 | Produkte | 0 | 0 | 0 |
| 35 | Mallra | 0 | 0 | 0 |
| 36 | Gjë e gjalle ne rritje e majmeri | 0 | 0 | 0 |
| 37 | Gjendje te pambritura ose pranë të tretteve | 0 | 0 | 0 |
| 38 | Diferenca nga çmimet e magazinimit | 0 | | 0 |

| Llogaritë kontabël | Emërtimi i llogarive | Viti 2023 | Viti 2022 | Diferenca |
|--------------------|---|------------|------------|-----------|
| 39 | Shuma te parashikuara për zhvlerësim te inventarit(-) | 0 | 0 | 0 |
| Totali | | 20,325,941 | 19,311,087 | 1,014,854 |

Llogaritë e Klasës 3, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë Dimal në 31.12.2023 paraqiten në vlerën 20,325,941 lekë dhe përbëhen nga llogaria kontabël 31 “Materiale” në vlerën 1,936,661 lekë dhe nga llogaria kontabël 32 “Objekte inventari” në vlerën 18,689,280 lekë.

Diferenca me vitin e mëparshëm përfaqëson lëvizjen e inventarit në shumën (1,014,854) lekë e cila kuadron me llogarinë 63 “Ndryshimi gjendjes së inventarit” në shumën (-1,014,854) lekë.

Llogaria 312 “Materiale”, ka vlerën 1,936,661.5 lekë dhe përputhet me rezultatin e inventarizimit vjetor.

Llogaria 327 “Objekte inventari”, ka vlerën 18,389,280 lekë dhe përputhet me rezultatin e inventarizimit vjetor.

Gjendja e llogarive të mësipërme është e kuadruar me gjendjen e inventarëve. Për kryerjen e tyre, përsa i përket llogarive të klasës 3, është zbatuar udhëzimi i MF nr. 30, datë 27.12.2012 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik". Titullari i Bashkisë Dimal ka nxjerrë Urdhrin e inventarizimit nr.3672/709 datë 13/11/2023, ku janë përcaktuar Grupet për inventarizimin të objekteve të inventarit llogaria 327 dhe 218. Nga inventarizimi nuk kanë rezultuar diferenca.

Llogaritë e klasës 3 kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llog. 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit” dhe duke u kredituar për daljet e inventarit në debi të llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit”.

Llogaritë Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme”&“Të tjera aktive afatshkurtra” përbëhet nga:

| Logaritë | EMERTIMI | Mbyllur 2023 | Paraardhes 2022 | Diferenca 2023-2022 |
|----------|--|-----------------|--------------------|------------------------|
| | 3.Llogari te Arketushme | 410,348,872 | 3,992,884,820 | 11,06,410 |
| 411 | Kliente e llogari te ngjashme | 0 | 0 | 0 |
| 423,429 | Personeli, paradhenie, deficite, gjoba | 12,893,788 | 12,893,788 | 0 |
| 431 | Tatim e Taksa | 0 | 0 | - |
| 432 | Tatime, mbledhur per llogari pushtetit lokal | 0 | 0 | - |
| 433 | Fatkeqsi natyrore qe mbulohe nga shteti | 0 | 0 | - |
| 435 | Sigurime Shoqerore | 0 | 0 | - |
| 436 | Sigurime Shendetsore | 0 | 0 | - |
| 437,438 | Organizma te tjerështëtorore | 0 | 0 | - |
| 44 | Institucione te tjera publike | 0 | 0 | - |
| 465 | Efekte per tu arketuar nga shitja e letrave me vlere | | 0 | 0 |
| 468 | Debitore te ndryshem | 338,753,326 | 317,757,340 | 20,995,986 |
| 4342 | Operacione me shtetin(Te drejta) | 58,701,758 | 68,637,334 | -9,935,576 |
| 45 | Mardhenie midis institucioneve apo njesive ekonomike | 0 | 0 | - |
| 49 | Shuma te parashikuara perxhvleresim(-) | 0 | 0 | - |
| | 4.Te tjera aktive afatshkurtra | 253,749,611 | 266,150,796 | -12,401,185 |
| 409 | Parapagime | - | - | - |
| 473 | Llogari e pritjes te mardhenieve me thesarin | - | - | - |
| 477 | Diferenca konvertimi aktive | - | - | - |
| 481 | Shpenzime per t'u shperndare ne disa ushtrime | - | - | - |
| 486 | Shpenzime te periudhave te ardhshme | 253,749,611 | 266,150,796 | -12,401,185 |

Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm”

| Referenca | EMERTIMI | 2023 | 2022 |
|-----------|----------------------|-------------|-------------|
| 468 | Debitorë të ndryshëm | 338,753,326 | 317,757,340 |

-Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” paraqitet në bilancin e vitit 2023 me tepricë debitore 338,753,326 lekë. Kjo llogari ka pësuar rritje nga viti 2022 në vlerën 20,995,986 lekë.

Kjo llogari është e analizuar në pasqyra të veçanta sipas subjekteve debitore.

Lista e debitorëve të taksave dhe tarifave i është dërguar drejtorisë së financës nga ana e drejtorisë së taksave dhe tarifave vendore me shkresë zyrtare nr. 805 datë 18.03.2024, konfirmuar këto nga Drejtori i Drejtorisë së Tatim Taksave . Kontabilizimi i tyre është bërë mbështetur në shkresën nr. 805, datë 18.03.2024 “Për regjistrimin në kontabilitet për taksat dhe tarifatat vendore për vitin 2023.

*Mbi kontabilizimin e llogarive nr.26 “Pjesëmarrje në Kapitalin e vet”.

Sipas të dhënave të pasqyruara në pasqyrat e vitit 2023, vlera kontabël e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 147,176,127 lekë, e cila përmban shumën e aksioneve që Bashkia Dimal ka në 3 shoqëri referuar ekstraktit historik të Qendrës Kombëtare të Biznesit.

1-Sipas ekstraktit historik të shoqërisë “Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime DIMAL”, me NIPT M...O , Bashkia Dimal zotëron 5.39 % të aksioneve.

Për sa më sipër llogaria nr.26”Pjesëmarrje në Kapitalin e vet”, është kontabilizuar në këtë vlerë, por nuk është vlerësuar derdhja e këtij kapitali në llogaritë e aksionarëve, pra nuk u konstatua kryerja e pagesës së pjesëmarrjes në kundërshtim me udhëzimin nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar.

-Llogaria 4342 “Te tjera operatione me shtetin (debitor)”, në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 58,701,758 lekë dhe kuadron me Llogarinë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” të Pasqyrës së Performancës Financiare e cila paraqitet në shumën 58,701,758 lekë, në përputhje me Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, Kapitulli III, pika 32. Vlera prej 357,873,219.5 lekë përfaqëson llogaritë e Klasës së 4 të Pasivit të Pasqyrës Financiare të Pozicionit Financiar dhe përbëhet nga:

| Nr.llogarisë | Emërtimi i llogarive | Vlera |
|--------------|---------------------------------------|----------------------|
| 401-408 | Furnitore e llogari te lidhura me to | 39,827,028 |
| 42 | Detyrime ndaj personelit | 13,819,362 |
| 431 | Detyrime ndaj shtetit per tatim taksa | 595,114 |
| 435 | Sigurime Shoqerore | 3,858,348 |
| 436 | Sigurime Shendetsore | 595,114 |
| 438 | Organizma te tjera shtetore | 3,858,348 |
| 467 | Kreditore te ndryshem | 253,749,611 |
| | Totali | 357,873,219.5 |

-Llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 253,749,611.00 lekë.

Vlera e kësaj llogarie duhet të përfaqësojë detyrime për shpenzime të kryera, por jo të financuara në vitin ushtrimor. Kjo llogari ka si kundërparti gjendjen e llogarisë nr.467 “Kreditorë të ndryshëm” në vlerën 253,749,611 lekë. Llog 401-408 Furnitorë për blerje, shërbime dhe investime në vlerën 253,749,611 lekë për detyrime e prapambetura.

Për shpenzimet përkatëse :

| Përshkrimi | Vlera |
|--|--------------------|
| Detyrime të prapambetura për vendime gjyqësore | 9,140,021 |
| Detyrime të prapambetura për mirëmbajtjen | 56,550,991 |
| Detyrime të prapambetura për investime | 188,058,599 |
| Totali | 253,749,611 |

Nga auditimi i Raportit të vetëvlerësimit financiar për vitin 2023 u konstatua se Bashkia Dimal ka paraqitur në Ministrinë e Financave raporte të vetëvlerësimit financiar, sipas periudhave katërmujore. Konstatohet se ka një rënie të ulët të faturave të pa likuiduara krahasimisht me vitin 2022. Sipas shpjegimeve kjo ka ardhur për efekt mungese fondesh. Konkretisht më datë 01.01.2023, numri i faturave të palikuiduara është 105 fatura me vlerë 266,150,796 lekë, ndërkohë që në datë 31.12.2023 numri i faturave të palikuiduara është 85 fatura me vlerë 253,749,611 lekë.

Nga verifikimi rezultoi se nga këto detyrime, 3 fatura me vlerë 89,220,684 lekë janë detyrime të krijuara nga mungesa e alokimit të fondeve nga Ministria e Infrastrukturës, pasi objekti i këtij shpenzimi është “Ndërtim i rrjetit të brendshëm dhe të jashtëm të ujësjellësit Cukalat”.

AKTIVET AFATGJATA JOMATERIALE (AAJM)

Llogaritë e Klasës 20 “Aktivet Afatgjata Jo materiale”, përbëhen nga llog.202 “Studime dhe kërkime”, në vlerën 71,416,016 lekë në fund të vitit 2022 dhe në fund të vitit 2023 në vlerën 73,276,016 lekë.

Gjithashtu sipas formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” në fund të vitit ushtrimor 2023 llogaria nr.202 “Studime dhe kërkime” paraqitet në vlerën 73,276,016 lekë.

Analitiku i llogarisë nr.202 “Studime dhe Kërkime”

| Llogaria | Përshkrimi | Viti 2022 | Shtesa | Pakësime | Viti 2023 |
|----------|-------------|------------|-----------|----------|------------|
| 202 | Të mbartura | 71,416,016 | 1,860,000 | 0 | 73,276,016 |
| | Shuma 202 | 71,416,016 | 1,860,000 | 0 | 73,276,016 |

AKTIVET AFATGJATA MATERIALE (AAM)

-Llogaritë e Klasës 21 “Aktivet Afatgjata Materiale”, AAM sipas të dhënave të pasqyruara për vitin ushtrimor 2023, vlera kontabël neto paraqitet në shumën 3,712,133,548 lekë. Në vitin paraardhës 2022, vlera kontabël neto e AAM-ve paraqitet në shumën 3,276,155,624 lek, me një rritje të AAM-ve në shumën 435,977,924 lekë.

Llogaritë e Klasës 21 “Aktivet Afatgjata Materiale”

| Llog. | Përshkrimi i llogarive | Çelje 2022 | Shtesa 2023 | Pakësime 2023 | Gjendje në fund |
|-------|--------------------------|------------|-------------|---------------|-----------------|
| | AAGJM | 2758471622 | 2311171 | 28878967 | 2731903826 |
| 210 | Toka, Troje, Terene | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 211 | Pyje, Plantacione | 7,185,712 | 0 | 0 | 7,185,712 |
| 212 | Ndertesa e Konstruksione | 1121722588 | 632171 | 0 | 1122354759 |

| | | | | | |
|-----|--------------------------------------|------------|-----------|----------|------------|
| 213 | Rruge, rrjete, vepra ujore | 1274218707 | 81600 | 0 | 1274300307 |
| 214 | Instalime teknike, makineri e paisje | 22546784 | 1584400 | 3416280 | 20714904 |
| 215 | Mjete Transporti | 72091613 | 0 | 0 | 72091613 |
| 216 | Rezerva Shteterore | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 217 | Kafshe pune e prodhimi | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 218 | Inventar ekonomik | 90340218 | 13000 | 2272812 | 88080404 |
| 24 | Aktive te qendrushme te demtuara | 00 | 0 | 0 | 0 |
| 28 | Caktime | 170366002 | | 23189875 | 147176127 |
| 219 | Amortizimi i AAGJM (-) | 618671377 | 114300918 | 0 | 732972295 |

Ndërsa sipas formatit 7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” paraqiten në mbylljen e vitit ushtrimor 2023 në vlerën 2,805,179,842 lekë dhe në fund të vitit ushtrimor 2022 në vlerën 2,829,887,638 lekë. Llogaritë analizohen si më poshtë:

-Llogaria nr.210 “Toka, troje, terrene”, paraqitet me vlerë neto 0 , në vitet ushtrimore 2023 dhe në vitin 2022 në vlerën neto 0 lekë, pra nuk ka pësuar ndryshime.

Në mënyrë analitike llogaria nr.210 “Toka, troje, terrene” paraqitet si më poshtë:

Sipas pasqyres nr.10: Analitiku i Llogarisë nr.210 “Toka, troje, terrene” rrezulton se nga Bashkia Dimal nuk është ndërmarrë asnjë procedurë për rivlerësimin e tyre, për të mundësuar paraqitjen me vlerë reale. Kostot me të cilat këto zëra rezultojnë në listën analitike janë sa kosto fillestare në momentin e njohjes, veprim ky në kundërshtim me paragrafin 22 të SKK 5 “Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jomateriale” dhe sipas në pikës 30 të Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” dhe për pjesën më të madhe të tyre nuk zotërohet informacion për vitin e njohjes fillestare, shtesat e pakësimet për secilin zë më vete.

Nga analiza e kësaj llogarije rrezulton se nuk është pasqyruar:

a)Vlera e truallit nën objekt dhe truallit funksional të objekteve të ndërtesave të shkollave, të kopshteve, të pallatit kulturës, ndërtesat që ndodhen në Njësitë Administrative etj, sipas inventarit të aktiveve afatgjatë, të pasqyruara në llogarinë nr.212 “Ndërtime e Konstruksione”.

b)Vlera e trojeve të cilat me VKM kanë kaluar në pronësi të bashkisë, me VKM nr.467 datë 18.07.2012 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike e shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Dimal, Qarku Berat.

-VKM nr.114, datë 13.02.2013“Për miratimin e listeës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike e shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Dimal, Qarku Berat.

-VKM nr.307, datë 10.04.2013“Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike e shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Ura Vajgurore, Kutalli, Poshnjë, Cukalat.

-Gjendja e llogarisë nr.211 “Pyje, Kullota e Plantacione” në datën 01.01.2023 paraqitet në vlerën 7,185,712 lekë, dhe ne datën 31.12.2023 paraqitet po në vlerën 7,185,712 lekë, e cila tregon se dhe për këtë zë nuk ka patur ndryshime dhe nuk janë rivlersuar të gjitha pronat dhe asetet që disponon Bashkia Dimal.

Në mënyrë analitike llogaria nr.210 “Toka, troje, terrene dhe llogaria nr.211 “Pyje, Kullota, Plantacione” paraqitet si më poshtë:

| NR | Numri objekteve | Emertimi | Siperfaqja ne m ² | Siperfaqe e ndëtimimit m ² |
|----|-----------------|---------------|------------------------------|---------------------------------------|
| 1 | 35 | Ura Vajgurore | 14,464.7 | 8,711.9 |

| | | | | |
|---------------|------------|--|---------------------|------------------|
| 2 | 40 | Posnjë | 3,746.8 | 5,650.8 |
| 3 | 19 | Kutalli | 6,711.3 | 6,166.8 |
| 4 | 10 | Cukalat | 4,156.8 | 3,224.1 |
| 5 | 60 | Vorreza | 292,732 | 0 |
| 6 | 82 | Tokë buqësore, ullishte, pyje, kullota | 4,815,157.3 | |
| Totali | 246 | - | 5,136,968.90 | 23,753.60 |

Në pasqyrat e paraqitura konstatohet se nuk ka rregjistër për asetet të plotësuar me të gjitha modalitete dhe procedurat e ndjekura.

Pra nga 246 prona të Bashkisë Dimal rrezultojnë se vetëm 6 prona janë të rregjistruar me çertifikate rregjistrimi nga ASHK- Berat dhe këto janë rregjistruar në vitet 2008-2009, në kundërshtim me VKM nr.500, datë 14.8.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”; VKM nr. 433, datë 8.6.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive”; pika 66 dhe UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Përmenaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kap. III, pika 30,35/a; VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për rmiratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të pa trupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo- territorial”, Kreu III, pika 1 dhe UKM nr. 1, datë 18.7.2012 “Për procedurat e dhënies me qiratë tokave bujqësore të pandara”, kreu V, pika 4, si dhe Rregullores me nr 1043Prot. datë 31.01.2021”Specialisti i aseteve”.

Për sa me sa me sipër mbajnë përgjegjësi: Ish/ Drejtori i Planifikimit të Territorrit z. A.P deri në shkurt 2023, z. G.B Drejtori i Planifikimit të Territorrit, zj. R.M me detyrë Përgjegjse e sektorit të Urbanistikës, z. M.A me detyrë Specialist i rregjistrimit dhe licensimit

Nga analiza konstatohet se në llogarinë nr.211 “Pyje, kullota e plantacione”, nuk është paraqitur vlera e pyjeve dhe kullotave në pronësi të bashkisë Dimal, të transferuar me VKM nr.433, datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkisë, të Pyjeve dhe Kullotave publike, sipas listave të inventarit” e ndryshuar pika 46, shtojca nr.44, e cila përmban listën e inventarit të pyjeve dhe kullotave që transferohen në pronësi të Bashkisë Dimal sipas pasqyrës se paraqitur konstatohet se 50 % e tyre nuk janë vlersuar .

Nga auditimi i llogarive 210” “toka, troje e terrene, dhe llogarisë nr.211 “Pyje, kullota e plantacione” u konstatua se në këto llogari pasqyrohet vlera e tyre e pandryshuar në vijimësi duke mos pasqyruar:

-Vlerat e truallit nën objekt dhe të truallit funksional, të objekteve si ndërtesat e shkollave, kopshteve, pallati i kulturës dhe ndërtesat e njësive administrative.

-Për këto llogari nuk ekziston një rregjistër kontabël i mirëfilltë i përditësuar, në kundërshtim me udhëzimin nr. 30 dt 27.12.2011”Per menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, Kapitulli III pika 30 në udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e pregaditjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

-Vlerat e truallit nën objekt dhe të truallit funksional, të objekteve si ndërtesat e shkollave, kopshteve, pallati i kulturës dhe ndërtesat e njësive administrative.

-Për këto llogari nuk ekziston një regjistër kontabël i mirëfilltë i përditësuar, në kundërshtim me udhëzimin nr. 30 dt 27.12.2011”Per menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, Kapitulli III pika 30 në udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e pregaditjes,paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

-Llogaria nr.212 “Ndërtesa dhe Konstruksiione”, në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën neto 1.122,354,759 lekë dhe në fund të vitit ushtrimor 2022 paraqitet në vlerën neto prej 882,695,775 lekë. Referuar formatit 7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike), në fund të vitit 2023 paraqitet në koston historike prej 1,122,354,759 lek dhe ne fund te viti 2021 në vlerë 1,122,354,756 lekë, gjendje në mbyllje të vitit 2022 është rritur me vlerë 632,171 lekë.

-Llogaria nr.213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën neto 1,274,300,307 lekë dhe në fund të vitit ushtrimor 2022 paraqitet në vlerën neto prej 1,274,218,707 lekë. Referuar formatit 7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike), në fund të vitit 2023 paraqitet në koston historike prej 963,855,582 lekë dhe në fund të vitit 2022 paraqitet me koston historike 1,014,498,928 lekë.

- Llogaria nr.214 “Instalime teknike,makineri,paisje,vegla pune” në mbyllje të vitit 2023 paraqitet në vlerën neto 7,750,432 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën neto 11,977,990 lekë. Ndërsa referuar formatit 7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)”, në fund të vitit 2022 paraqitet në koston historike prej 22,546,784 lekë dhe në fund të vitit 2022 në vlerën 20,714,904 lekë.

-Llogaria nr.215 “Mjete transporti”, në mbyllje të vitit 2023 paraqitet në vlerën neto 28,545,997 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën neto 22,545,997 lekë. Ndërsa referuar formatit 7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)”, në fund të vitit 2023 paraqitet 72,091,613 lek në vitin paraardhës 202 në koston historike 72,091,613 lekë nuk ka ndryshime.

INVENTARË Llog.215 (Mjete transporti)

| Nr. | Emërtimi | Viti blerjes | Vlera fillestare | Amortizimi i Akumuluar | Vlera e mbetur |
|---------------|---|--------------|-------------------|------------------------|-------------------|
| 1 | Skrepi CAT 438 Skrep JCB | 2012 | 2 937 600 | 2 826 009 | 111 591 |
| 2 | Skrep JCB | 2021 | 3 900 000 | 1 903 200 | 1 996 800 |
| 3 | Motociklete 125CCBrand KEEYAY model target 125CC | 2019 | 323 252 | 224 501 | 98 751 |
| 4 | Auture LanRover me targa AA 611UD | 2022 | 474 000 | 170 640 | 303 360 |
| 5 | Makine Autoveture AA 763 AO (R.M) | 2011 | 1 498 800 | 1 463 143 | 35 657 |
| 6 | Makine e vjedhur BR 9830 A (Ne Hetuesi) e vjedhur | 2005 | 980 000 | 997 750 | - 17 750 |
| 7 | VË Touareg AA 150 NG (Muharrem Selenica) | 2003 | 2 736 000 | 2 800 220 | - 64 220 |
| 8 | Makine Transporti BR 9937 A(E.N) | 2004 | 2 350 000 | 2 399 562 | - 49 562 |
| 9 | Makina e Plehrave KAMA BR 2264 B , P.H) | 2006 | 960 000 | 973 815 | -13 815 |
| 10 | Kamioncine veteshkarkuese AA 917 JD | 2016 | 1 320 000 | 1 134 793 | 185 207 |
| 11 | Dum Dum Kama AA 216 SU | 2016 | 780 000 | 670 559 | 109 441 |
| 12 | Kamioncine dopio Ford Transit AA 506 FH M.S | 2016 | 1 200 000 | 1 031 629 | 168 371 |
| 13 | Kamion kater akse Targa AA602CP | 2017 | 7 776 000 | 0 | 7 776 000 |
| 14 | Makine Kamiocine Iveko AA693ES (G.K)) | 2016 | 2 520 000 | 2 169 407 | 350 593 |
| 15 | Eskavator me zinxhir VOLVOEC220D (F.B, E.G) | 2017 | 16 347 131 | 13 345 212 | 3 001 919 |
| 16 | Eskavator me zinxhir VOLVOECR88D (F.B, B.S) | 2017 | 9 055 196 | 7 392 338 | 1 662 858 |
| 17 | Zjarrfikese (M.S) 224 Su | 2017 | 4 918 560 | 4 015 336 | 903 224 |
| 18 | Mercedez Benx AA 355 OF (H.H) | 2018 | 3 240 000 | 2 469 545 | 770 455 |
| 19 | Motociklete 125CCBrand KEEYAY model target 125CC | 2019 | 323 252 | 224 501 | 98 751 |
| 20 | Mjete Zjarr Fikes tipi Ford Ronger Ab 062GU | 2022 | 8 451 822 | 3 042 655 | 5 409 167 |
| TOTALI | | | 72 091 613 | 49 254 815 | 22 836 798 |

- Llogaria nr.218 “Inventar ekonomik”, në mbyllje të vitit 2023 paraqitet në vlerën neto 88,080,404 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën neto 90,340,216 lekë. Ndërsa referuar formatit 7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)”, në fund të vitit 2023 paraqitet në koston historike prej 41,038,266 lekë dhe në fund të vitit 2022 në vlerën 47,344,224 lekë. Gjatë vitit ushtrimor ka pasur shtesa në llogari të materialeve në vlerën 13,000 lekë dhe pakësime në vlerën 2,272,812. Pakësimi vjen nga nxjerrjet jashtë përdorimi të cilat janë kontabilizuar pa u bërë asgjësi i aseteve që i përkasin kësaj llogarie.

- Amortizimi për këtë klasë llogarie bëhet në grup dhe jo për çdo zë më vete, dhe për shtesat e vitit 2023 amortizimi është llogaritur i plotë për 12 muaj, pasi nuk detajohet në mënyrë specifike data e saktë e njohjes së tyre.

- Në lidhje me këtë klasë llogarie nga ana e Bashkisë Dimal nuk është ndërmarrë asnjë proces inventarizimi, në listën analitike ka mjete, që kanë si vit të njohjes së tyre periudha shumë të hershme, konkretisht për mjete transporti nuk është identifikuar viti i njohjes, 1 mjet rezulton te jetë regjistruar 21 vite më parë, ç’ka tregon se nga ana e Bashkisë Dimal nuk janë marrë masa për verifikimin e tyre fizik për të konfirmuar funksionimin e tyre real dhe për të siguruar paraqitjen e saktë të vlerës në pasqyrat financiare.

-Gjendja e llogarisë nr.219 “Amortizimi i AAGJM & AAJM në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën (72,091,613) lekë.

Pasqyra statistikore nr. 7.b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me vlerën neto të tyre”

| Llog. | Teprica Neto | Shtesat gjate vitit | | Paksimet gjate vitit | | Teprica ne Fund | | |
|---------------|----------------------|---------------------|--------------------|----------------------|-----------|----------------------|---------------------|----------------------|
| | | Kosto Historike | Amortizim | Kosto Historike | Amortizim | Kosto Historike | Amortizim Akumuluar | Teprica Neto |
| b | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 |
| 20 | 48,601,733 | 1,860,000 | 7,290,260 | 0.00 | 0.00 | 73,276,016 | 30,104,543 | 43,171,473 |
| 201 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.0 |
| 202 | 48,601,733 | 1,860,000 | 7,290,260 | | | 73,276,016 | 30,104,543 | 43,171,473 |
| 203 | 0 | 0 | | | | 0 | | 0 |
| 21- 28 | 2,162,614 | 2,311,171 | 107,010,658 | 28,878,967 | 0 | 2,731,903,826 | 702,867,752 | 2,029,036 |
| 210 | 0.00 | 0.00 | | 0.00 | | 0.00 | 0.00 | 0.00 |
| 211 | 7,185,712 | | | | | 7,185,712 | 0.00 | 7,185,712 |
| 212 | 882,695,775 | 632,171 | 44,134,789 | | | 1,122,354,759 | 283,161,602 | 839,193,157 |
| 213 | 1,014,498,928 | 81,600 | 50,724,946 | | | 1,274,300,307 | 310,444,725 | 963,855,582 |
| 214 | 11,977,890 | 1,584,400 | 2,395,578 | 3,416,280 | | 20,714,904 | 12,964,472 | 7,750,432 |
| 215 | 28,545,997 | | 5,709,199 | | | 72,091,613 | 49,254,815 | 22,836,798 |
| 216 | | | | 0 | | | | 0 |
| 217 | | | | 0 | | | | 0 |
| 218 | 47,344,224 | 13,000 | 4,046,146 | 2,272,812 | | 88,080,404 | 47,042,138 | 41,038,266 |
| 24 | | | | | | | | |
| 28 | 170,366,002 | 0 | | 23,189,875 | | 147,176,127 | 0 | 147,176,127 |
| Totali | 2,211,216,261 | 4,171,171 | 114,300,918 | 28,878,967 | | 2,805,179,842 | 732,972,295 | 2,072,207,547 |

Përlllogaritja është bërë mbi vlerën neto në celje të periudhës ushtrimore për cdo grup aktivesh. Referuar tabelës formati 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata, vlera neto”, totali i amortizimit për vitin 2023 për klasat e aktiveve është përlllogaritur në vlerën prej (732,972,295) lekë, duke debituar llogarinë nr.1013 “Nga konsumi i AAGJ” (formati 4 “Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto”), në kredi të llogarive nr.2192 “Amortizimi ndërtesa dhe konstruksione” në vlerën (283,161,602)lekë, llogarine 2193 “Amortizimi i rruge rrjete “ ne vlerën (310,444,725) lek,llogarisë nr.219 “Amortizim makineri dhe paisje” në vlerën (12,964,472) lekë, llogarisë nr.2195 “Amortizim mjete transporti” në vlerën (49,254,815) lekë, llogarisë nr.2198 “Amortizim inventar ekonomik” në vlerën (47,254,815) lekë.

-Inventarizimi i aktiveve për vitin ushtrimor 2023, Bashkia Dimal.

Në bazë të Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, është kryer procesi i inventarizimit të aktiveve në fund të vitit 2023 për Bashkinë Dimal. Është kryer inventarizimi i aktiveve afatshkurtra, bazuar në urdhërin e Kryetarit të Bashkisë Dimal nr. 3672/709 datë 13/11/2023 “Për ngritjen e komisionit të inventarizimit dhe vlersimit të aktiveve të qendrueshme të inventarit (llogaria 327) dhe inventarit ekonomik (llogaria 218)”.

Nga ana e Bashkisë Dimal është ngritur komisioni i inventarizimit dhe i vlerësimit në të njëjtin urdhër, me Urdhrin nr.126 date 29.09.2022 “Për ngritjen e komisionit të inventarizimit dhe të vlerësimit të aktiveve (llog.218 dhe llog.327)”. Mbështetur në këtë urdhër komisioni ka mbajtur relacion për vlerësimin e aktiveve të Bashkisë Dimal (llogaria 218 dhe llogaria 327). Bashkia Dimal ka ngritur komisionin e asgjesimit të objekteve të inventarit (llogaria 327) dhe inventarit ekonomik (llogaria 218). Janë kryer procedurat e asgjesimit të aktiveve nga ana e Bashkisë Dimal. U konstatua se nga ana e Bashkisë Dimal është bërë pakësimi i aktiveve pasi janë bërë procedurat e asgjesimit të tyre në zbatim të Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Në disa raste, kryesisht të materialeve shkollore janë kryer inventaret sipas Urdherit nr.232 datë 06.06.2023 dhe Urdherit nr.709 datë 13.11.2023 për ngritjen e grupit të punës për inventarët e materialeve të Bashkisë Dimal.

Nga grupi i inventarizimit janë mbajtur proces verbalet datë 27.12.2023, por nuk janë asgjësuar pra nuk është përfunduar procedura e asgjesimit nga punonjësit z.G.B , Drejtori i Urbanistikës, D.K , Përgjegjëse e Sektorit të Burimeve Njerëzore, Isi Sheu Drejtor i Tatim-Taksave, F.P Drejtore e Kadastres, R.H Përgjegjëse e Sektorit të Kulturës, në kundërshtim me nenin 21 (Pika 12) të Ligjit 10463 datë 22.09.2011, ku shprehimisht thuhet “ Kryetarët e njësitë të qeverisjes vendore janë përgjegjës për menaxhimin dhe administrimin e mbetjeve që krijohen brenda territorit të tyre administrativ, në përputhje me kërkesat e këtij ligji.si dhe neni 55 (Pika 2-5) dhe neni 57 të ligjin 10 463 datë 22.09.2011, me ndryshime.

PASIVET (DETYRIMET)

Pasivet Afatshkurtra

Llogaritë e klasës 4, në pasiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, janë llogari të pagueshme dhe paraqesin detyrimet e Bashkisë Dimal më 31.12.2023, pagat e punonjësve të muajit dhjetor 2023, detyrimet kundrejt tatimeve, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të muajit dhjetor 2023, kreditorë për mjete në ruajtje si vijon:

| Llogaritë | | Viti 2023 | Viti 2022 | Diferenca/ndryshimi |
|-----------|---------------------------------------|-----------|-----------|---------------------|
| 401-408 | Furnitore e llogari te lidhura me to | 39827362 | 49415168 | -9588140 |
| 42 | Detyrime ndaj personelit | 13819362 | 13532625 | 286377 |
| 431 | Detyrime ndaj shtetit per tatim taksa | 595114 | 936365 | -341251 |
| 435 | Sigurime Shoqerore | 3858348 | 4116012 | -257664 |
| 436 | Sigurime Shendetesore | 530061 | 565319 | -35258 |
| 438 | Organizma te tjera shtetror | 71845 | 71845 | 0 |
| 466 | Kreditore per mjete ne ruajtje | 45189150 | 33247940 | 11941211 |
| 467 | Kreditore te ndryshem | 253749611 | 266150796 | -12401185 |
| 4341 | Operacione me shtetin(detyrime | 0 | 0 | 0 |
| | Gjendja më fund të periudhës | 357873219 | 368771670 | -10898451 |

Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, në fund të vitit ushtrimor 2023 është në vlerën 39,8287,028 lekë.

| Llog. 401-408 “Furnitorë e llogari te lidhura me to” | |
|--|-------------|
| Celje e vitit 2023 | 49,415,166 |
| Shtesa (K) | 211,634,821 |
| Pakësime (D) | 221,222,959 |
| Gjendja në 31.12.2023 (K) | 39,827,028 |

-Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm”, në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 253,749,611 lekë. Vlera e kësaj llogarie duhet të përfaqësojë detyrime për shpenzime të kryera, por jo të financuara në vitin ushtrimor. Kjo llogari ka si kundërparti gjendjen e llogarisë nr.486 “Shpenzime të ardhshme” e cila përbëhet nga vlera 253,749.611 lekë për detyrime te e prapambetura.

Për shpenzimet përkatëse :

| Përshkrimi | Vlera |
|--|--------------------|
| Detyrime të prapambetura për vendime gjyqësore | 9,140,021 |
| Detyrime të prapambetura për mirëmbajtjen | 5,786,867 |
| Detyrime të prapambetura për sherbime | 11,167,314 |
| Detyrime të prapambetura për investime | 188,058,599 |
| Detyrime të prapambetura për mallra | 39,596,810 |
| Totali | 253,749,611 |

-Llogaria 42, “Detyrime ndaj personelit”, sipas pasqyrave financiare të paraqitura pranë Bashkisë Dimal, paraqitet në vlerën 13,819,362 lekë dhe përfaqëson vlerën e pagave të muajit dhjetor e cila rakordon me vlerën sipas listë pagesave të muajit Dhjetor 2023.

-Llogaria 431, “Detyrime ndaj shteti për tatim taksa”, paraqitet në vlerën 595,114 lekë dhe përfaqëson vlerën për t’u paguar për taksa e tatime ndaj shtetit për muajin dhjetor.

-Llogaria 435, “Sigurime shoqërore” dhe llogaria 436 “Sigurime shëndetësore” paraqet vlerën e pa paguar për sigurime shoqërore e shëndetësore për pagat e muajit dhjetor 2023 që paguhet në muajin janar 2024 dhe janë përkatsisht në vlerat 3,858,348 dhe 530,061 lekë.

Llogaria 438 Organizma të tjera shtetërore paraqet detyrimin për një pjesë të ndihmës ekonomike të palikuiduar të dhjetor 2023 e cila është likuiduar në 2024 në vlerën 71,845 lekë.

Llogaria nr.466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”, nga pasqyra e pozicionit financiar për vitin 2023 paraqitet në vlerën kontabël prej 45,189,150 lekë, vlerë kjo e cila është e rakorduar me degën e Thesarit. Mbështetur në akt-rakordimet me thesarin gjatë vitit 2023 kjo llogari është shtuar me 14,372,661 lekë në total nga ngurtësimet e garancive të punimit të vitit, me 13,842,466 dhe pulla takse 530,195 lekë nga taksa e pullës dhe është pakësuar me 1,921,205 lekë nga likuidimet e garancive të punimit dhe 510,245 lekë . Prandaj, teprica kreditore e kësaj llogarie mbështetur në të dhënat e thesarit në fund të vitit 2023 është 45,189,150 lekë.

Nga analizimi i Pasqyrës së Performancës Financiare përsa i përket të ardhurave:

Llogaritë e financimit nga buxheti i shtetit për vitin 2023 (grant) paraqitet në shumën prej 472,619,443 lekë. Të ardhurat e realizuara nga Bashkia Dimal për vitin 2023 janë 168,095,560.36 lekë nga të cilat: Të ardhurat tatimore në vlerën 75,841,692 lekë dhe të ardhurat jo tatimore në vlerën 60,759,015,000 lekë, sipas aktit të rakordimit me degën e Thesarit.

- AUDITIMI I ZONAVE TË LLOGARISË

Paga, shpërblime e të tjera personeli (llog. 600) dhe sigurimet shoqërore (llog 601)

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në depozitonit nga Drejtoria Burimeve Njerëzore dhe drejtoria e financës në lidhje me zbatimin e dispozitave ligjore, që rregullojnë pagat dhe shpërblimet u konstatua se:

Organika për vitin 2023 ka funksionuar me 299 punonjës punonjës nga këto për administratën e aparatit të Bashkisë 97 punonjës, NJA Vajgurore 48, ku Nj.A Kutalli 3 punonjës, Nj.A Poshnje 3 punonjës, Nj.A Cukalat 3 punonjës dhe Agjensitë e varësisë 135 punonjës.

| Emërtimi | Viti 2023 | |
|---------------------------|-----------|------|
| | Plan | Fakt |
| Aparati i bashkisë. | 97 | 97 |
| NjA Ura Vajgurore | 58 | 58 |
| NJA Kutalli | 3 | 3 |
| Nj.Poshnjë | 3 | 3 |
| Cukalat | 3 | 3 |
| Te tjera struktura ndimse | 135 | 135 |
| Gjithsej : | 299 | 299 |

-Për të gjithë periudhën e audituar janë respektuar struktura dhe organika.

-Nga të punësuarit 65 janë të me statusin e nëpunësit civil, marrdhëniet e punës e të cilëve rregullohen me ligjit nr.152/2013 datë 30.05.2013 “Për Nëpunësin Civil”, ndërsa 234 punonjës janë me kontratë pune paradhëniet e punës të të cilëve rregullohen me ligjin nr. 7961, date 12.07.1995 “Kodit te Punës te Republikës se Shqipërisë” i ndryshuar.

-Përcaktimi i nivelit të pagave është bërë në përputhje me kërkesat e VKM nr. Nr. 165, datë 2.3.2016 “Për grupimin e njërive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njërive të vetëqeverisjes vendore ”i ndryshuar me VKM nr.177 datë 08.03.2017. Në hartimin e këtyre strukturave janë zbatuar kriteret e klasifikimit të vendeve të punës për organet e qeverisjes vendore në lidhjen nr.4 duke përshtatur dhe respektuar kufijtë e niveleve të pagave në përputhje me kategorinë e kësaj njësie vendore (50,000,-100,000 mbas zbatimit të Reformës Territoriale).

-Është mbajtur dhe azhurnuar libri i pagave e ditari i pagave.

-Nga auditimi i listë-pagesave u konstatua se listë-pagesat hartoheshin sipas standardeve të kontabilitetit, ku plotësoheshin pagat me të gjithë elementet dhe shtesa të ndryshme të përfituara deri tek shuma bruto. Po kështu pasqyroheshin llojet e ndalesave deri tek paga neto. Përmbledhëset janë të kundruara me listë pagesat dhe me urdhër pagesat respektive, të nënshkruara nga punonjësi i financës dhe titullari. Në dokumentacionin justifikues të shpenzimeve për paga rezultoi se liste pagesat janë nënshkruar nga punonjësi caktuar për menaxhimin e burimeve njerëzore, në zbatim te UMF nr. 30 dt. 27.12.2011 “Për menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, pika 69 “Listë pagesat plotësohen nga punonjësi i caktuar për pagat, duke u mbështetur në të dhënat e dokumentacionit bazë (liste prezencat e firmosur nga menaxheri i strukturëspërkatese) për shërbimin e kryer. Ato kontrollohen dhe nënshkruhen nga punonjësi i caktuar me menaxhimin e burimeve njerëzore dhe nëpunësi zbatues ose i deleguari i tij.”

-Nga verifikimi me zgjedhje i ushtruar në listë pagesat e muajit shtator të vitit 2023, rezultoi se pagat, shtesat dhe ndalesat janë përlllogaritur drejtë sipas tabelës së pagave si dhe kanë përputhje me nivelin e arsimit. Nga ky sondazh u verifikuan përcaktimi i niveleve të pagave dhe pagesa e tyre, ku rezultoi se: ato ishin në përputhje me nivelet e përcaktuar për shtesat e pozicionit si dhe shtesat e pagës së grupit përputheshin me nivelin e arsimit sipas përcaktimeve të lidhjes nr.4 të VKM të pagave dhe sipas kategorisë 3 së kësaj njësie vendore. Gjithashtu listë pagesat janë të shoqëruara dhe në përputhje me listë prezencat përkatëse.

Përmbledhëset janë të kuadruara me listë pagesat dhe me urdhër pagesat respektive, të nënshkuara nga punonjësi i financës dhe titullari.

-Për të gjithë periudhën e kontrolluar, janë përlllogaritur, ndaluar dhe xhiruar detyrimet për kontributin e sigurimeve shoqërore dhe tatimin mbi të ardhurat.

Nga sa me sipër kostatojmë se sipas Vendimit të Keshillit Bashkiak Dimal nr. 84 datë 27.12.2022 të konfirmuar me nr 960/1 prot ,date 11.01.2023 nga Prefekti i Qarkut Berat mbi miratimin me pagë dhe shtesa te punonjsve si dhe miratimin e buxhetit afatmesem të vitit 2023-2025 ku konfirmohet se numri i punonjsve do jetë 299 punonjës dhe rezulton se si numer është i plotsuar si struktura, por ka sektore të rëndesishem ku janë aprovuar 11 punonjes dhe rezultojnë 5 punonjes me vakance për 6 punonjes mugesë personeli në Drejtori i Planifikimit të Territorit, Emergjencave Civile , Hartimit të Projekteve, Intregimin European dhe Mardhenjeve me Publikun, pra stuktura e pa studjuar mire dhe për sa me lart kostatojme se mugon sektori i Aadministrimit ,Manaxhimit te Aseteve.

-Nga verifikimi rezultoi se në çdo rast shpenzimet e paraqitur në llogarinë 606 janë të mbështetura në dispozitat ligjore përkatëse dhe të shoqëruara më dokumentacionin e nevojshëm justifikues.

-U auditua krijimi dhe përdorimi i fondit të veçantë për periudhën 2023, nga u konstatua se është respektuar kufiri në masën prej 5% mbi fondin e pagave sipas kriterëve të përcaktuara në dispozitat ligjore në fuqi. Këto fonde janë të përdorur vetëm për raste dalje në pension si dhe raste fatkeqësisht në bazë të VKM nr. 929, datë 17.11.2010 “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë” të ndryshuar.

-Mallra dhe Shërbime (llogaria 602)

-Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve dhe ngjarjeve të kryera nëpërmjet arkës në lekë.

Mbajtja e kontabilitetit të ardhurave është bërë nga Drejtoria e Menaxhimit Financiar nga specialisti i financës që mbulon kontabilizimin e të ardhurave të realizuar nëpërmjet arkës dhe me bankës. Çdo regjistrim kontabël bëhet sipas mandat-arkëtimeve të arkës dhe të bankës. Kontabilizimi i të ardhurave është bërë i saktë në llogaritë e klasës 7 sipas llojeve të ardhurave. Për të ardhurat e arkëtuara nëpërmjet Arkës evidentohen në librin e arkës sipas mandat arkëtimeve dhe kryqëzohen me fatura për arkëtim të lëshuar nga Sektori i Tatim Taksave. Sektori Tatim taksave evidenton dhe rregjistron të gjithë llojet e të ardhurave të kryera nëpërmjet Bankës dhe Arkës e cila finalizohet me akt-rakordimin me Thesarin Dega për të ardhurat, të cilat nga verifikimi me zgjedhje për muajin shtator 2023 rakordonin me ditarin e të ardhurave. Nga Drejtoria e Menaxhimit Financiar është kryer rakordim mujor dhe progresiv për të ardhurat me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore, si dhe me Degën e Berat me anë të ekstrakteve të bankës pergjithe muajt progresive per vitin 2023 që korospondon me mbylljen e vittit ushtrimor. Nga Drejtoria e Menaxhimit Financiar administrohen dhe kontabilizohen letra me vlerë pullat e Gjendjes Civile, vlera e të cilave është kontabilizuar në llogarinë 466”Kreditorë të ndryshëm” gjendja në bilanc e të cilës paraqitet në fund të vitit 2023 në vlerën 19,950 lekë dhe është rakorduar për periudhen Janar-Dhjetor 2023 nga Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe Drejtoria e Tatimeve Berat.

-Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve dhe ngjarjeve të kryera nëpërmjet bankës në lekë.

Transaksionet financiare të kryera nëpërmjet bankës janë regjistruar në mënyrë kronologjike në ditarin e bankës në bazë të urdhër-shpenzimeve të cilat ishin të nënshkuara nga nëpunësi autorizues dhe zbatues të konfirmuar nga nëpunësi i Thesarit dhe të vulosura nga të dy palët.

Përpilimi i urdhër-shpenzimeve ishte i bazuar në dokumentet vërtetues dhe autorizues sipas natyrës së shpenzimit si urdhër prokurimi, procesverbale, oferta, kontrata, fatura e furnitorit, preventiva, situacione, fletëhyrje, listpagesa, deklaratimet e tatimit mbi të ardhurat, formularët e përlllogaritjeve

të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si nga punëdhënësi dhe nga punonjësi etj. Vlerat e shënuara në urdhër-shpenzim përputhen me vlerat e këtyre dokumenteve financiare që mbështesin këtë shpenzim. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës është bërë në mënyrë të saktë sipas destinacionit dhe sipas natyrës së shpenzimeve. Totali i shpenzimeve mujore dhe progresive kuadronin me konfermat bankare mujore. Nga verifikimi një për një i shumave të urdhër-shpenzimeve për periudhën 12-mujore rezultoi se totali është i barabartë me shumën e totale të shpenzimeve të akt-rakordimit përfundimtar të shpenzimeve me thesarin. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës sipas destinacionit dhe natyrës së shpenzimeve është bërë i saktë. Në fund të vitit ushtrimor është bërë rakordimi i llogarive që preken dhe është bërë prerja e artikujve kontabël.

Konkluzion: Nga auditimi i pasqyrave dhe ndjekja e procedurave të inventarizimit dhe vlerësimit të aseteve, u konstatua se Bashkia Dimal nuk ka arritur të certifikojë dhe regjistrojnë pronat që ka në administrim në 4 njësitë në varësi të saj. Nga 246 asete në përdorim, rezulton se vetëm 7 objekte janë pajisur në certifikatë pronësie dhe 239 asete nuk janë pajisur me certifikatë pronësie ose në 97% të tyre nuk janë ndjekur procedurat për ti regjistruar në ASHK- Berat. Lidhur me këtë konstatim, rezulton gjithashtu se në Drejtorinë e Urbanistikës në Bashkinë Dimal, e cila aktualisht administron edhe çështjet e pronësisë dhe aseteve në këtë Bashki, ka mungesë personeli, ku nga 11 punonjës të miratuar, janë vakante 6 vende me pasojë mos funksionim përkatësisht të Sektorit të Administrimit dhe Menaxhimit të Aseteve, Planifikimit të Territorit, Emergjencave Civile, Hartimit të Projekteve, Integritimit Evropian dhe Marrëdhënieve me Publikun. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Nenin 4, neni 5 dhe neni 43 i Ligjit nr. 20/2020 “Për Kadastrën”.

Konkluzion: Nga auditimi i llogarive nr.210 “Toka, Troje, Terrene” dhe nr.211 “Pyje, Kullota, Plantacione”, u konstatua se në këto llogari pasqyrohen vlerat e investimeve të kryera në vitet 2006-2018, pa ndryshuar në vijimësi, duke mos pasqyruar:

- vlerat e truallit nën objekt dhe të truallit funksional, të objekteve si ndërtesat e shkollave, të kopshteve, të pallatit të kulturës, ndërtesat që ndodhen në Njësitë Administrative, etj;
- vlerat e trojeve, pyjeve dhe kullotave të cilat me VKM kanë kaluar në pronësi të Bashkisë Dimal
- Nuk është kryer inventarizimi dhe vlerësimi i aseteve për dy llogaritë e mësipërme.
- Për llogaritë e mësipërme në Bashkinë Dimal nuk ekziston një regjistër kontabël, ku të specifikohet analitiku i llogarisë, data e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimi i aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datë e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia etj.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Kapitullin III, neni 9, pika 1.2 në Ligjin nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar; Pikat 26, 27, 30 dhe 74 në udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar; Kapitullin III, pika 30 në udhëzimin nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”.

Konkluzion: Nga auditimi i dokumentacionit mbi administrimin e nxjerrjen jashtë përdorimit të materialeve gjatë vitit ushtrimor 2023, nga Bashkia Dimal është ngritur komisioni i inventarizimit dhe i vlerësimit sipas Urdhrit nr.232 datë 06.06.2023 dhe Urdhrit nr.126 date 29.09.2022 “Për

ngritjen e komisionit te inventarizimit dhe të vlerësimit të aktiveve (llog.218 dhe llog.327)”,por nuk është vijuar me kryerjen e asgjësimit të tyre dhe nuk është bërë pakësimi i aktiveve ne bilanc për aktivet e nxjerra jashtë përdorimit.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” .

Konkluzion: Nga auditimi i llogarisë nr.215 “Mjete transporti”, e cila në mbyllje të vitit 2023 paraqitet në vlerën 72,091,613 lekë, rezulton se nuk janë marrë masa për përditësimin e vlerës së mbetur për përdorimin e 4 prej mjeteve të cilat kanë mbi 20 vite dhe e kane kaluar normën e amortizimit, duke u pasqyruar në vlerën 145,347 lekë, pra pa kryer dhe pakësimet përkatëse.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 për Menaxhimin e Aktive e në Njësitë e sektorit publik .

2.4 Mbi auditimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm

Me shkresen nr 989/9, datë 14/06/2023 është dërguar Raporti Përfundimtar dhe Rekomandimet për Auditimin e Përputhshmërisë të ushtruar në Bashkinë Dimal, sipas Programit të Auditimit me nr 121/1 Prot, datë 31.01.2023.

Nga Bashkia Dimal në lidhje me Reportin Përfundimtar të Auditimit, nuk ka patur kundërshtime për rekomandimet e dërguar nga KLSH, si dhe janë përcaktuar strukturat përgjegjëse për zbatimin e rekomandimeve dhe afatet përkatëse.

Bashkia Dimal ka përgatitur programin e masave që do të merren dhe realizohen për zbatimin e rekomandimeve ku janë përcaktuar afatet, personat apo drejtoritë përgjegjëse si dhe janë nxjerrë shkresat përkatëse për zbatim. Plan veprimi i masave për zbatimin e rekomandimeve është miratuar nga Kryetari i Bashkisë, znj. J.M dhe është dërguar në KLSH, brenda 20 ditëve me shkresën me nr. 2142/8 datë, 04/07/2023.

Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar, u konstatua se subjekti nuk ka dorëzuar raportin e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6-mujor, në kundërshtim me pikën nr. 2, neni 30, të ligjit nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, e cila citon: “*Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna.*”

Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 25 masa organizative, 5 masa për shpërbllim dëmi, 6 masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomikitet, eficensë dhe efektivitet të fondeve publike, të ardhura të munguara. I është rekomanduar Kryetarit të Bashkisë Dimal t’i kërkojë Komisionit Disiplinor pranë institucionit, masa disiplinore për 9 punonjësit të vënë përpara përgjegjësisë në material.

Nga auditimi rezulton se:

-Nga 25 masa organizative të rekomanduara, janë pranuar plotësisht për zbatim 25 masa Organizative, është zbatuar 1 masë, janë në proces zbatimi 5 masa, është zbatuar pjesërisht 1 masë dhe nuk janë zbatuar 18 masa.

-Nga 5 masa për dëm ekonomik, janë pranuar plotësisht për zbatim 5 masa. Ndër to, është zbatuar 1 masë, janë në proces zbatimi 2 masa, nuk janë zbatuar 2 masa.

-Nga 6 masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet të tyre, janë pranuar për zbatim 6 masa, nga të cilat janë në proces zbatimi 6 masa.

-Lidhur me marrjen e masave disiplinore në kompetencë të Bashkisë Dimal, u konstatua se nga 9 masa disiplinore të rekomanduara ndaj 9 punonjësve, janë zbatuar të 9-ta masat. Ndërkaq është kërkuar të njoftohet Departamenti i Administratës Publike dhe Komisioneri i Mbikëqyrjes së Shërbimit Civil, për punonjësit të cilët u është dhënë masë administrative, për të cilën kjo masë rezultoi të jetë pjesërisht e zbatuar.

Më konkretisht:

A. Masa organizative.

1. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi i pesë komponentëve të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, u konstatua se; referuar Strukturës dhe Organigramës së Bashkisë Dimal në Rregulloren e saj, në disa raste ka mbivendosje dhe mbingarkesë kompetencash. Në bazë të pyetësorit dërguar njësive të menaxhimit, nuk ka një urdhër nga titullari i institucionit për njohjen dhe trajnimin e stafit me rregulloren dhe bazën ligjore në fuqi. Nuk ka raporte periodike mbi zhvillimin e aktiviteteve të kontrollit sipas afateve të përcaktuara në Planin e Veprimit për Kontrollin e Brendshëm, në kundërshtim me Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Bashkia Dimal nuk ka një plan trajnimesh të brendshme, për rrjedhojë as një buxhet trajnimesh për punonjësit e shërbimit civil apo punonjësit marrëdhëniet me të cilët rregullohen me anë të Kodit të Punës. Bashkia Dimal nuk ka miratuar plan pune vjetor lidhur me funksionimin e Grupit për Menaxhimin Strategjik. Bashkia Dimal nuk ka një plan strategjik për veprimtarinë vjetore ose të viteve në vijim. Në Bashkinë Dimal nuk është hartuar dhe miratuar strategjia e menaxhimit të riskut. Vendosja e znj. M.B me detyrë shef finance dhe nëpunës zbatues i Bashkia Dimal, si kryetari i Njesisë së Prokurimit, është jo në përputhje me kuadrin ligjor rregullator të nëpunësit zbatues. Bashkia Dimal nuk ka procedurë të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT. Bashkia Dimal nuk ka hartuar dhe miratuar hartat e procesit të punës. Bashkia Dimal nuk ka miratuar gjurmën e auditimit. Nuk janë përditësuar raportet periodike apo publikimet vjetore për performancën e bashkisë në lidhje me shërbimet e ofruara publikut, planifikimin dhe realizimin prokurimeve, raporte të auditimit, institucionet e varësisë, nuk përditësohet informacioni mbi ndryshimet në strukturën e bashkisë, paketat fiskale.

1.1.Rekomandimi: Sektori i Burimeve Njerëzore në Bashkinë Dimal të hartojë një plan trajnimesh për punonjësit e këtij institucioni.

Të hartohet dhe miratohet Plani Strategjik i institucionit. Të hartohet dhe miratohet strategjia e menaxhimit të riskut.

Të miratohet Gjurma e Auditimit për institucionin. Sektorët dhe Drejtoritë që janë ngarkuar me zbatimin e aktiviteteve të cituara në Planin e Veprimit për Kontrollin e Brendshëm, duhet të hartojnë në mënyrë periodike raporte drejtuar titullarit, ku të përshkruhet ecuria e zbatimit.

Koment: Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion ky rekomandim rezultoi të jetë **i pazbatuar**.

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimtarisë dhe përbërjes së Sektorit të Auditit të Brendshëm, u konstatua se; nuk është ngritur Komiteti i Auditimit. Niveli profesional i punonjësve në Sektorin e Auditit të Brendshëm nuk është në standardin e përcaktuar nga ligji. Ka shmangie nga Plani Vjetor i miratuar nga titullari i institucionit, si dhe nuk është miratuar apo dokumentuar

ndryshimi i Planit në Raportin Vjetor referuar Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm. Dosjet e auditimit të brendshëm të njësive publike nuk arkivohen në arkivin e njësive vendore. Njësia e Auditimit të Brendshëm nuk ka çelur manualisht dhe elektronikisht dosjet e përhershme mbi njësitë e menaxhimit. Në dosjet e auditimit të realizuar nga Njësia e Auditimit nuk është dokumentuar plani i veprimit. Nga shqyrtimi i një prej dosjeve të auditimit të përzgjedhura, u konstatua mungesa e një sërë dokumentesh, të cilat parashikohen nga Manuali i Auditimit të Brendshëm. *Veprime jo në përputhje Ligjin nr. 114 dt. 22.10.2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, neni 11, 14. (Më hollësisht trajtuar në pikën nr. 1, faqe 9 - 30, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1.Rekomandimi: -Titullari i institucionit të miratohet Komitetin e Auditimit të Brendshëm në përputhje me ligjin dhe të certifikohen dy punonjësit e Sektorit të Auditimit të Brendshëm, sipas kërkesave të Ligjit për Auditimin e Brendshëm.

- Dosjet e auditimit të arkivohen sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.

Koment: Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, u konstatua se dy punonjëset e Sektorit të Auditimit të Brendshëm janë pajisur me certifikatën e Audituesit të Brendshëm. Për sa i përket Komitetit të Auditimit të Brendshëm, kjo strukturë nuk është miratuar nga titullari i institucionit, si dhe dosjet e auditimit të brendshëm vijnë të mos arkivohen sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi.

Për sa më sipër ky rekomandim rezulton të jetë pjesërisht i zbatuar.

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatohet se realizimi i shpenzimeve buxhetore për vitin 2022 me të ardhurat e veta (pa transfertën e pakushtëzuar) të Bashkisë Dimal ka diferencë me vlerën e planifikuar. Planifikimi i shpenzimeve me të ardhurat e veta ka vlerën 335,674,180 lekë, ndërsa realizimi në vlerën 319,520,908 lekë, ose në masën 95,16%. Niveli i realizimit të investimeve të planifikuara, i cili është zëri më kryesor i buxhetit në lidhje me ndikimin që ka në ofrimin e të mirave publike ndaj komunitetit, është akoma më i ulët se mesatarja e realizimit të buxhetit. Ky zë është planifikuar në vlerën 212,517 mijë lekë, realizuar 157,618 mijë lekë, ose në masën 74,16 %. Ky mos realizim vjen si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave, që do të thotë se nga Bashkia Dimal në fillim të vitit buxhetor planifikohen angazhime buxhetore, duke mos u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifatat vendore dhe ky planifikim nuk korrigjohet gjatë vitit, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat reale të realizuara. Në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9936, datë 26.06.2006 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 32, 65; UMF Nr.2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar pika 101; ligjit nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes Vendore”, neni 46.

3.1.Rekomandimi: Bashkia Dimal, të marrë masat për programimin e buxheteve afat mesëm sa më real, bazuar në radhë të parë me burimet e veta të financimit, duke zbatuar të gjitha procedurat ligjore. Të marrë masat, që në buxhetin e vitit ushtrimor, të programohet shlyerja e të gjitha detyrimeve kreditore të trashëguar nga viti paraardhës sipas kërkesave ligjore.

Koment: Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion ky rekomandim rezulton të jetë i pazbatuar.

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se totali i faturave të palikujduara në fund të vitit 2021, të llogarisë (401-408) “Furnitor e llogari të lidhura me to”, detyrime të tjera në llogar (467) “Kreditorë të ndryshëm”, paraqitet në vlerën në vlerën 266,150,796 lekë. Bashkia Dimal në datën 01.01.2022 ka pasur si çelje të vitit ushtrimor detyrime të prapambetura progresive vlerën

101,357,088 lekë, e cila ka si burim financimi të ardhurat e veta, dhe Nga kjo vlerë në planin e buxhetit vjetor 2022 është planifikuar për likuidim gjatë këtij viti 32,151,954 lekë nga investimet e FZHR-së, vlera 101,357,088 lekë, nga e cila është likuiduar vlera 91,926,520 lekë, ose 90,69% e vlerës së planifikuar, diferenca prej 9,430,568 lekë e pa likuiduar gjatë vitit 2022. Por gjatë vitit 2022 janë marrë angazhime të reja buxhetore pa pasur fonde në dispozicion, duke krijuar detyrime të reja të prapambetura në vlerën 137,394,223 lekë, duke e çuar në 31.12.2022 vlerën e detyrimeve të prapambetura me burim financimi të ardhurat e veta në 146,824,791lekë. Peshën kryesore të detyrimeve e zënë ato për investime në vlerën 122,634,948 lekë, ose në masën 83% të detyrimeve që kanë si burim financimi të ardhurat e veta bashkisë. Pra, në datën 31.12.2022 vlera e detyrimeve të prapambetura me burim financimi të ardhurat e veta, krahasuar me këtë vlerë në fillim të vitit ushtrimor (01.01.2022) është rritur me 45,467,703 lekë, ose në masën prej 44%.

Përveç sa më lartë më 31.12.2022 Bashkia Dimal ka krijuar detyrime të tjera të reja gjatë vitit 2022, me burim financimi nga granti (FZHR), të cilat janë detyrime për dy ujësjellës, në vlerën 119,326,005 lekë, duke çuar vlerën totale të detyrimeve të prapambetura më 31.12.2022 në 266,150,796 lekë. Peshën kryesore të detyrimeve totale (së bashku me detyrimet e FZHR) e zënë ato për investime në vlerën 223,961,553lekë, ose në masën 84% të totalit prej 266,150,796 lekë. Në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 61 dhe neni 54, “Kryerja e pagesave”, Ligjin nr. 25 datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, neni 15 pika 1 dhe nenin 11 pika 1, Ligjin nr.48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare” neni 7, afatet për autoritet publike, pika a), Udhëzimin nr. 9, datë 20.07.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, pikën 164.

4.1. Rekomandimi: Bashkia Dimal të marrë masa për hartimin sa më real të buxhetit, mbështetur në realizimin sa më objektiv të të ardhurave dhe shpenzimeve duke pasur parasysh shlyerjen e detyrimeve të prapambetura.

Koment: Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë ne dispozicion ky rekomandim rezulton të jetë i pazbatuar.

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të dosjes së dhënies me qira të fondit pyjor nga Bashkia Dimal, u konstatua se, është lidhur kontrata me nr. 912/13, datë 02.11.2021, me objekt “Për dhënien në përdorim të fondit pyjor”, me afat 10 vjet dhe me vlerën 971,500 lekë/vit, ndërmjet Bashkia Dimal përfaqësuar nga znj. J.M në cilësinë e Qiradhënësit dhe zhvillues subjektin “S ShPK” në cilësinë e Qiramarrësit. Kontrata e lidhur është bërë pas miratimit të Këshillit Bashkiak i cili me vendimin nr. 55 datë 02.09.2021, me 15 vota pro nga 21 anëtarë, është dhënë dakortësia për vijimin e procedurave të Heqjes nga fondi pyjor/kullor publik të sipërfaqe pyjore Bregu i pashijes dhe mali i Kozarës Për Zhvillimin e Aktivitetit Agroturizëm nga Shoqëria S ShPK, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Berat me shkresën nr. 614/1 datë 08.09.2021. Miratimi i dhënies së fondit pyjor nga Këshilli Bashkiak dhe kontrata e lidhur është dhënë jo në përputhje me kondicionet urbane sipas PPV në fuqi, në kohën e miratimit të kontratës, pasi në njësitë strukturore në të cilën është kërkuar të zhvillohet projekti i propozuar nuk lejohen ndërtimet e tipologjive të propozuara. Gjithashtu ndryshimi i zhvillimit të njërive të miratuar me PPV e re të vitit 2022, sjell edhe ndryshimin e statusit të resursit të tokës. Si rezultat i ndryshimeve nevojitet rishikimi i kushteve të kontratës të lidhur përpara miratimit të PPV dhe tarifave përkatëse të tokës në të cilën do të zhvillohet projekti. Veprime jo në përputhje me Ligjin nr.57/2020, “Për pyjet”, Neni25, pika 3, Ligjin nr. 107/2014, datë 31.07.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, neni 12, pika c, neni 13, neni 20, Plani i Përgjithshëm Vendor miratuar me vendim të

KKT nr. 3 datë 08.02.2017, i ndryshuar. Plani i Përgjithshëm Vendor miratuar me Vendimin nr. 04, datë 14.12.2022, Udhëzimi nr. 1, datë 16.03.2017, “Për mënyrën dhe procedurat e zbatimit të planeve të përgjithshme vendore”, i ndryshuar, pika 5.

5.1.Rekomandim: Këshilli Bashkiak, Kryetari i Bashkisë Dimal, të marrë masat e duhura që, të rishikojnë të gjithë procesin e dhënies me qira të fondit pyjor dhe kontratën e nënshkruar, të rishqyrtojnë projektin e paraqitur nga subjekti “S” ShPK si kontraktues për dhënie e fondit pyjor, sipas kushteve dhe tarifave të miratuara, për resursin e tokës, me qëllim arkëtimin e të ardhurave në përputhje me këto tarifa, përshtatjen e tipologjisë së ndërtimit në zonat me aktivitete sociale dhe rekreative, sipas PPV të miratuar me vendimin të KKT nr. 04, datë 14.12.2022 dhe Ligjit nr. 57/2020, datë 30.04.2020, “Për pyjet”.

Koment: Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, rezulton se rekomandimi i mësipërm është në proces zbatimi.

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të procedurave të prokurimit u konstatua se; në 5 (pesë) procedura prokurimi, nga Autoriteti Kontraktor janë vendosur kritere e kërkesa të veçanta si licenca, akte ekspertiza ligjore etj., si dhe specifikime teknike të cilat nuk janë sqaruar në mënyrë teknike dhe ligjore për lidhjen e ngushtë me objektin e prokurimit dhe natyrën e kontratave.

Vendosja e kritereve kufizuese dhe të pa argumentuara sjellin për pasojë diskriminim dhe trajtimin e pabarabartë të ofertuesve në procedurat e prokurimit publik. Veprime të cilat bien ndesh me qëllimin dhe parimet e kuadrit ligjor për prokurimin publik, Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 1, nenin 3, Kreu V, neni 21, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu X, neni 40, pika 3, neni 78, pika 2, ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 12, pika 2/a, VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 45/1 pika 2, neni 59, pika 2.

6.1.Rekomandimi: Autoritetit Kontraktor Bashkia Dimal, Përgjegjësi i Prokurimeve, të marrë masat e duhura që në procedurat e prokurimit publik të mbahen parasysh kërkesat ligjore për argumentimin e të gjitha kritereve të vendosura dhe specifikimeve teknike, të lidhura me objektin e prokurimit dhe natyrën e kontratave, me qëllim konkurrencën e lirë dhe shmangien e kërkesave diskriminuese, ndaj operatorëve ekonomikë.

Koment: Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, rezulton se rekomandimi i mësipërm është në proces zbatimi.

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi zbatimin e kontratës së furnizimit me karburant konstatohet se nuk është hartuar raport për monitorimin e zbatimit të kontratës, për t’u siguruar se cilësia e mallrave të furnizuara ka qenë ose jo në përputhje me cilësinë për të cilën OE kontraktues është shpallur fitues i kësaj procedure, dhe nuk është raportuar në APP për zbatimin e kontratës. Veprim jo në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 77, pika 3, pika 4, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, pika 43.

7.1.Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor Bashkia Dimal, në zbatimin e kontratave të furnizimit të marrë masat për të hartuar raportet e monitorimit të zbatimit të kontratës, për t’u siguruar se cilësia e mallrave të furnizuara ka qenë ose jo në përputhje me cilësinë për të cilën OE kontraktues janë shpallur fitues.

Koment: Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, rezulton se rekomandimi i mësipër është në proces zbatimi.

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi zbatimin e rekomandimeve konstatohet se, Bashkia Dimal nuk ka dërguar raport brenda 6-muajve për realizimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna. Gjithashtu rezulton se Bashkia Dimal nuk ka raportuar në Këshillin Bashkiak mbi rezultat e zbatimit të këtyre rekomandimeve, veprime këto jo në përputhje me ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 50, pika 5.

8.1.Rekomandim: Bashkia Dimal të marrë masa për të kryer raportimin periodik në Këshillin Bashkiak lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH në përfundim të çdo auditimi. Gjithashtu të raportohet në auditimet në vijim brenda afatit të përcaktuar për zbatimin e rekomandimeve të lëna.

Koment: Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion ky rekomandim rezulton të jetë i pazbatuar.

9. Gjetje nga auditimi: Bashkia Dimal nuk ka marrë masat e duhura për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm e konkretisht:

a. Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 16 masa organizative janë pranuar 16 masa nga të cilat janë realizuar 3 masa, janë në proces 3 masa, janë zbatuar pjesërisht 3 masa dhe nuk janë zbatuar 7 masa.

b. Për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike-të ardhura të munguara janë rekomanduar 4 masa nga të cilat, janë pranuar për zbatim 4 masa, janë zbatuar 1 masë, janë në proces zbatimi 2 masa, dhe është 1 masë pjesërisht e realizuar.

c. Në lidhje me masat disiplinore në kompetencë të Bashkisë Dimal, për punonjësit e saj konstatohet se nga ana e Bashkia Dimal nuk janë marrë masat e duhura për dhënien e masave disiplinore për punonjësit e konstatuar me shkelje dhe me përgjegjësi në Raportin e auditimit të mëparshëm. Veprime këto jo në përputhje me Ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15, “Të drejtat e KLSH”, germa j), ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar.

9.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Dimal të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësinë për moszbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e mëparshëm. Të marrë masa të përshpejtuara për zbatimin e rekomandimeve që janë ende të pa zbatuara dhe pjesërisht të zbatuara si më poshtë:

Koment: Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion ky rekomandim rezulton të jetë i pazbatuar.

3.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, si dhe Drejtoria e të Ardhurave Vendore, të marrin masa për një planifikim të studiuar të buxhetit, duke u mbështetur mbi parashikime të studiuar dhe realiste të të ardhurave. Mbi bazën e këtyre të ardhurave të parashikohet edhe plani shpenzimeve publike, me qëllim që këto shpenzime të kenë burime financimi të sigurta për tu realizuar. Nëse gjatë vitit ka mosrealizim të të ardhurave të planifikuara, atëherë Kryetari i Bashkisë, brenda afateve që përcakton kuadri rregullator në fuqi, të kërkojë korrigjimin e buxhetit nga këshilli bashkiak, me qëllim që të mos ketë diferenca midis planifikimit dhe realizimit të shpenzimeve.

Koment: Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë ne dispozicion ky rekomandim rezulton të jetë i pazbatuar.

4.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Dimal dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të marrin masa për likuidimin e detyrimeve ndaj të tretëve brenda afatit 30 ditor nga momenti i ardhjes së faturës. Lidhja e kontratës të bëhet vetëm pasi fondi të jetë në dispozicion në llogarinë e thesarit të autoritetit kontraktor, duke eliminuar në këtë mënyrë shkakun e krijimit të detyrimeve të reja prapambetura. Gjithashtu të merren masa për likuidimin e detyrimeve të prapambetura të krijuara në vitet e mëparshme.

Koment: Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë ne dispozicion ky rekomandim rezulton të jetë i pazbatuar.

5.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Dimal të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatohë, me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kanë sjellë humbjen e çështjes gjyqësore. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen të procedurave të gabuara të ndjekura për çështjen e largimit të punonjësve nga puna dhe çështje të tjera, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet.

Koment: Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë ne dispozicion ky rekomandim rezulton të jetë i pazbatuar.

6.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Dimal në bashkëpunim me Drejtoria e Burimeve Njerëzore të marrë masa për plotësimin e stafit të DAV Bashkia Dimal me specialistë të fushës dhe përshtatja e strukturës sipas natyrës së menaxhimit të të ardhurave, duke krijuar Sektorin e Menaxhimit të Borxhit.

Koment: Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë ne dispozicion ky rekomandim rezulton të jetë i pazbatuar.

8.1.Rekomandimi; Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Dimal, të marrë masa për evidentimin e diferencave të pa mbledhura nga Agjentët Tatimore, sipas llojit të taksës/tarifës, të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj dhe të fillojë procedurat për penalizmin e Agjentëve Tatimore me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të pa mbledhura apo të shmangura.

Koment: Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë ne dispozicion ky rekomandim rezulton të jetë i pazbatuar.

8.2.Rekomandimi; Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të krijojë bazën të dhënave për subjektet, tarifat apo taksat të cilat mbledhen nga Agjentët Tatimore, të kryqëzojë informacionet me institucionin e tjera përkatëse dhe rakordimet të bëhen në fund të çdo muaj sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministria e Financave.

Koment: Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë ne dispozicion ky rekomandim rezulton të jetë zbatuar.

10.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet të llogarisë 4342 Operacione me shtetin” dhe kundër partisë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” Veprimet sistemuese të bëhen me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2022.

Koment: Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë ne dispozicion ky rekomandim rezulton të jetë i pazbatuar.

11.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës të marrë masa për sistemimin e llogarisë (202) “Studime dhe kërkime”, duke bërë që në këtë llogari të paraqitet vetëm vlera e projekteve, për të cilat investimet e lidhura me to nuk kanë përfunduar. Për projektet të cilat kanë përfunduar, vlerat të kapitalizohet sipas objekteve përkatëse dhe regjistrohen në llogaritë përkatësisë, si pjesë e kostos totale të objektit.

Koment: Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë ne dispozicion ky rekomandim rezulton të jetë i pazbatuar.

12.1.Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Dimal në cilësinë e Nëpunësit Autorizues, të marrë masa të menjëhershme për të kryer procedurat ligjore të rivlerësimit të 76 prona të certifikuar në ASHK, por pa vlerë respektive si dhe paraqitjen e vlerës së këtyre aktiveve në Pasqyrën e Pozicionit Financiar të njësisë publike vendore Bashkia Dimal më 31.12.2022, pasqyrimin e tyre në kontabilitet me vlerë reale historike (referuar tregut), si dhe kryerjen e veprimeve kontabël referuar rezultatit (rritje/ulje rivlerësimi), respektivisht në llogaritë përkatëse(21) “Aktive afatgjata materiale” e llog.(109) “Diferenca nga rivlerësimi”.

Koment: Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë ne dispozicion ky rekomandim rezulton të jetë i pazbatuar.

13.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Dimal të analizojë situatën e mos zbatimit plotësisht të rekomandimeve të dërguara nga KLSH-ja me shkresën Nr. 241/44 datë 13/04/2021, duke nxjerrë përgjegjësitë e personave përgjegjës, si dhe të hartojë plan pune të veçantë e të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për ri zbatimin e plotë të tyre, konkretisht:

a-Për 3 masa organizative të cilat janë në proces si dhe për 5 masa organizative të pa zbatuar

b-Për 6 masë shpërblim dëmi në vlerë 41,735,450 lekë.

Koment: Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë ne dispozicion ky rekomandim rezulton të jetë i pazbatuar.

2.1.Rekomandimi: Drejtoria e Shërbimeve dhe e Licencave në bashkëpunim me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore dhe Policinë Bashkiake, Bashkia Dimal, të ndjekë të gjitha rrugët administrative e ligjore për pajisen me licenca të subjekteve që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre dhe arkëtimin e tarifës së pataksuar prej 2,800,000 lekë ndaj 5 subjekteve, sipas pasqyrës Aneks nr. 6 pika 2.6 bashkëlidhur raportit të auditimit.

Koment: Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë ne dispozicion ky rekomandim rezulton të jetë i pazbatuar .

10. Gjetje nga auditimi: Nga kontrolli në sistemin e-leje për lejet e ndërtimit rezulton se: Leja me nr. prot 2105 datë 11.09.2020 me zhvillues DARDHA BIO me objekt Magazinë dhe dy stalla për rritjen e shpendëve me adresë Ura Vajgurore nuk është marrë miratim nga TAP-i bazuar mbi sugjerimin që i është dhënë nga përgjigjja e shkresës së AZHT, nr.437 dhe leje ndërtimi: Magazine bujqësore 1 kat ne Drenovicë, Ura Vajgurore adresa e realizimit të punimeve: Ura Vajgurore Fshati Drenovicë nuk është marrë mendim nga institucionet si AKM, AZHT. Me nr. 2977/1, datë 24/09/2021 dhe leje ndërtimi nr. 3360/1, datë 10/11/2021, për magazine shërbimi 1 kat " adresa e realizimit të punimeve: Kutalli, Dimal bazuar mbi përgjigjen e kthyer nga ana e ARRSH-së ku

citohet se duhet të respektojë distancat nga kufiri rrugor si dhe të aksesit të bëhet në rrugët e brendshme dhe jo në aksin kombëtar Berat-Fier. Me nr. prot 1514 dhe leje zhvillimi 3827/1 datë 13.12.2021 bazuar mbi kthimin e përgjigjes nga ana e ARRSH-së ku në atë aks ka projekt zhvillimi nga ana e FSHZH dhe DPZHTK e bashkisë Dimal të marrë masa për të bërë ballafaqimin nëse kjo leje e miratuar prek ose jo projektin e zhvillimit që do realizojë FSHZH. Veprime jo në përputhje me VKM nr. 408, datë 13.05.2015 neni 15 pika ë.

10.1.Rekomandime: Nga DPKZHT Dimal të merren masa për të marrë konformitetin nga institucionet e përfshira dhe ti respektojë rekomandimet e tyre.

Koment: Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë ne dispozicion ky rekomandim rezulton të jetë i pazbatuar.

11. Gjetje nga auditimi: Nga kontrolli në sistemin e-leje për certifikatën e përdorimit me të dhënat: “Banese 1 kat mbuluar me çati, me bodrum në fshatin Donofrose, Njësia Administrative Cukalat, Bashkia Dimal, paraqitur nga zhvilluesi F.S me nr. prot 1553 Certifikatë përdorimi, rezulton se nuk përputhet realizimi në terren i objektit bazuar mbi imazhet e ngarkuara në sistemin e-leje krahasuar me projektin e miratuar. Veprime jo në përputhje me VKM nr. 408 datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, neni 27.

11.1.Rekomandime: Nga DPKZHT Dimal të merren masa për të respektuar me përpikmëri zbatimin e projektit të miratuar.

Koment: Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë ne dispozicion ky rekomandim rezulton të jetë i pazbatuar.

12. Gjetje nga auditimi: Nga kontrolli i inspektoratit të mbrojtjes së territorit bashkia Dimal u konstatua se arsimimi i kryeinspektorit nuk është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Si rezultat i kësaj, në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë së IMTV rezultoi se në 10 raste nuk është mbajtur vlera e gjobës sipas kuadrit ligjor në fuqi. Veprim jo në përputhje me Ligjin nr. 9780 datë 16.07.2007 “Për Inspektimin e ndërtimit”, nenin 11 dhe nenin 52. Gjithashtu nga kontrolli i inspektoratit të mbrojtjes së territorit u konstatua se në 58 raste është konstatuar se janë mbajtur proces-verbal kundërvajtje por nuk kanë dalë me vendime gjobe, në 94 raste është mbajtur proces-verbal kundërvajtje është mbajtur dhe vendim me gjobë por nuk është mbajtur vendim prishje. Veprim jo në përputhje me Ligjin nr. 9780 datë 16.07.2007 “Për Inspektimin e ndërtimit”, neni 4 dhe në nenin 5.

12.1.Rekomandime: Nga ana e kryetarit të bashkisë Dimal të merren masa për të emëruar në krye të këtij Inspektoriatit punonjës me arsim të duhur sipas kuadrit ligjor në fuqi. Gjithashtu nga IMTV të merren masat e duhura për rastet e konstatuara me shkelje të vendosën kundërvajtjet administrative përkatëse.

Koment: Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë ne dispozicion ky rekomandim rezulton të jetë i pazbatuar.

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dosjes së procedurës së prokurimit me objekt “Rikonstruksion i rrugës Sheq-Gajdë”, me fond limit në shumën 60,391,938 lekë, në fazën e vlerësimit të ofertave u konstatua se: Në këtë procedurë kanë marrë pjesë dy BOE, e konkretisht BOE “LL ShPK & V ShPK & E ShPK” me vlerë oferte në shumën 37,414,293 lekë dhe BOE K ShPK & F ShPK”, me vlerë oferte në shumën 57,305,850 lekë. Nga procesi i vlerësimit të KVO rezulton se të dy BOE pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e AK por një prej tyre ka paraqitur ofertë anomalisht të ulët. Grupi i auditimi pasi shqyrtoi të gjithë dokumentacionin e paraqitur nga

ofertuesi dhe komisioni i ngritur, arrin në përfundimin se s'kualifikimi i "LL ShPK & V ShPK & E ShPK", është i padrejtë dhe se dokumentacioni i paraqitur justifikon vlerën e ofertës së dhënë për shkak se një pjesë e zërave të preventivit gjenden pranë zonës së Bashkia Dimal me çmime/kosto më të ulët dhe të favorshme nga manuali i çmimeve të punimeve të ndërtimit. Gjithashtu BOE ka paraqitur dëshmi se plotëson kërkesat e cilësisë së AK dhe dokumentacionin e kërkuar për të cilat ka deklaruar se merr përsipër kryerjen e punimeve sipas të gjitha kushteve të kërkuara nga Bashkia Dimal sikurse ka paraqitur dhe dokumentacionin shtesë për të justifikuar dhe dhënien e ofertës, pavarësisht se ka qenë anomalisht e ulët. Nëse do të kualifikohej BOE "LL ShPK & V ShPK & E ShPK", Bashkia Dimal do të kryente këtë procedurë me një vlerë 19,891,557 lekë më pak. Pra **shuma prej 19,891,557 lekë pa TVSh përbën efekt financiar negativ** për buxhetin e Bashkia Dimal. *Veprime jo në përputhje me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", nenin 2, nenin 93, pika 2.*

13.1.Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor Bashkia Dimal, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, të marrë masat e duhura që, të mbajë në konsideratë të parimet e prokurimit publik, gjatë procesit të vlerësimit të ofertave, me qëllim përdorimin e fondeve me ekonomicitet, efikasitet dhe efikasitet.

Koment: Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion ky rekomandim rezulton të jetë në proces zbatimi.

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt "**Rrjeti jashtëm dhe brendshëm, njësia administrative Cukalat, Bashkia Ura Vajguore**", me fond limit në shumën 201,420,870 lekë pa TVSh dhe me vlerë kontrate në shumën 200,412,476 lekë pa tvsh, me BOE fitues "S ShPK dhe G ShPK". Bashkia Dimal, nëpërmjet Komisionit të vlerësimit të ofertave, në të cilën, nga 3 OE pjesëmarrës, ka s'kualifikuar 2 OE për mosplotësim të kriterëve të kërkuara dhe ka kualifikuar 1 OE. Nga verifikimi i dokumentacionit të BOE të kualifikuar dhe shpallur fitues, rezulton se, BOE i kualifikuar nuk ka plotësuar të gjitha kriteret e kërkuara nga AK, pra në këtë rast tenderi duhet të anulohet. Mos anulimi i procedurës së prokurimit ka çuar në kualifikim dhe shpallje fitues të OE i cili nuk plotëson kriteret e vendosura në DST, duke sjellë si rezultat lidhjen e kontratës në kushtet e paligjshmërisë të procedurës së prokurimit publik në **vlerën 238,203,283 lekë** me TVSH. Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006, "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar, neni 1, neni 46, neni 53, VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", ndryshuar, neni 66, pika 3, VKM nr. 514, datë 15.8.2007 "*Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit*", i ndryshuar me Vendim nr. 664, datë 26.9.2012 "*Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 514, datë 15.8.2007 të Këshillit të Ministrave 'Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit*", pika 10, pika 11.

14.1.Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor, Përgjegjësi i Prokurimeve në Bashkia Dimal, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, të marrë masat e duhura që, të mbajë në konsideratë të gjitha aktet ligjore në vlerësimin e OE pjesëmarrës në kushtet kur ata plotësojnë të gjitha kërkesat e vendosura nga AK.

Koment: Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion ky rekomandim rezulton të jetë në proces zbatimi.

B. Masa për shpërblim dëmi

1.1 Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt "**Rikonstruktion i rrjeteve shpërndarës të ujës-jellës në bashkinë Ura Vajguore**", me kontratë

nr.2515/5 Prot, datë 16.10.2020, me vlerë kontrate në shumën 71,774,494 lekë me TVSH, me sipërmarrës S ShPK, referuar preventivit të punimeve, në lidhje me zëri Shtresë çakëlli t=20 cm.u konstatua se; Nga vëzhgimi në terren i mbulimit të tubacioneve të dërgimit nga st. pompave në depo nuk u konstatua që këto tubacione të mbulohe me çakëll 20cm derisa shtresa e çakllit është e fundit dhe do të ishte e dukshme nëse do ishte vendosur. Janë situacionuar 2209 m2 shtresë çakëlli t=20 cm me vlerë 618,547 lekë. Veprime jo në përputhje me Ligji 8402 date 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” neni 7, si dhe kontrata Nr. 2515/5 Prot, datë 16.10.2020.

1.2 Rekomandim: Nga ana e bashkisë Dimal të merren masa për të arkëtuar shumën prej **618,547 lekë** vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Koment: Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë ne dispozicion ky rekomandim rezulton të jetë i pazbatuar.

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “**Rikonstruksioni i qendër komunitare Llambi Mile, Bashkia Ura Vajgurore**” Vlera e kontratës 40,608,800 lekë pa TVSH sipërmarrësit BOE M ShPK dhe N ShPK me kontratë nr.3086/10 Prot, datë 17.12.2020 u konstatua se: Zëri 2.267/1 Shtresë me pllaka porcelani importi është situacionuar 572 m2.Sipërfaqja reale e matur nga jashtë në terren rezulton të jetë 526 m2.Duke zbritur dhe muret e jashtëm dhe të brendshëm llogaritur dhe lartësinë e plinteve rezulton se duhet ti zbresim 33 m2 sipërfaqe. Në total janë 526 m2-33m2=493 m2 sipërfaqe e shtruar me pllaka porcelani importi.573-492=79 x 2753 lekë/m2=217,487 lekë.

-Instalimet telefon/internet: Nga kontrolli në terren nuk u konstatuan këto instalime me vlerë në total për gjithë nen zërat e kësaj rubrike janë në vlerë 55,350 lekë.

-Enë zgjerimi të kaldajës copë 2 me vlerë 82,800 lekë nuk janë konstatuar nga ana e grupit të auditimit si dhe nga ana e mbikëqyrësit. Vlera totale prej **355,637 lekë** përbën dëm ekonomik si pasojë e punimeve të përfunduara dhe situacionimit të volumeve më shumë se gjendja faktike në terren. Veprime jo në përputhje me Ligjin nr. 8402 date 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” neni 7 si dhe Kontrata nr. prot.38/7 datë 23.12.2020.

2.1.Rekomandim:Nga ana e bashkisë Dimal të merren masa për të arkëtuar shumën prej **355,637 lekë** vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Koment: Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë ne dispozicion, u konstatua se në zbatim të këtij rekomandimi, nga Titullari i Bashkisë ka dalë Urdhëri nr. 2149/10, datë 03/07/2023, si dhe njoftimi nr. 2142/3 datë 03/07/2023, ku ngarkohet Drejtoria Juridike për zbatimin e tij. Ne zbatim të këtij rekomandimi është depozituar padi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë, për arkëtimin e dëmit ekonomik, me shkresën nr. 2865 datë 11/09/2023. Për sa më sipër ky rekomandim rezulton të jetë **në proces zbatimi**.

3.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt **Ndërtim kopshtesh në lagjen 28 nëntori Ura Vajgurore, Syzes dhe lagje 4 shtatori** Vlera e kontratës 21,609,579 lekë me TVSH sipërmarrësit F. ShPK me kontratë nr.1576/13 Prot, datë 16.10.2020 është konstatuar se : Zëri i punës F.V dritare druri dopio xham 12.6 m2 dhe F.V dyer druri me dy çarje vertikale me xham 6.2 m2.Nga matjet në terren rezulton se sipërfaqja e dritareve është 14.3m2.Diferenca 18.8m2-14.3 m2=4.5 m2 x 12000 lekë/m2=**54,000 lekë**. Veprime jo në

përputhje me Ligjin nr. 8402 date 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” neni 7, si dhe Kontrata me nr, prot 36/7 datë 30.10.2020.

3.1.Rekomandim: Nga ana e bashkisë Dimal të merren masa për të arkëtuar shumën prej **54,000 lekë** vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Koment: *Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë ne dispozicion ky rekomandim rezulton të jetë në proces zbatimi.*

4.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i sistemit e-leje për lejet e miratuara nga ana e DPZHTK Bashkia Dimal u konstatua se për lejen e ndërtimit njësi shërbimi adresa e realizimit të punimeve: Kutalli, Dimal me nr. prot 1514 dhe leje zhvillimi 3827/1 datë 13.12.2021 taksa e ndikimit në infrastrukturë nuk është llogaritur saktë dhe ka një diferencë **prej 286,149 lekë shumë e cila përbën të ardhur të munguar** për buxhetin e Bashkisë Dimal, si dhe për lejen nr. 2471/2, datë 24/08/2021 fabrikë për përpunimin e vajit të ullirit, bashkia ura vajguore taksa e ndikimit në infrastrukturë nuk është llogaritur saktë dhe ka një diferencë prej **110,373 lekë shumë e cila përbën të ardhur të munguar** për buxhetin e Bashkisë Dimal. Veprime jo në përputhje me Ligjin nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Neni 46, si dhe me Vendimin e KB nr. 80 datë 24.12.2021 “Mbi miratimin e taksave dhe tarifave vendore për bashkinë Dimal dhe njësitë administrative”.

4.1.Rekomandim: Nga ana e DPZHTK bashkia Dimal të merren masa për të arkëtuar shumat prej 286,149 lekë dhe 110,373 lekë shuma të cilat përbëjnë të ardhura të munguara në buxhetin e bashkisë si dhe të merren masa për të llogaritur në mënyrën e saktë taksën e ndikimit në infrastrukturë.

Koment: *Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë ne dispozicion, u konstatua se në zbatim të këtij rekomandimi nga Titullari i Bashkisë ka dalë Urdhëri nr. 2149/10 datë 03/07/2023, si dhe njoftimi nr. 2142/5, datë 03/07/2023, dhe nr. 2142/6, datë 03/07/2023, ku ngarkohet Drejtoria Juridike për zbatimin e tij. Nga verifikimi i dokumentacionit të njoftimit dhe dokumentave të thesarit, rezulton se është kryer pagesa e këtyre detyrimeve nga subjektet të cilët kanë arkëtuar dëmin ekonomik sipas rekomandimit përkatës. Për sa më sipër ky rekomandim rezulton të jetë i zbatuar.*

5. Gjetje nga auditimi: Nga kontrolli i dosjes teknike dhe vëzhgimit në terren për objektin “**Rrjeti i jashtëm dhe brendshëm njësia administrative Cukalat, bashkia Ura Vajguore,**” Vlera e kontratës 238,203,283 lekë me TVSH sipërmarrësit BOE S ShPK me dhe G kontratë nr.2199/12 Prot u konstatua se: Nga auditimi dhe kontrolli në terren i ujësjellësit të njësisë administrative Cukalat u konstatua se rrethimet e depove Bistrovicë, Cukalat dhe Hallambrez nuk janë rrethuar me rrjetë teli me gjemba si në situacion por me rrjetë teli normale konkretisht zëri: 3.837 Rrethim me tela me gjemba janë situacionuar 250 m2 me vlerë 450,288 lekë në depo Allambres, 250 m2 me vlerë 450,288 lekë në depo Bistrovicë, 250 m2 me vlerë 450,288 lekë, 280 m2 me vlerë 505,620 lekë në depon Cukalat. Në total **1,406,196 lekë vlerë që përbën dëm ekonomik.** Veprime jo në përputhje me Ligjin nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” neni 7, me Ligjin nr. 10297, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, neni 2, neni 8.

5.1.Rekomandim: Nga ana e bashkisë Dimal të merren masa për të arkëtuar shumën prej **1,406,196 lekë** nga operatori ekonomik BOE “S ShPK dhe G ” vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e ndryshimit të zërave të të punimeve të situacionuara nga ato të konstatuara në terren.

Koment: Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë ne dispozicion ky rekomandim rezulton të jetë i pazbatuar

C. Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet të tyre.

1. Gjetje nga auditimi: Nga kontrolli i dosjes teknike dhe vëzhgimit në terren për objektin “*Rikonstruksioni i rrugëve me rërë bituminoze i fshatrave të bashkisë,*” Vlera e kontratës 39,918,096 lekë pa TVSH sipërmarrësit BOE T ShPK dhe M ShPK me kontratë nr.236/21 Nga kontrolli në terren i këtyre rrugëve të cilat janë të shpërndara nëpër fshatra të ndryshëm të kësaj bashkie u konstatua se rrugët në shumë pjesë të tyre kishin dëmtime të mëdha si gropa apo rrëshqitje të shtresave rrugore madje në disa pjesë rëra bituminoze kishte degraduar.

Projekti i kësaj rruge nuk është efikasitet dhe efektiv pasi kjo metodë projektimi nuk garanton jetëgjatësi të objektit të ndërtuar. Një rikonstruksion rruge nuk mund të jetë jetëgjatë kur në të ndodhen vetëm 2 shtresa konkretisht stabilizant 10 cm dhe rërë bituminoze 10 cm. Lidhja mes këtyre dy shtresave nuk realizohet sipas kushteve teknike gjithashtu dhe vetë shtresa e rërës bituminoze nuk është zgjidhje e duhur marrë parasysh që këto rruge nuk kanë kanale për kullimin e ujërave. Prania e ujërave mbi sipërfaqen e rrugës për një kohë të gjatë ndikon në degradimin e rrugës për një afat kohor të shkurtër. Nga sa më sipër arrihet në konkluzionin se vlera e këtij investimi në shumën 39,918,096 lekë pa TVSH dhe **47,901,715 lekë me TVSh është shpenzim pa efektivitet për buxhetin e Bashkia Dimal.** Veprime jo në përputhje me Ligjin nr. 10297, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, neni 2, neni 8.

1.1.Rekomandim: Nga ana e bashkisë Dimal konkretisht zyrës së urbanistikës dhe kryetarit të bashkisë të merren masa për të hartuar dhe miratuar projekte me efikasitet dhe efektivitet.

Koment: Në zbatim të këtij rekomandimi, nga Titullari i Bashkisë ka dalë Urdhëri nr. 2141/11 datë 03/07/2023, ku është ngarkuar Drejtoria e Urbanistikës dhe e Planifikimit të hartojë projekte sipas rekomandimit të KLSH. Për sa më sipër ky rekomandim rezulton të jetë **në proces zbatimi.**

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i vjeljes së të ardhurave, rezultuan të ardhura të munguara progresive 2016-2022, për buxhetin e bashkisë Dimal në vlerën totale 317,757,340 lekë. Të ardhura të munguara nga mospagimi i taksave dhe tarifave të familjarëve në vlerën 199,755,053 lekë. Të ardhura të munguara nga mospagimi i taksave dhe tarifave vendore nga subjektet e biznesit në vlerën 69,920,905 lekë Të ardhura të munguara nga mospagimi i taksës së ndikimit në infrastrukturë në vlerën 3,822,253 lekë. Të ardhura të munguara nga mospagimi i detyrimit për pajisje me licencë tregtimi për shitjen me pakicë të hidrokarbureve dhe nënprodukteve të tyre në vlerën 2,600,000 lekë. Të ardhura të munguara nga mospagimi i gjobave të vendosura nga IMT-ja në vlerën progresive 33,124,950 lekë. Ka mangësi në rastet e ndjekjes së plotë të procedurave të arkëtimit të debitorëve, deri në nxjerrjen e Urdhër sekuestrimit, konfiskimit të pasurisë apo kallëzim penal të subjekteve për mos shlyerje të detyrimeve, në kundërshtim me Kreun XI “Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar”, të ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar .

2.1.Rekomandimi:

a) Drejtoria e të Ardhurave Vendore në Bashkinë Dimal, të marrë masa ligjore ndaj subjekteve debitorë me qëllim mbledhjen e detyrimeve të prapambetura dhe të zbatojë procedurat ligjore për realizimin dhe arkëtimin e tyre.

b) Të marrë masa për arkëtimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore në momentin që lind detyrimi me qëllim mos krijimin e detyrimeve të prapambetura për secilën kategori biznesi.

Koment: Nga verifikimi rezulton se në Bashkinë Dimal për zbatimin e rekomandimit, ka dalë Urdhëri i Kryetarit nr.307, me nr. 2141/12 prot., datë 03.07.2023, në të cilin ngarkohet Drejtoria e Tatim Taksave dhe e Menaxhimit të Aseteve, për arkëtimin e detyrimeve të prapambetura. Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatuan të ardhura të munguara nga mospagimi i detyrimeve në vlerën prej 280,667,282 lekësh. Për sa më sipër ky rekomandim rezulton të jetë **në proces zbatimi**.

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit mbi pasjen me Liçencë tregtimi për subjektet që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre, u konstatua se ka mangësi në plotësimin e të dhënave të këtyre subjekteve në përgjithësi dhe debitorëve në veçanti, si mos aplikimin e tarifës së licencës dhe lejimin e subjekteve të ushtrojnë aktivitetet pa paguar këtë taksë dhe mos ndjekjen e detyrimeve për subjektet të cilat janë pajisur dhe nuk e kanë paguar tarifën. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave, rezulton se në territorin e Bashkisë Dimal dhe në Njësitë Administrative në vartësi, ushtrojnë aktivitetin 14 subjekte aktualisht të cilat tregtojnë me pakicë hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre. Nga 14 subjekte janë pajisur me autorizim 12 subjekte, nga të cilat 2 subjekte janë përpara periudhës objekt auditimi si dhe janë pajisur me licenca/autorizime të reja subjekti 12 subjekte të cilat tregtojnë me pakicë hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre, kanë mbyllur aktivitetin e tyre 2 subjektet të cilat nuk ushtrojnë më aktivitetin në tregtimin me pakicë të hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre si dhe nuk paguar tarifën për tu pajisur me autorizim tregtim karburanti gjithsej 5 subjekte të cilët ushtrojnë aktivitetet dhe papaguar detyrimin fiskal, evidentohen në **vlerën 2,600,000 lekë** e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Dimal nga subjektet e paraqitura në Aneksin nr. 3, pika 2.3, “Debitorë në fushën hidrokarbure të cilët nuk kanë paguar detyrimin e pajisjes me autorizim”, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit. Veprime të cilat bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në, Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar neni 35, VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar kapitulli II, pika 1; germa “b”, dhe pika 9, ndryshuar me VKM nr. 344, datë 19.04.2017, kapitulli II, pika 1; germa “b” dhe pika 9 dhe 15.

3.1.Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Dimal, të ndjekë të gjitha rrugët administrative e ligjore për pajisen me liçenca të subjekteve që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre dhe arkëtimin e tarifës së pataksuar prej **2,600,000 lekë** ndaj 5 subjekteve, sipas pasqyrës më sipër. Në rastet kur këto subjekte nuk paraqiten për pagesën e tarifës së liçencë/autorizimit, Bashkia Dimal në bashkëpunim me Inspektoratin Shtetëror Teknik të ndërmarrin veprime administrative e ligjore deri në mbylljen e aktivitetit të këtyre subjekteve.

Koment: Në Bashkinë Dimal për zbatimin e rekomandimit ka dalë Urdhëri i Kryetarit nr.299 me nr. 2141/4 prot., datë 03.07.2023, në të cilin ngarkohet Drejtoria e Tatim-Taksave dhe e Menaxhimit të Aseteve, si dhe Komisioni i Dhënies së Licensave Profesionale. Drejtoria e Tatim Taksave dhe Menaxhimit të Aseteve së bashku me Komisionin e Dhënies së Licensave ka bërë njoftimet ndaj subjekteve të cilët janë debitor ndaj Bashkisë. Nga verifikimi i dokumentacionit dhe të dhënave tabelore, rezulton ende e paarkëtuara shuma prej 2,200,000 lekësh.

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion ky rekomandim rezulton të jetë **në proces zbatimi**.

4. Gjetje nga auditimi: Drejtoria e të Ardhurave, Bashkia Dimal, nuk ka zbatuar VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”, pika 5, si dhe ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave vendore”, i ndryshuar, pika 3 e nenit 27- Taksa e ndikimit në infrastrukturë, për objektet që legalizohen. Rezulton se nuk kanë bërë pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë **137 persona në vlerë 3,822,253 lekë e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Dimal**, sipas të dhënave sipas *Aneks nr. 2*, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

4.1.Rekomandimi: Drejtorin e Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet pa leje në vlerën **3,822,253,lekë** ndaj **137** personave sipas listës, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Koment: Nga verifikimi rezulton se në Bashkinë Dimal përzbatimin e rekomandimit ka dalë Urdhri i Kryetarit nr.309 me nr. 2141/14 prot., datë 03.07.2023, në të cilin ngarkohet Drejtoria e e Tatim-Taksave dhe e Menaxhimit të Aseteve. Drejtoria e Tatim Taksave në Zbatim të urdhërit të dalë nga Kryetari dhe Rekomandimeve të lëna nga auditimi i KLSH, ka dërguar njoftime për pagim të detyrimit të Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë për objektet që legalizohen, për të gjithë tatimpaguesit të cilët nuk kanë arkëtuar këtë detyrim. Nga procedurat e ndjekura rezulton shume paarkëtuar në vlerën prej 2,330,657 lekësh.

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë ne dispozicion ky rekomandim rezulton të jetë në proces zbatimi.

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacioni të procedurës së prokurimit me objekt “Blerje karburant”, me fond limit në shumën 24,000,000 lekë pa TVSh dhe vlerë kontrate në shumën 24,000,000 lekë pa TVSh me marzh fitimi 16.1% ose 17 leke litër, pjesë e dosjes së prokurimit, konstatohet se; Në dosjen e prokurimit nuk rezulton të jetë argumentuar dhe justifikuar sasia e parashikuar. Referuar të dhënave të vëna në dispozicion për vitet e mëparshme rezulton se sasia e konsumuar për vitin 2018 është 71,707 litra, për vitin 2019 është 61,963 litra dhe për vitin 2020 është 79,960 litra. Pra referuar 3 viteve të mëparshme sasia mesatare e konsumuar është 71,210 litra. Për vitin 2021 janë parashikuar 102,439 litra sikurse edhe për vitin 2022. Kjo sasi nuk është argumentuar se përse është parashikuar rreth 22,479 litra më tepër nga viti 2020, dhe 44,958 litra më tepër për të dy vitet. Autoriteti Kontraktor nuk ka siguruar një përkrahim të mallrave që nevojiten për nisjen e procedurës, nuk ka siguruar të dhëna të nevojshme nga strukturat përkatëse për parashikimin e sasisë që nevojiten për realizimin e procedurës, të cilat duhet të argumentonin vlerën e kontratës. Bazuar në çmimin e ditës i cili është marrë për llogaritjen e fondit limit i cili është 117,143 lekë pa TVSH me sasinë prej 44,958 litra e pa argumentuar arrihet në konkluzion se vlera prej **5,266,514 lekë konsiderohet vlerë e pa argumentuar e fondit limit** me pasojë përdorimin e fondeve publike jo në përputhje me parimet e ekonomicitetit. Gjithashtu nuk rezulton të jetë argumentuar përzgjedhja e llojit të kësaj procedure prokurimi si Marrëveshje Kuadër. Veprime e mosveprime jo në përputhje me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 12, pika 2/a, VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 45/1 pika 2, neni 59, pika 2.

5.1.Rekomandimi: - Autoriteti Kontraktor, Përgjegjësi i Prokurimeve në Bashkia Dimal, të marrë masat e duhura që, të mbajë në konsideratë të gjitha aktet ligjore në llogaritjen e vlerës limit të kontratës, me qëllim përdorimin e fondeve me ekonomicitet.

- Autoriteti Kontraktor, Përgjegjësi i Prokurimeve në Bashkia Dimal, të marrë masat e duhura që përpara hartimit të urdhrimit të prokurimit të argumentojë përzgjedhjen e llojit të procedurës së prokurimit me qëllim kryerjen e një procesi transparent dhe të besueshëm të procesit.

Koment: Në zbatim të këtij rekomandimi, nga Titullari i Autoritetit Kontraktor është nxjerrë Urdhëri nr. 2141/15 datë 03/07/2023, ku janë përcaktuar masat përkatëse për zbatimin e rekomandimit të lënë nga KLSH. Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion ky rekomandim rezulton të jetë në proces zbatimi.

6. Gjetje nga auditimi: Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion mbi auditimin e zbatimit të kontratës së furnizimit me karburant për vitin 2021 konstatohet se; Me datën 15.12.2012, referuar fletëhyrjes në magazinë me nr. 66, marrë në dorëzim nga magazinierja është bërë hyrje sasia me karburant 12,520 litra “Naftë”, sipas faturës së OE “G”, me nr. 432, datë 15.12.2021. Është mbajtur procesverbali nga komisioni i marrjes në dorëzim në të cilin shprehen se kjo sasi është bërë hyrje sipas kontratës së nënshkruar pa nr. prot., datë 15.12.2021 me vlerë 2,140,419 lekë me TVSh. Në këtë procesverbal citohet gjithashtu se “Sipas kërkesave të njëjste shpenzuese përkatëse komisioni mori në dorëzim sasinë prej 12,520 litra me vlerë 2,140,419 lekë. Ky shpenzim është njohur dhe në kontabilitet nga nëpunësi zbatues, duke e njohur si detyrime në Pasqyrat Financiare të Bashkia Dimal të vitit 2021. Rast i cili konsiston në marrjen përsipër të një angazhimi të pa parashikuar në buxhetin e vitit 2021 për të cilin nuk janë parashikuar fonde në dispozicion, duke shmangur gjithashtu kryerjen e procedurave standarte të prokurimit, mostrajtimin e barabartë të OE, shmangien e konkurrencës, etj. Nga sa më sipër konstatohet se **shuma prej 2,140,419 lekë është shpenzim financiar i pa argumentuar** për buxhetin e Bashkisë Dimal. Veprime jo në përputhje me Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 3, pika 38, neni 40, Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 1, neni 2, neni 3.

6.1.Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor, Drejtorja e Ekonomisë dhe Financës, të marrin masat e duhura për miratimin e fondeve përkatës në Këshillin Bashkiak para kryerjes së shpenzimeve dhe iniciativave të angazhimeve buxhetore.

Koment: Ne zbatim të këtij rekomandimi, nga Titullari i Autoritetit Kontraktor është nxjerrë Urdhëri nr 2141/16 datë 03/07/2023, ku janë përcaktuar masat për miratimin e fondeve përkatës në Këshillin Bashkiak para kryerjes së shpenzimeve dhe iniciativave të angazhimeve buxhetore. Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion ky rekomandim rezulton të jetë në proces zbatimi.

C. Masa disiplinore

Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil:

Mbështetur në nenin 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, shkronja (c), të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, në V.K.M-në nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Dimal**, që për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo punonjës të atakuar dhe të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore përkatëse, si më poshtë:

1. **Zj. R.SH**, me detyrë Sekretar i Përgjithshëm, për problemet e konstatuara në lidhje me vlerësimin e ofertave të paraqitura nga Operatorët Ekonomikë në mospërputhje me kërkesat e vendosura në DST, në 2 procedura dhe për problemet e konstatuara në hartimin e kriterëve të kualifikimit dhe specifikimeve teknike, si dhe në 1 rast në procesin e dhënies me qira të fondit pyjor;
2. **Zj. L.B**, me detyrë zëvendës Kryetar i Bashkisë, në cilësinë e personit të autorizuar si titullar i Autoritetit Kontraktor, për problemet e konstatuara në lidhje me hartimin e kërkesave për kualifikim në DST, në katër procedura, në një rast në llogaritjen e fondit limit për procedurën e prokurimit si dhe në 1 rast në procesin e dhënies me qira të fondit pyjor;
3. **Z. A.P**, me detyrë Drejtor i Urbanistikës, për problemet e konstatuara në lidhje me hartimin e kërkesave për kualifikim në DST, në tre procedura, në një rast në procesin e vlerësimit të ofertave për procedurat e prokurimit si dhe në 1 rast në procesin e dhënies me qira të fondit pyjor;
4. **Zj. M.B**, me detyrë Drejtor i Drejtorisë Ekonomike dhe Financave, për problemet e konstatuara në lidhje me programimin dhe zbatimin e buxhetit të bashkisë, si dhe në lidhje me hartimin e kriterëve të kualifikimit në dy procedura prokurimi;
5. **Zj. I.D**, me detyrë përgjegjës sektori për marrëdhëniet me publikun, për problemet e konstatuara në lidhje me hartimin e kriterëve të kualifikimit në një procedurë prokurimi, në lidhje me kualifikimin e Operatorëve Ekonomikë në mospërputhje me kërkesat e vendosura në DST, në 1 procedurë si dhe në 1 rast në procesin e dhënies me qira të fondit pyjor;
6. **Z. I.SH**, me detyrë specialist topograf në Drejtorinë e Urbanistikës, për problemet e konstatuara në lidhje me hartimin e kriterëve të kualifikimit në një procedurë prokurimi, në lidhje me kualifikimin e Operatorëve Ekonomikë në mospërputhje me kërkesat e vendosura në DST, në 1 procedurë,
7. **Zj. A.GJ**, me detyrë specialiste finance, për problemet e konstatuara në lidhje me hartimin e kërkesave për kualifikim në DST, në një procedurë, në një rast në llogaritjen e fondit limit për procedurën e prokurimit si dhe në 1 rast në procesin e marrjes në dorëzim të mallrave.
8. **Z. E.H**, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Marrëdhënieve me Publikun, për problemet e konstatuara në lidhje me hartimin e kërkesave për kualifikim në DST, në katër procedura, dhe në 1 rast në procesin e dhënies me qira të fondit pyjor;

Koment: Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion këto masa rezultojnë të jenë zbatuar.

Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës apo me status të parashikuar në ligje të veçanta:

Mbështetur në nenin 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, shkronja (c), të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në Kodin e Punës në Republikën e Shqipërisë, neni 37 “Masa Disiplinore”, të kontratës individuale të punës, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Dimal**, që për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo punonjës të atakuar dhe të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore përkatëse, si më poshtë:

Z. I.SH, me detyrë Drejtor i Taksave dhe Tarifave Vendore, për problemet e konstatuara në lidhje me realizimin e ulët të të ardhurave në buxhetin e bashkisë.

Koment: Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion ky rekomandim konsiderohet të jetë zbatuar.

D. Njoftimi i departamentit të administratës publike dhe komisionerit të mbikëqyrjes të shërbimit civil.

Për punonjësit që janë rekomanduar masat disiplinore, Bashkia Dimal pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, **të ndërmarrë veprimet si më poshtë:**

a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", i ndryshuar.

b. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", i ndryshuar.

Koment: Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se ky rekomandim është **pjesërisht i zbatuar.**

Konkluzion: Me shkresen nr 989/9, datë 14/06/2023 është dërguar Raporti Përfundimtar dhe Rekomandimet për Auditimin e Përputhshmërisë të ushtruar në Bashkinë Dimal, sipas Programit të Auditimit me nr 121/1 Prot, datë 31.01.2023. Nga Bashkia Dimal në lidhje me Raportin Përfundimtar të Auditimit, nuk ka patur kundërshtime për rekomandimet e dërguar nga KLSH, si dhe janë përcaktuar strukturat përgjegjëse për zbatimin e rekomandimeve dhe afatet përkatëse.

Bashkia Dimal ka përgatitur programin e masave që do të merren dhe realizohen për zbatimin e rekomandimeve ku janë përcaktuar afatet, personat apo drejtoritë përgjegjëse si dhe janë nxjerrë shkresat përkatëse për zbatim. Plan veprimi i masave për zbatimin e rekomandimeve është miratuar nga Kryetari i Bashkisë, znj. J.M dhe është dërguar në adresën të KLSH, brenda 20 ditëve me shkresën me nr. 2142/8 datë, 04/07/2023.

Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar, u konstatua se subjekti nuk ka dorëzuar raportin e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6-mujor, një fakt ky në kundërshtim me pikën nr. 2, neni 30, të ligjit nr. 154, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", e cila citon: "Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna.

Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 25 masa organizative, 5 masa për shpërblim dëmi, 6 masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomikitet, eficensë dhe efektivitet të fondeve publike, të ardhura të munguara. I është rekomanduar Kryetarit të Bashkisë Dimal t'i kërkojë Komisionit Disiplinor pranë institucionit, masa disiplinore për 9 punonjësit të vënë përpara përgjegjësisë në material.

Nga auditimi rezulton se:

-Nga 25 masa organizative të rekomanduara, janë pranuar plotësisht për zbatim 25 masa Organizative, është zbatuar 1 masë, janë në proces zbatimi 5 masa, është zbatuar pjesërisht 1 masë dhe nuk janë zbatuar 18 masa.

-Nga 5 masa për dëm ekonomik, janë pranuar plotësisht për zbatim 5 masa. Ndër to, është zbatuar 1 masë, janë në proces zbatimi 2 masa, nuk janë zbatuar 2 masa.

-Nga 6 masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomikitet, eficence dhe efektivitet të tyre, janë pranuar për zbatim 6 masa, nga të cilat janë në proces zbatimi 6 masa.

-Lidhur me marrjen e masave disiplinore në kompetencë të Bashkisë Dimal, u konstatua se nga 9 masa disiplinore të rekomanduara ndaj 9 punonjësve, janë zbatuar të 9-ta masat. -Ndërkaq është kërkuar të njoftohet Departamenti i Administratës Publike dhe Komisioneri i Mbikëqyrjes së Shërbimit Civil, për punonjësit të cilët u është dhënë masë administrative, për të cilën kjo masë rezultoi të jetë pjesërisht e zbatuar.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi: znj. J.M, me detyrë kryetar i Bashkisë Dimal, znj. R.SH me detyrë sekretar i përgjithshëm Bashkia Dimal.

IV. GJETJE DHE REKOMANDIME

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi funksionimin e ligjit për menaxhimin financiar, rezultoi se: (i) Nuk është hartuar plan për trajnimet e stafit. (ii) nuk janë miratuar plane pune vjetore për funksionimin e GMS, (iii) nuk ka plan të përgjithshëm strategjik, (iv) nuk është hartuar dhe miratuar strategjia e menaxhimit të riskut, (v) nuk ka gjurmë të auditimit si dhe në Strukturën e miratuar Drejtoria e Planifikimit të Territorit, Kontrollit të Projekteve, Shërbimeve Publike, Transportit, Administrimit të Ujërave, Diasporës, Migracionit dhe Integritit Europian, ka mbingarkesë të detyrave dhe të kompetencave, gjithashtu në këtë drejtori ka pozicione pune të cilat janë funksione të drejtorive të tjera përcaktuar në rregulloren e funksionimit të Bashkisë. Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 10296 “Për menaxhimin Financiar dhe kontrollin” nenet 20,21,22,23 dhe 24. (Më hollësisht trajtuar në faqet 9-22 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1 Rekomandimi: Titullari i njësisë vendore për mirëfunksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, të marrë masa si vijo:

- të hartohet një plan trajnimesh për punonjësit e këtij institucioni;
- të hartohet dhe miratohet Plani Strategjik i institucionit;
- të hartohet dhe miratohet strategjia e menaxhimit të riskut;
- të miratohet Gjurma e Auditimit për institucionin, si dhe
- të rishikohet struktura organizative e institucionit në funksion të shmangies së mbingarkesës së Drejtorive, apo shpërndarjes së drejtë të detyrave në Rregulloren e Brendshme.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Bashkia Dimal nuk ka parashikuar në strukturën e saj, Komitetin e Auditimit të Brendshëm. Struktura e projekt-raporteve dhe raporteve përfundimtare pjesë e dosjeve të auditimit të zhvilluar në vitin 2023, nuk është hartuar plotësisht në përputhje me urdhrin nr. 4 dt. 10.10.2020 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Nga auditimi i Raporteve Përfundimtare të Angazhimit pjesë e dosjeve të auditimit u konstatua mungesa e rubrikës “Opinion i Përgjithshëm”. Dosjet e auditimit të brendshëm të njësisë publike nuk arkivohen në arkivin e njësisë vendore. Njësia e Auditimit të Brendshëm nuk ka çelur manualisht dhe elektronikisht dosjet e përhershme mbi njësitë e menaxhimit. Nuk është bërë pjesë e dosjes së auditimit njoftimi që duhet të kryejë grupi i auditimit për titullarin e njësisë publike, në rastet kur subjekti i audituar nuk njofton për planin e masave. Në dosjet e auditimit nuk është dokumentuar

plani i veprimit, i cili duhet të realizohet nga subjekti i audituar në vazhden e rekomandimeve të lëna nga grupi i auditimit. Edhe pse vërtetohet se grupi i auditimit të brendshëm ka lënë për detyrë hartimin e një plani veprimi për zbatimin e rekomandimeve, nga verifikimi fizik i disa prej dosjeve të përzgjedhura u konstatua mungesa e planeve të veprimit nga ana e subjekteve të audituara. Në dosjet e auditimit nuk janë konstatuar shkresa rikujtuese nga ana e përgjegjësit të njësisë së auditimit drejtuar njësisive të menaxhimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Ligjin nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, neni 13, Urdhri nr. 4 dt. 10.10.2020 i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Normave Teknike Profesionale të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë, neni 19 pika 1, Manuali i Auditimit të Brendshëm, paragrafi 4.1.12, Kreu 6, paragrafin 6.3, Kreun IV, paragrafi 4.1.13.1 (Më hollësisht trajtuar në faqet 9-22 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1 Rekomandimi: Njësia e Auditimit të Brendshëm të marrë masa për çeljen manualisht dhe elektronikisht të dosjeve të përhershme të auditimit të sektorëve dhe drejtorive të institucionit. Të kryej misionet auditimi në fushat e veprimtarisë së institucionit që paraqesin risk të lart, si prokurimet publike, administrimi i taksave dhe tarifave vendore, si dhe ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve duke kryer për këtë qëllim auditime të posaçme.

Të arkivojë dosjet e auditimit në përfundim të çdo misioni auditimi në arkivën e institucionit.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Niveli i treguesve të buxhetit për vitin 2023 paraqitet i realizuar në vlerën 773,673 mijë lekë nga vlera 932,647 mijë lekë të planifikuara, ose në masën 83%. Ndër zërat e shpenzimeve që paraqiten me mos realizim, janë transfertat korrente të brendshme, realizuar në masën 34% përdorur për shpronësime dhe rehabilitime si pasojë emergjencash, si dhe shpenzime operative realizuar në masën 71%.

Për këtë vit, shpenzimet e realizuara në Bashkinë Dimal, janë mbuluar nga të ardhurat e veta vetëm në vlerën 163,690 mijë lekë ose në masën 21%, kjo për shkak të mos realizimit të shpenzimeve nga të ardhurat e planifikuara në vlerën 94,191 mijë lekë.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” nenet 42,43,47,50,52 dhe 65; ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 41, me ligjin nr. 68/2017 datën 27.4.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 40,42. Udhëzim i MFE nr. 09 datë 20.07.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” pika 106, ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar neni 12 pika 3. (Më hollësisht trajtuar në faqet 22-42 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

3.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në bashkëpunim me Ekipet e Menaxhimit të Programeve të kryejnë një proces planifikimi të buxhetit në mënyrë të kujdesshme dhe të përgjegjshme, mbi baza mujore, si për nga nevojat për shpenzime, ashtu edhe për nga mundësitë e arkëtimit që planifikon Bashkia, në mënyrë që programimet e shpenzimeve buxhetore gjatë vitit koherent, të jenë sa më të argumentuara.

Në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se, detyrimet nga faturat e pa likuiduara dhe vendimet gjyqësore janë në vlerën 253,749 mijë lekë. Ndërsa të raportuara në Ministrinë e Financave ky detyrim është për vlerën 172,097 mijë lekë.

Në totalin e detyrimeve prej 172,097 mijë lekë, konstatohet se 3 fatura me vlerë 89,220 mijë lekë janë detyrime të krijuara nga mungesa e alokimit të fondeve nga Ministria e Infrastrukturës dhe në

total detyrimi i faturave të pa likjujduar nga fondet e vetë bashkisë mbetet në vlerën 82,887 mijë lekë, ku në raport me shpenzimet e vitit të cilat janë në shumën 543,275 mijë lekë zënë 15.1%, kjo e raportuar në MFE, pra nuk është me vështirësi financiare.

Të krahasuara me detyrimet e pasqyruara në bilanc në llogaritë 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” dhe 467 “Kreditorë të ndryshëm”, gjithsej në vlerën 293,576,639 lekë rezulton të jenë pasqyruar më shumë në bilanc për vlerën 39,827,028 lekë, për faktin se në detyrimet e raportuara në MFE nuk janë përfshirë faturat të cilat s’kanë mbushur afatin 60 ditor për likuidim dhe detyrimet për fondet të cilat janë të ministrive të linjës.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 41, me ligjin nr. 68/2017 datën 27.4.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 40,42. Udhëzim i MFE nr. 09 datë 20.07.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” pika 106, Udhëzimin e MF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, Kreu “Detyrimet e prapambetura të Njësitë të Vetëqeverisjes Vendore”, pikat 82-91. (Më hollësisht trajtuar në faqet 22-42 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

4.1 Rekomandimi: Bashkia Dimal, Drejtoria e Financës, të paraqesë në mbledhjen e Këshillit Bashkiak, një material për gjendjen e faturave të pa likuiduara, si dhe të hartojë një grafik duke zbatuar të gjithë radhën e pagesave. Për Vendimet Gjyqësore që kanë marrë formë të prerë, duhet ti ekzekutojë ato në mënyrë vullnetare dhe të mos presë që ekzekutimi të bëhet nëpërmjet urdhrave të përmbauesit gjyqësor për të shmangur kostot e tepërta buxhetore që vijnë për shkak të pagesave të shpenzimeve përmbareshme.

Menjëherë

5.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave dhe ndjekja e procedurave të inventarizimit dhe vlerësimit të asetëve, u konstatua se Bashkia Dimal nuk ka arritur të certifikojë dhe regjistrojnë pronat që ka në administrim në 4 njësitë në varësi të saj. Nga 246 prona në përdorim, rezulton se vetëm 7 prona janë pajisur ne certifikatë pronësie dhe 239 prona nuk janë pajisur me certifikatë pronësie ose në 97% të tyre nuk janë ndjekur procedurat për ti regjistruar në ASHK- Berat.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 4, neni 5 dhe neni 43 i Ligjit nr. 20/2020 “Për Kadastrën”. (Më hollësisht trajtuar në faqet 42-57 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

5.1 Rekomandimi: Bashkia Dimal të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat ligjore dhe në bashkëpunim me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës të regjistrojë dhe pajisë me certifikatë regjistrimi të gjitha asetet që ka në përdorim sipas ligjit.

Menjëherë dhe në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarive nr.210 “Toka, Troje, Terrene” dhe nr.211 “Pyje, Kullota, Plantacione”, u konstatua se në këto llogari pasqyrohen vlerat e investimeve të kryera në vitet 2006-2018, pa ndryshuar në vijimësi, duke mos pasqyruar:

- Vlerat e truallit nën objekt dhe të truallit funksional, të objekteve si ndërtesat e shkollave, të kopshteve, të pallatit të kulturës, ndërtesat që ndodhen në Njësitë Administrative, etj;

- Vlerat e trojeve, pyjeve dhe kullotave të cilat me VKM kanë kaluar në pronësi të Bashkisë Dimal Nuk është kryer inventarizimi dhe vlerësimi i asetëve për dy llogaritë e mësipërme, si dhe nuk ekziston një regjistër kontabël, ku të specifikohet analitiku i llogarisë, data e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimi i aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datë e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia etj.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Kapitulli III, neni 9, pika 1.2 në Ligjin nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar; Pikat 26, 27, 30 dhe 74 në udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar; Kapitullin III, pika 30 në udhëzimin nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”. (Më hollësisht trajtuar në faqet 42-57 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

6.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës në Bashkinë Dimal, të hartojnë regjistrin e aktiveve dhe kontabilizimin e plotë dhe të saktë në llogarive nr.210 “Toka, Troje, Terrene” dhe nr.211 “Pyje, kullota, plantacione”, si dhe të marrë masat e nevojshme për ngritjen e një grupi pune me qëllim kryerjen e verifikimit fizik dhe vlerësimin me vlerë financiare të sipërfaqeve të pyjeve, kullotave dhe plantacioneve të llogarisë nr.210 “Toka, Troje, Terrene” dhe nr.211 “Pyje, kullota, plantacione”.

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit mbi administrimin e nxjerrjen jashtë përdorimit të materialeve gjatë vitit ushtrimor 2023, nga Kryetari i Bashkisë Dimal është ngritur komisioni i inventarizimit dhe i vlerësimit sipas Urdhrit nr.232 datë 06.06.2023 dhe Urdhrit nr.126 date 29.09.2022 “Për ngritjen e komisionit të inventarizimit dhe të vlerësimit të aktiveve (llog.218 dhe llog.327)”, por nuk është vijuar me kryerjen e asgjësimit të tyre dhe nuk është bërë pakësimi i aktiveve në bilanc për aktivet e nxjerra jashtë përdorimit, veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” (Më hollësisht trajtuar në faqet 42-57 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

7.1 Rekomandimi: Nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues të marrin masa për përfundimin e procedurës së nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve të vlerësuara të tilla nga komisioni, duke vijuar me asgjësimin e tyre dhe dokumentimin përkatës, si dhe të pasqyrohen pakësimet përkatëse në llogarinë kontabël.

Menjëherë

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë nr.215 “Mjete transporti”, e cila në mbyllje të vitit 2023 paraqitet në vlerën 72,091,613 lekë, rezulton se nuk janë marrë masa për përditësimin e vlerës së mbetur për përdorimin e 4 prej mjeteve të cilat kanë mbi 20 vite dhe e kane kaluar normën e amortizimit, duke u pasqyruar në vlerën 145,347 lekë, pra pa kryer dhe pakësimet përkatëse, veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 për Menaxhimin e Aktive e në Njësitë e sektorit publik (Më hollësisht trajtuar në faqet 42-57 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

8.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës të ngriejë një grup pune me specialist të fushës për vlerësimin e gjendjes së mjeteve të transportit, si dhe të përditësojë vlerën aktuale pas amortizimit për këto 4 mjete.

Menjëherë

9. Gjetje nga auditimi: Lidhur me zbatimin e rekomandimeve nga auditimi i mëparshëm, nga Bashkia Dimal është hartuar Plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve miratuar nga Kryetari i Bashkisë, dërguar me shkresën me nr. 2142/8 datë, 04/07/2023 brenda 20 ditëve. Ndërkohë që nuk rezulton të jetë dërguar raportimi 6 mujor mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve.

Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar **25** masa organizative, **5** masa për shpërblim dëmi, **6** masa për eliminimin e fondeve publike me ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet (të ardhura të

munguara), si dhe i është rekomanduar Kryetarit të Bashkisë Dimal t'i kërkojë Komisionit Disiplinor pranë institucionit, masa disiplinore për **9 punonjësit** të vënë përpara përgjegjësisë në material.

Nga auditimi rezulton se:

-Nga **25 masa organizative** të cilat janë pranuar 100% nga subjekti. Nga të pranuarat është zbatuar 1 (një) masë, janë në proces zbatimi 5 masa, është **zbatuar pjesërisht 1 masë dhe nuk janë zbatuar 18 masa.**

-Nga **5 masa për dëm ekonomik**, të cilat janë pranuar 100% nga subjekti. Nga të pranuarat është zbatuar 1 (një) masë, janë në proces zbatimi 2 masa, **nuk janë zbatuar 2 masa.**

-Nga **6 masa për eliminimin** e fondeve publike me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet (të ardhura të munguara), të cilat janë pranuar 100% nga subjekti. Nga të pranuarat janë në proces zbatimi 6 masa.

-Lidhur me marrjen e masave disiplinore në kompetencë të Bashkisë Dimal, u konstatua se nga **9 masa disiplinore** të rekomanduara, janë zbatuar të 9-ta masat.

Në lidhje me kërkesën për njoftimin e Departamentit të Administratës Publike dhe Komisioneri i Mbikëqyrjes së Shërbimit Civil, për punonjësit të cilët u është dhënë masë administrative, **rezulton masë pjesërisht e zbatuar.**

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15, shkronja j, neni 30, pika 2. (Më hollësisht trajtuar në faqet 57-76 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

9.1. Rekomandimi: Bazuar në nenet 15 dhe 16, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për përmirësimin e gjendjes, Ju rikërkojmë marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara dhe të zbatuara pjesërisht, si dhe përsheptimin e atyre në proces zbatimi, si më poshtë:

A. Masa organizative

1.1.Rekomandimi: *Sektori i Burimeve Njerëzore në Bashkinë Dimal të hartojë një plan trajnimesh për punonjësit e këtij institucioni.*

Të hartohet dhe miratohet Plani Strategjik i institucionit. Të hartohet dhe miratohet strategjia e menaxhimit të riskut.

Të miratohet Gjurma e Auditimit për institucionin. Sektorët dhe Drejtoritë që janë ngarkuar me zbatimin e aktiviteteve të cituara në Plan e Veprimit për Kontrollin e Brendshëm, duhet të hartojnë në mënyrë periodike raporte drejtuar titullarit, ku të përshkruhet ecuria e zbatimit.

3.1.Rekomandimi: *Bashkia Dimal, të marrë masat për programimin e buxheteve afat mesëm sa më real, bazuar në radhë të parë me burimet e veta të financimit, duke zbatuar të gjitha procedurat ligjore. Të marrë masat, që në buxhetin e vitit ushtrimor, të programohet shlyerja e të gjitha detyrimeve kreditore të trashëguar nga viti paraardhës sipas kërkesave ligjore.*

4.1. Rekomandimi: *Bashkia Dimal të marrë masa për hartimin sa më real të buxhetit, mbështetur në realizimin sa më objektiv të të ardhurave dhe shpenzimeve duke pasur parasysh shlyerjen e detyrimeve të prapambetura.*

8.1.Rekomandim: *Bashkia Dimal të marrë masa për të kryer raportimin periodik në Këshillin Bashkiak lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH në përfundim të çdo auditimi. Gjithashtu të raportohet në auditimet në vijim brenda afatit të përcaktuar për zbatimin e rekomandimeve të lëna.*

9.1. Rekomandimi: *Kryetari i Bashkisë Dimal të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësinë për moszbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e mëparshëm. Të marrë masa të përsheptuara për zbatimin e rekomandimeve që janë ende të pazbatuara dhe pjesërisht të zbatuara si më poshtë:*

3.1.Rekomandimi: *Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, si dhe Drejtoria e të Ardhurave Vendore, të marrin masa për një planifikim të studiuar të buxhetit, duke u mbështetur mbi parashikime të studiuar dhe realiste të të ardhurave. Mbi bazën e këtyre të ardhurave të parashikohet edhe plani*

shpenzimeve publike, me qëllim që këto shpenzime të kenë burime financimi të sigurta për tu realizuar. Nëse gjatë vitit ka mosrealizim të të ardhurave të planifikuara, atëherë Kryetari i Bashkisë, brenda afateve që përcakton kuadri rregullator në fuqi, të kërkojë korigjimin e buxhetit nga këshilli bashkiak, me qëllim që të mos ketë diferenca midis planifikimit dhe realizimit të shpenzimeve.

4.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Dimal dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të marrin masa për likuidimin e detyrimeve ndaj të tretëve brenda afatit 30 ditor nga momenti i ardhjes së faturës. Lidhja e kontratës të bëhet vetëm pasi fondi të jetë në dispozicion në llogarinë e thesarit të autoritetit kontraktor, duke eliminuar në këtë mënyrë shkakun e krijimit të detyrimeve të reja prapambetura. Gjithashtu të merren masa për likuidimin e detyrimeve të prapambetura të krijuara në vitet e mëparshme.

5.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Dimal të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatohet, me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kane sjellë humbjen e çështjes gjyqësore. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen të procedurave të gabuara të ndjekura për çështjen e largimit të punonjësve nga puna dhe çështje të tjera, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet.

6.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Dimal në bashkëpunim me Drejtoria e Burimeve Njerëzore të marrë masa për plotësimin e stafit të DAV Bashkia Dimal me specialistë të fushës dhe përshtatja e strukturës sipas natyrës së menaxhimit të të ardhurave, duke krijuar Sektorin e Menaxhimit të Borxhit.

8.1.Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Dimal, të marrë masa për evidentimin e diferencave të pa mbledhura nga Agjentët Tatimore, sipas llojit të taksës/tarifës, të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj dhe të fillojë procedurat për penalizimin e Agjentëve Tatimore me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të pa mbledhura apo të shmangura.

8.2.Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të krijojë bazën të dhënave për subjektet, tarifën apo taksat të cilat mblidhen nga Agjentët Tatimore, të kryqëzojë informacionet me institucioni e tjera përkatëse dhe rakordimet të bëhen në fund të çdo muaj sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministria e Financave.

10.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet të llogarisë 4342 "Operacione me shtetin" dhe kundër partisë 7206 "Financim i pritshëm nga buxheti" Veprimet sistemuese të bëhen me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2022.

11.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës të marrë masa për sistemimin e llogarisë (202) "Studime dhe kërkime", duke bërë që në këtë llogari të paraqitet vetëm vlera e projekteve, për të cilat investimet e lidhura me to nuk kanë përfunduar. Për projektet të cilat kanë përfunduar, vlerat të kapitalizohet sipas objekteve përkatëse dhe regjistrohen në llogaritë përkatësisë, si pjesë e kostos totale të objektit.

12.1.Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Dimal në cilësinë e Nëpunësit Autorizues, të marrë masa të menjëhershme për të kryer procedurat ligjore të rivlerësimit të 76 prona të certifikuara në ASHK, por pa vlerë respektive si dhe paraqitjen e vlerës së këtyre aktiveve në Pasqyrën e Pozicionit Financiar të njësisë publike vendore Bashkia Dimal më 31.12.2022, pasqyrimin e tyre në kontabilitet me vlerë reale historike (referuar tregut), si dhe kryerjen e veprimeve kontabël referuar rezultatit (rritje/ulje rivlerësimi), respektivisht në llogaritë përkatëse(21) "Aktive afatgjata materiale" e llog.(109) "Diferenca nga rivlerësimi".

13.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Dimal të analizojë situatën e mos zbatimit plotësisht të rekomandimeve të dërguara nga KLSH-ja me shkresën Nr. 241/44 datë 13/04/2021, duke nxjerrë përgjegjësitë e personave përgjegjës, si dhe të hartojë plan pune të veçantë e të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për ri zbatimin e plotë të tyre, konkretisht:

a-Për 3 masa organizative të cilat janë në proces si dhe për 5 masa organizative të pa zbatuar

b-Për 6 masë shpërblim dëmi në vlerë 41,735,450 lekë.

2.1.Rekomandimi: Drejtoria e Shërbimeve dhe e Licencave në bashkëpunim me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore dhe Policinë Bashkiake, Bashkia Dimal, të ndjekë të gjitha rrugët administrative e ligjore për pajisjen me licenca të subjekteve që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre dhe arkëtimin e tarifës së pataksuar prej 2,800,000 lekë ndaj 5 subjekteve, sipas pasqyrës Aneks nr. 6 pika 2.6 bashkëlidhur raportit të auditimit.

10.1.Rekomandime: Nga DPKZHT Dimal të merren masa për të marrë konformitetin nga institucionet e përfshira dhe ti respektojë rekomandimet e tyre.

11.1.Rekomandime: Nga DPKZHT Dimal të merren masa për të respektuar me përpikmëri zbatimin e projektit të miratuar.

12.1.Rekomandime: Nga ana e kryetarit të bashkisë Dimal të merren masa për të emëruar në krye të këtij Inspektoriatit punonjës me arsim të duhur sipas kuadrit ligjor në fuqi. Gjithashtu nga IMTV të merren masat e duhura për rastet e konstatuara me shkelje të vendosen kundërvajtjet administrative përkatëse.

Menjëherë

B. Masa shpërblim dëmi:

1.3.Rekomandim: Nga ana e bashkisë Dimal të merren masa për të arkëtuar shumën prej **618,547 lekë** vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

5.1.Rekomandim: Nga ana e bashkisë Dimal të merren masa për të arkëtuar shumën prej **1,406,196 lekë** nga operatori ekonomik BOE “S ShPK dhe G ” vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e ndryshimit të zërave të të punimeve të situacionuara nga ato të konstatuara në terren.

Menjëherë

C. MASA PËR ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA.

1.Gjetje nga auditimi: Realizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore në Bashkinë Dimal për vitin 2023 paraqitet në masën 65%, ku nga 257,881 mijë lekë të parashikuara janë realizuar 167,263 mijë lekë. Nga auditimi u konstatua se, Drejtoria e Tatim-Taksave dhe Menaxhimit të Aseteve qëndron thuajse në të njëjtën performancë në realizimin e të ardhurave krahasuar me vitin paraardhës. Konstatohet se masat shtrënguese nuk kanë qenë në nivelin e duhur dhe ka mangësi në planifikim dhe realizim.

Lidhur me planifikimin e taksave të ndara apo atyre që vilen nga agjentët tatimore si tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, tatimit mbi të ardhurat personale, etj, Drejtoria e Tatim-Taksave... në Bashkinë Dimal nuk disponon të dhëna të sakta për numrin e subjekteve të cilët gjatë vitit mbyllen dhe regjistrohen dhe rrjedhimisht nuk ka rakordime të sakta, pasi për vitin 2023 nuk ka patur Akt marrëveshje me asnjë nga agjentët tatimorë, kjo edhe për shkak të mos bashkëpunimit nga ana e këtyre të fundit pavarësisht përpjekjeve. Krahas treguesve me mos realizim, rezulton se si pasojë e mungesës së të dhënave të sakta, ka mangësi edhe në planifikim, pasi rezulton se në disa zëra të ardhurat paraqiten me tejkalime, çka nënkupton planifikim jo të plotë dhe mbi tregues jo real.

Nga të dhënat rezulton se vlera progresive dhe e kontabilizuar e borxhit në fund të vitit 2023 është në vlerën **309,106,980 lekë**, nga të cilat vlera 61,485,311 lekë është krijuar vetëm në vitin 2023 dhe përbëjnë të ardhura të munguara për këtë vit.

Në vlerën totale të borxhit, peshën më të madhe të detyrimeve e zënë debitorët familjarë për tarifave pastrim, ndriçim, gjelbërim, etj, në vlerën 117,818,846 lekë ose në masën 38% të vlerës totale të borxhit, ndërkohë zëri i dytë që rëndon këtë vlerë janë detyrimet po familjare për taksën e tokës bujqësore në vlerën 70,268,869 lekë ose në masën 22.7%.

Sa i takon bizneseve debitorë, nuk janë krijuar vlera të konsiderueshme detyrimesh për vitin 2023, duke marrë parasysh se Bashkia Dimal ka arritur të arkëtojë këto detyrime më tepër nëpërmjet bllokimit të llogarive sesa nëpërmjet arkëtimeve vullnetare.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me pikën (ç) e nenit 5 të Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar dhe në Kreun XI- “Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar”, nenet 88 – 104, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH” me ndryshime. VKB-në nr. 72, datë 21.11.2022 “Paketa fiskale për sistemin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2023”. (Më hollësisht trajtuar në faqet 22-42 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1. Rekomandimi: Drejtoria e Tatim-Taksave dhe Menaxhimit të Aseteve Bashkia Dimal, të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës debitorë nga taksat për bizneset, institucione dhe familjare prej **309,106,980 lekë**.

Të bashkëpunojë periodikisht me strukturat e tjera të Bashkisë si dhe me institucionet e varësisë, me qëllim grumbullimin në mënyrë progresive të informacionit të nevojshëm për planifikimin e të ardhurave të veta

1.2. Rekomandimi: Në funksion të një planifikimi sa më të saktë të të ardhurave, nga titullari i Bashkisë të merren masa për lidhjen e Akt marrëveshje me agjentët tatimorë si dhe për caktimin e një personi përgjegjës për mbajtjen e marrëdhënieve dhe korrespondencave periodike me ta Ujësjeles sh.a, ASHK Dega Berat, Drejtoria e Tatim-Taksave, zyra e Gjendjes Civile, etj., për gjenerimin e të dhënave dhe treguesve të saktë dhe në kohë reale mbi numrin e subjekteve familjare apo privatë të cilët kanë detyrime ndaj Bashkisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Referuar dokumentacionit të paraqitur rezulton se, në territorin e Bashkisë Dimal për periudhën objekt auditimi kanë ushtruar aktivitet në fushën e tregtimit të lëndëve djegëse me pakicë **16** subjekte të paraqitura, ku 4 subjekte ushtrojnë aktivitet pa u pajisur me autorizim për tregtim karburanti. Ndërsa 10 subjekte kanë autorizim për tregtim karburanti.

Nga subjektet me leje tregtim karburanti, nuk kanë likuaduar detyrimit sipas ligjit **2 subjekte** për vlerën 400,000 lekë, si ardhur e munguar, konkretisht shoqëria “D ” ShPK për vlerën 200,000 lekë dhe shoqëria “E ” ShPK për vlerën 200,000 lekë.

Për **4 subjektet** të cilat ushtrojnë aktivitet pa leje, rezulton detyrim i taksuar por paarkëtuar në vlerën **1,800,000 lekë**, respektivisht subjektet: “B” ShPK në shumën 400,000 lekë, subjekti “B” ShPK në shumën 400,000 lekë, subjekti “A” ShPK për vlerën 1,000,000 lekë. Ndërsa subjekti “Z Oil” ShPK nuk ka detyrime.

Për sa më lart rezulton se kanë shlyer detyrimin e plotë 11 subjekte, ndërsa 5 të tjerë mbeten debitorë për vitin 2023, **në vlerën totale prej 2,200,000 lekë**.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të mbajtur për secilin subjekt më sipër, rezultoi se nga 16 subjektet e mësipërme, 4 prej tyre vijnë të ushtrojnë aktivitetin në shkelje të ligjit dhe konkretisht: Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar me ligjin nr. 71/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar dhe VKM nr. 970, datë 02.12.2015, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” (Më hollësisht trajtuar në faqet 22-42 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1. Rekomandimi: Drejtoria e Tatim-Taksave dhe Menaxhimit të Aseteve në bashkëpunim me Policinë Bashkiake, të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e vlerës **2,200,000 lekë** për 5 subjekte, konkretisht:

- **vlera 400,000 lekë** nga shoqëria “B”;

- vlera 400,000 lekë nga shoqëria “B”;
- vlera 200 lekë nga shoqëria “D ”;
- vlera 200,000 lekë nga shoqëria “E ”;
- vlera 1,000,000 lekë nga shoqëria “A”.

Brenda datës 30.9.2024

2.2. Rekomandim: Drejtoria e Tatim-Taksave dhe Menaxhimit të Aseteve (Sektori i Licensave), në bashkëpunim me Policinë Bashkiake të marrë masa për mos lejimin e subjekte në fushën e tregtimit të karburanteve pa u pajisur me leje tregtimi nga njësia vendore si dhe plotësimin e gjithë dokumentacionit ligjorë të nevojshëm për të ushtruar aktivitetin.

Menjëherë

D. MASA DISIPLINORE.

Mbështetur në Nenin 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, shkronja (c), të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, të Ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në VKM-në nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Dimal, që për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit, t’i kërkojë Komisionit Disiplinor pranë këtij Institucioni, që bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve, të fillojë procedurat për dhënien e masës disiplinore - “Vërejtje”, si më poshtë:

Z. I.SH me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Tatim taksave ..., për mangësitë konstatuar sa i takon planifikimit dhe arkëtimit të të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore;

Znj. L.H, me detyrë përgjegjëse e sektorit të tatim taksave për mangësitë konstatuar sa i takon planifikimit dhe arkëtimit të të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore;

Z. E.H, me detyrë Përgjegjës i sektorit të mjedisit, pyjeve dhe mbrojtjes konsumatore për mangësitë konstatuar sa i takon planifikimit dhe arkëtimit të të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore;

Znj. A.A, me detyrë specialiste mjedisi, për mangësitë konstatuar sa i takon dhënies së autorizimeve për subjektet që operojnë në fushën e hidrokarbureve;

Znj. G.H, në cilësinë e anëtarëve të komisionit për miratimin e licencimit të subjekteve tregtare në fushën e hidrokarbureve.

Z. I.SH, me detyrë Drejtor i Shërbimit Publik, për mangësitë konstatuar sa i takon dhënies së autorizimeve për subjektet që operojnë në fushën e hidrokarbureve;

Z. M.G, me detyrë inspektor taksash për mangësitë konstatuar sa i takon planifikimit dhe arkëtimit të të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore;

Znj. R.B, me detyrë Përgjegjës i sektorit të urbanistikës, për mangësitë e trajtuara në lidhje me taksat dhe tarifave vendore;

Znj. I.M, me detyrë përgjegjës i sektorit të financës për konstatimet sa i takon menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe mangësitë e trajtuara në lidhje me taksat dhe tarifave vendore;

Znj. M.B, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financës, për mangësitë konstatuar sa i takon hartimit të konstatuar sa i takon hartimit të pasqyrave financiare.

E. PËR NJOFTIMIN E DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË SHËRBIMIT CIVIL.

Për punonjësit të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër (Drejtoria e Burimeve Njerëzore e Institucionit) , pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, të ndërmarrë veprimet si më poshtë:

1. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të Ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", të ndryshuar.

2. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 1 Komisionari për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, të Ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", të ndryshuar.

V. ANEKSE

1. Rekomandimet nga auditimet e kryera në vitin 2023 nga NjAB

| Subjekti Audituar | Rek. të dhëna në vitin 2023 | STATUSI REKOMANDIMEVE I | | | | REKOMANDIMET SIPAS LLOJIT | | | | | AUDITUESI |
|--|-----------------------------|-------------------------|----------------------|----------------------|-------------------|--|---|---------------------------------------|--------------------------|----------------------|----------------------------------|
| | | Rekomandim idhëné | Rekomandim i pranuar | Rekomandim i zbatuar | Në proces zbatimi | Rekomandime të përmirësimit të sistemeve | Rekomandime të përmirësimit të kuadrit ligjor | Rekomandime të karakterit organizativ | Rekomandime për arkëtime | Rekomandime të tjera | |
| Në Drejtorit e Sektorët e Bashkisë Dimal Zbatimi i Rekomandime të Lëna nga auditimet e mëparshme | 0 | 1 | 1 | 0 | 1 | | | | | 1 | Q.Malasi V.Shehu L.Bejlari |
| Në Drejtorin e Ekonomisë dhe Financës Auditim i detyrimeve të prapambetura | | 1 | 1 | 0 | 1 | | | | | 1 | Q.Malasi V.Shehu L.Bejlari |
| Në Inspektoriati Vendore i Mbrojtjes së Territorit | | 3 | 3 | 1 | 2 | | | | | 3 | Q.Malasi V.Shehu L.Bejlari |
| Në Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Mirëmbajtjes rruge, varreza,gjelberim. | | 12 | 12 | 5 | 7 | | | | | 12 | Q.Malasi V.Shehu L.Bejlari |
| Në Drejtoria e Tatim Taksave dhe Menaxhimit të Aseteve në Bashkin Dimal | | 8 | 8 | 1 | 7 | | | | | 8 | Q.Malasi V.Shehu L.Bejlari |
| Në Drejtoria Burimeve Njerëzore, Prokurimeve, dhe Shërbimeve mbështetëse", Prokurimet | | 4 | 4 | 0 | 4 | | | | | 4 | Q.Malasi V.Shehu L.Bejlari |
| Në Sektorin e Arsim Kultures dhe Sportit | | | | | | | | | | | Q.Malasi V.Shehu L.Bejlari |
| shuma | | 7 | 7 | 0 | 7 | 1 | 0 | 0 | 1 | 5 | L.Bejlari |
| | | 36 | 36 | 7 | 29 | 1 | 0 | 0 | 1 | 34 | |

| | |
|----------------------|-------------------------------------|
| Subjektet e Audituar | Realizimii angazhimeve të auditimit |
|----------------------|-------------------------------------|

| | Auditime të realizuara sipas llojit të tyre | | | | | | | | Statusi Angazhimit | |
|--|---|------------------------------------|--------------------|---------------|-----------------------|------------------|---------------------|------------------------------------|--------------------------|---------------------|
| | Gjithsej | Shërbime të Sigurisë nga të cilat: | | | | | Shërbime Këshillimi | Angazhime me kërkesë të titullarit | Angazhime të përfunduara | Angazhime në proces |
| | | A. të përputhshmërisë | A. të performancës | A. financiare | A. tek. Informacionit | A. të kombinuara | | | | |
| Në Drejtorit e Sektorët e Bashkisë Dimal Zbatimi i Rekomandime të Lëna nga auditimet e mëparshme | 1 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 | |
| Në Drejtorin e Ekonomisë dhe Financës Auditim auditim i detyrimeve të prapambetura | 1 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 | |
| Në Inspektoriati Vendore i Mbrojtjes së Territorit | 1 | 1 | | | | | | | 1 | |
| Në Drejtorin e Shërbimeve Publike dhe Mirëmbajtjes rruge, varreza, gjelberim. | 1 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 | |
| Në Drejtorin e Tatim Taksave dhe Menaxhimit të Aseteve në Bashkin Dimal | 1 | 1 | | | | | | | 1 | |
| Në Drejtorin e Burimeve Njerëzore, Prokurimeve, dhe Shërbimeve mbështetëse", Prokurimet | 1 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 | |
| Në Sektorin e Arsim Kultures dhe Sportit | 1 | 1 | | | | | | | 1 | |
| shuma | 7 | 7 | | | | | | | 7 | |

Lista e investimeve të prokuruar dhe përfunduara gjatë vitit 2023

| Nr | Date | Vlera | Objekti | Fillimi | Perfundimi | ZBATUESI |
|----------|------------|-------------|--|--------------------------------|--|----------|
| 2406/29 | 05.01.2023 | 68,767,020 | Rikonstruksion I rruges Sheq-Gajde | 16.01.2023 | Nr 143/4 prot 03.05.2023 rifillim -03.06.2023 perf kontrata | K |
| CW672284 | 22/12/2022 | M.... dhe S | Rikonstruksion I rruges Kthesa Pashallise-Konizbalte deri ne Konizbalte | Nr.423 prot, dt 08.02.23 | | S |
| 2259/15 | 17.10.2023 | 83,996,885 | Ndertim I godines se shkolles Gorican | nr 3478 prot, dt 30.10.2023 | | SH.... |
| 2499/13 | 27.10.2023 | 6,188,400 | Mbrojtje e qytetit nga permbytja dhe erozioni I Lumit Osum dhe rehabilitimi urban I kesaj zone | Nr 3857 prot, dt 01.12.2023 | | M |
| 2162/19 | 17.10.2023 | 36,094,372 | Mbrojtje Lumore ne fshatin Arrez | | | F |

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

Grupi i auditimit
R.K përgjegjës grupi
H.M, anëtar
M.M, anëtar

Drejtori i Departamentit
K.GJ

